



Bashkimi Evropian
**MISIONI I VËZHGIMIT TË
ZGJEDHJEVE**

KOSOVË 2021

Raporti përfundimtar

Zgjedhjet Komunale

17 tetor – 14 nëntor 2021



EU EOM KOSOVË

Zgjedhjet Komunale 2021

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	PËRMBLEDHJE	1
II.	HYRJE	4
III.	KONTEKSTI POLITIK.....	5
IV.	ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË MËPARSHME TË EU EOM-SË.....	6
V.	KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR.....	7
	Sistemi zgjedhor.....	8
VI.	ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	9
	Përgatitjet për zgjedhje	10
	Edukimi i votuesve	12
VII.	REGJISTRIMI I VOTUESVE.....	12
	Regjistrimi i votuesve jashtë Kosovës	14
VIII.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE.....	16
IX.	AMBIENTI I FUSHATËS	17
	Fushata para raundit të parë të zgjedhjeve.....	17
	Fushata para raundit të dytë të zgjedhjeve.....	19
	Ankesat në lidhje me fushatën zgjedhore	21
X.	FINANCIMI I FUSHATËS.....	21
XI.	MEDIAT	23
	Mjedisi medial	24
	Korniza ligjore për mediat	25
	Monitorimi i mediave nga EU EOM	27
XII.	KOMUNIKIMI DIGJITAL DHE MEDIAT SOCIALE.....	29
	Korniza ligjore për mediat shoqërore	30
	Gjetjet e monitorimit të mediave sociale	30
XIII.	PJESËMARRJA E GRAVE	34
XIV.	PJESËMARRJA E KOMUNITETEVE	35
XV.	PJESËMARRJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE GRUPEVE TË TJERA TË CENUESHME	36
XVI.	VËZHGIMI I SHOQËRISË CIVILE DHE NDËRKOMBËTAR.....	37
XVII.	KONTESTET ZGJEDHORE	37
XVIII.	VOTIMI DHE NUMËRIMI	40
	Raundi i Parë i Zgjedhjeve për Kryetarë dhe Kuvende të Komunave, 17 Tetor 2021	40
	Rundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave, 14 nëntor 2021	41

XIX. TABELIMI I REZULTATEVE DHE MJEDISI PASZGJEDHOR	43
Tabelimi i rezultateve të Zgjedhjeve për Kuvende Komunale dhe të Raundit të Parë të Zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave	43
Tabelimi i rezultateve të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave	45
Rezultatet përfundimtare.....	46
XX. REKOMANDIMET.....	47
ANEKSI I. REZULTATET E ZGJEDHJEVE	65
ANEKSI II. REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE.....	67
ANEKSI III. REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE SOCIALE	74

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

I. PËRMBLEDHJE

- Zgjedhjet komunale të vitit 2021 **ishin të organizuara mirë**. Liritë themelore u respektuan gjatë fushatës dhe një numër i madh garuesish u ofruan votuesve një zgjedhje reale, me përjashtim të komunave serbe të Kosovës ku konkurrenca politike ishte e kufizuar. Votimi në të dy raundet (17 tetor dhe 14 nëntor) u vlerësua pozitivisht nga vëzhguesit e BE-së. Pas raundit të parë, u zgjodhën anëtarët e të 38 kuvendeve komunale dhe 17 nga 38 kandidatët për kryetarë të komunave që morën mbi 50 për qind të votave të vlefshme. Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave u zhvillua në 21 komuna e mbetura, përfshirë edhe dy qytetet më të mëdha, Prishtinën dhe Prizrenin.
- Zgjedhjet komunale u mbajtën vetëm tetë muaj pas zgjedhjeve të parakohshme legislative të cilat ndryshuan peizazhin politik në Kosovë pas fitores bindëse të *Lëvizjes Vetëvendosje* (LVV). Partia e cila për shumë vite kishte qenë në opozitë, fitoi mbi 50 për qind të votave dhe formoi qeverinë e re. Zgjedhjet komunale përbënin test të rëndësishëm për LVV-në në pushtet dhe mundësi për të zgjeruar fuqinë e saj në nivel lokal. Për partitë kryesore opozitare si Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) – të cilat e kanë dominuar peizazhin politik të Kosovës pas konfliktit të armatosur, por që shënuan rezultatet e tyre më të këqija ndonjëherë në zgjedhjet e shkurtit – këto zgjedhje kishin të bënin me ruajtjen e pozitës së tyre në komuna.
- Derisa **korniza ligjore** ofron bazë adekuate për zgjedhjet, ende nuk janë adresuar mangësitë e identifikuar më herët. Një reformë gjithëpërfshirëse zgjedhore e cila mund të marrë parasysh rekomandime të shumta të dhëna nga EU EOM që nga viti 2013 është vonuar shumë. Në dobësitë afatgjate hyjnë zbrazëtitat dhe dispozitat kundërtënëse mbi kualifikimin e kandidatëve, rregullat e fushatës zgjedhore, mungesa e mbikëqyrjes dhe zbatimit efektiv të financimit të partive politike dhe fushatave, procesi i votimit jashtë Kosovës, mangësitë në zgjidhjen e kontesteve zgjedhore, rregullat e fushatës për platformat online, etj.
- **Regjistrimi i kandidatëve** ishte gjithëpërfshirës, përkundër mangësive procedurale dhe kufizimeve ligjore që janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. Gjithsej 89 subjekte, duke përfshirë 34 parti politike, paraqitën 166 kandidatë për kryetarë të komunave dhe 5,199 kandidatë për kuvendet komunale. Megjithatë, në disa komuna, kandidati i *Listës Serbe* (LS) ishte kandidati i vetëm serb i Kosovës që garonte për kryetar komune ose LS ishte e vetmja listë e serbëve të Kosovës në garën për kuvendet komunale, gjë që kufizoi konkurrencën politike dhe mundësinë e votuesve për të zgjedhur. Kufizimet për kandidatët me të kaluar penale janë joproporcionale dhe nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Për më tepër, verifikimi i të dhënave [penale] vuri në pah disa mangësi.
- Numri shumë i ulët i grave në garat për kryetarë të komunave e pasqyroi realitetin e vrazhdë të **pjesëmarrjes politike të grave** në Kosovë. Ndonëse gjithsej 14 kandidatë për kryetarë të komunave ishin gra (8 për qind), vetëm dy prej tyre u caktuan në bastionet e partive të tyre politike; të dyja u zgjodhën si përfaqësuese të LS. Gjithsej 1,937 gra (37 për qind) kandiduan për kuvendet komunale duke respektuar kuotën minimale gjinore prej 30 për qind, dhe 36 prej tyre (12 për qind)

kryesonin listat e tyre. Pavarësisht emërimit të numrit që kërkohet ligjërisht të kandidatëve [gra], partitë politike, të cilat kryesisht janë të dominuara nga meshkujt, ende nuk e kanë trajtuar seriozisht çështjen e pabarazisë gjinore në programet dhe statutet e tyre.

- KQZ-ja i bëri **përgatitjet për zgjedhje** në mënyrë profesionale duke respektuar të gjitha afatet ligjore dhe gëzoi një nivel të lartë besimi nga të gjitha palët e interesuara. Përbërja e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillave të Vendvotimeve (KVV) ishte gjithëpërfshirëse dhe transparente, me një formulë të emërimit që në përgjithësi balanconte kompleksitetin e përfaqësimit të subjekteve politike në Kuvendin e Kosovës dhe në kuvendet komunale. Ajo po ashtu u siguroi që të përfaqësoheshin komunitetet jo-shumicë që kishin një prani më të madhe në një komunë. Megjithatë, gratë ishin dukshëm të nënpërfaqësuara në të gjitha nivelet e administratës së zgjedhjeve.
- **Regjistrimi i votuesve** ishte gjithëpërfshirëse, por vazhdojnë problemet me saktësinë e të dhënave, përfshirë edhe verifikimin e votuesve jashtë Kosovës. Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV), e bazuar në ekstraktet nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile, përmbante gati 1.9 milionë votues, 90,586 më shumë sesa në zgjedhjet legjislative të shkurtit 2021. Numri i qytetarëve të regjistruar për votim jashtë Kosovës ishte 15,532, që ishte 86,568 më pak krahasuar me zgjedhjet e shkurtit. Pas pastrimit të regjistrimit të gjendjes civile të bërë në vitin 2019 dhe para zgjedhjeve legjislative të vitit 2021, është përmirësuar saktësia e LPV-së. Megjithatë, ende mbeten problemet lidhur me të dhënat e votuesve të vdekur dhe mungesa e një sistemi të unifikuar të adresave. Për më tepër, procesit të regjistrimit dhe verifikimit të votuesve jashtë Kosovës i mungojnë garancitë themelore për të mbrojtur integritetin e tij nga manipulimi dhe mashtrimi.
- **Fushata** në përgjithësi ishte e decentralizuar dhe konkurruese, e dominuar nga zgjedhjet për kryetarë të komunave. Duke marrë parasysh masat e pandemisë dhe burimet e pakta financiare, kandidatët reduktuan fushën e aktiviteteve të tyre të planifikuara fillimisht dhe u fokusuan në paraqitjet e tyre në media sociale dhe TV. Gjithandej Kosovës u mbajtën takime kryesisht të vogla dhe në ambiente të jashtme, zakonisht me një audiencë të caktuar dhe duke respektuar kufizimet sanitare. Tubimet u intensifikuan pak para të dy raundeve ku shumë prej tyre mblidhnin disa qindra pjesëmarrës, në kundërshtim me masat sanitare. Në shumë ngjarje morën pjesë liderë të partive kryesore si dhe zyrtarë qeveritarë, përfshirë kryeministrin Albin Kurti dhe ministrat e tij. EU EOM-së iu raportuan pretendime për blerje të votave dhe keqpërdorim të burimeve administrative në disa komuna, si dhe për presion mbi votuesit në veri të Kosovës.
- Meqë korniza ligjore nuk përcakton ndonjë ndëshkim për bërje të fushatës jashtë **periudhës zyrtare të fushatës** dhe KQZ-ja nuk ndërmori ndonjë masë për këtë, shumica e garuesve për raundin e dytë rifilluan aktivitetet e tyre të fushatës menjëherë pas raundit të parë, duke mos e respektuar periudhën zyrtare pesëditore të fushatës.
- **Fushata online** filloi menjëherë pas raundit të parë dhe, për dallim nga retorika respektuese e vërejtur në raundin e parë, toni u bë më i ashpër. Derisa kandidatët shpërndanë informacione të dobishme përmes platformave online dhe përdorën reklama me pagesë për të promovuar mesazhet e tyre, faqet jotransparente të Facebook-ut u përdorën për të diskredituar konkurrentët përmes përmbajtjes çorientuese me pagesë. Reklamata online duket se u përdorën gjerësisht, por mungesa e rregullave të transparencës e pamundësoi llogaridhënien për to. Korniza ligjore nuk reflekton rëndësinë e shtuar të komunikimit digjital në zgjedhje, duke e lënë të parregulluar shpërndarjen e reklamave politike në internet.

- **Mediat** kontribuan në informimin e votuesve dhe iu ofruan qasje garuesve. Transmetuesi publik, *RTK*, përmbushi rolin e tij të shërbimit publik duke ofruar mbulim të balancuar dhe neutral për garuesit, dhe duke organizuar debate të strukturuar mirë dhe informuese ndërmjet kandidatëve për kryetarë të komunave dhe për kuvende komunale. Megjithatë, *RTK* nuk ishte e balancuar në versionin e saj online. Transmetuesit privatë ofruan një mbulim shumë të kufizuar të lajmeve për garat lokale, por organizuan debate zgjedhore për shumicën e komunave. Mbulimi i tyre redaktues ishte në përgjithësi mjaft i balancuar ku kanalet televizive pasqyronin ambientin pluralist mediatik dhe duke u dhënë pak më shumë hapësirë partive të ndryshme. Sistemit të ndëshkimit të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) i mungonte qartësia dhe konsistenca. Gjatë fushatës zgjedhore 30-ditore të raundit të parë, KPM-ja nuk sanksionoi me kohë shkeljet e mediave transmetuese, gjë të cilën e bëri gjatë fushatës pesëditore për raundin e dytë.
- Në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare, korniza ligjore parasheh kufizime për **donacionet dhe shpenzimet e fushatës** por për shkak të mangësive thelbësore, nuk siguron raportim të saktë, zbulim me kohë dhe zbatim kuptimplotë. Mungesa e auditimit të rregullt dhe zbatimi selektiv i sanksioneve nga KQZ-ja rezultoi në mbikëqyrje *pro-forma* të financave të fushatës dhe nuk shërbeu si nxitje për garuesit që të respektojnë rregullat. Në anën tjetër, kjo ka çuar në një mungesë të qartë të transparencës dhe llogaridhënies me shqetësime për problemet afatgjate të lidhjeve të paraportuara financiare ndërmjet partive dhe bizneseve me ndikim.
- **Gjykimi i ankesave dhe parashtresave** është bërë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe Gjykata Supreme (GJS) përgjithësisht në mënyrë transparente dhe të paanshme. PZAP-ja ishte në gjendje të trajtojë një numër të madh të kërkesave, veçanërisht lidhur me zgjedhjet për kuvendet komunale, brenda afateve shumë të shkurta ligjore. Disa vendime të PZAP-së që urdhëruan një numër të konsiderueshëm rinumërimesh për zgjedhjet për kuvendet komunale, anulimin e votave jashtë Kosovës në një komunë ose anulimin e zgjedhjeve komunale në një tjetër, nxorën në pah disa dobësi në kornizën ligjore të cilat duhet të adresohen për të mbrojtur më mirë të drejtën themelore për të votuar. Dy prej vendimeve të PZAP-së lidhur me ankesat nuk ishin plotësisht në përputhje me ligjin, por të dyja u korrigjuan me vendimet e GJS-së pas ankesave.
- Të dy raundet e **votimit** ishin të qeta dhe të rregullta dhe u vlerësuan shumë pozitivisht nga vëzhguesit e BE-së. Megjithatë, është vërejtur një numër i konsiderueshëm i rasteve të votimit me asistencë dhe rregullat për pranimin e letërnjoftimeve të skaduara për identifikim të votuesve nuk janë respektuar në mënyrë konsistente. Vetëm rreth 67 për qind e vendvotimeve të vizituara ofronin qasje për njerëzit me vështirësi për të lëvizur.
- **Numërimi i votave** ishte transparent në të dy raundet, siç raportuan vëzhguesit e BE-së. Megjithatë, në raundin e parë, numërimi u vlerësua negativisht në gjashtë nga 31 vendvotimet e vëzhguara, kryesisht për shkak të mospërputhjeve në ndjekjen e procedurave. Numërimi u vlerësua si i mirë dhe shumë i mirë në të gjitha qendrat e votimit të vizituara gjatë raundit të dytë, por kishte disa vështirësi gjatë përputhjes së fletëvotimeve në rreth një të tretën e vendvotimeve të vëzhguara, të cilat nuk ndikuan në integritetin e procesit.
- **Tabelimi** i rezultateve të raundit të parë, ndonëse i hollësishëm dhe transparent, zgjati deri në mbrëmjen e raundit të dytë dhe nxori në pah dobësi të theksuara në numërim dhe në plotësimin e formularëve të rezultateve. Është dashur të rinumërohen gjithsej 987 rezultate të vendvotimeve për zgjedhjet për kryetarë dhe kuvende komunale, gjë që tregon nevojën për një rishikim të plotë të

dizajnit të fletëvotimeve, të formularëve të kandidatëve dhe formularëve të rezultateve, si dhe për trajnimin e anëtarëve të KVV-ve. Numri i fletëvotimeve të pavlefshme në zgjedhjet për kuvende komunale arriti në pothuajse 7 për qind, duke treguar se ka pasur aktivitete të pamjaftueshme për informimin e votuesve dhe se dizajni i fletëvotimit ka qenë tepër kompleks. Tabelimi i rezultateve të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave ishte më i lehtë dhe më i shpejtë se sa në raundin e parë për shkak të numrit më të vogël të komunave ku u votua, si dhe thjeshtësisë së formularit të rezultateve që duhej të plotësohej. Megjithatë, anulimi i rezultateve të votimit jashtë Kosovës në Dragash nga PZAP-ja vuri në pah një mangësi në atë se si KQZ-ja duhet të adresojë dyshimet për fletëvotimet jashtë Kosovës.

REKOMANDIMET ME PRIORITET:

- 1. Të modernizohet metoda e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, për shembull përmes një vegëze (link) në faqen e internetit të KQZ-së me masa të sigurisë siç është verifikimi me dy hapa i aplikuesve për tu mbrojtur nga mashtrimi dhe paraqitja e personave në emër të dikujt tjetër.*
- 2. Të sigurohet që të ketë një mekanizëm të pavarur për mbikëqyrjen efektive të financave të partive dhe fushatave, të cilit i jepet mandati, autoriteti, si dhe burimet financiare dhe njerëzore për të monitoruar dhe hetuar në mënyrë efektive dhe proaktive parregullsitë e pretenduara në financimin e partive dhe fushatave, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e paraportuara dhe shqiptimin e ndëshkimeve.*
- 3. Të përfshihen dispozita për reklamat zgjedhore në platformat online dhe rregullat ekzistuese të fushatës të shtrihen në mënyrë të qartë edhe në sferën digjitale.*
- 4. Të emërohen me kohë të gjithë anëtarët e KPM-së dhe të Bordit të Ankesave të KPM-së përmes një procesi përzgjedhës konkurrues dhe transparent për të nxitur pavarësinë, mbikëqyrjen dhe fuqinë sanksionuese të këtij organi rregullator.*
- 5. Të ridizajnohen fletëvotimet e zgjedhjeve për kuvende komunale që votuesit t'i kuptojnë më mirë ato dhe të shtohen informacionet për votuesit se si të shënojnë në mënyrë të duhur fletëvotimin në mënyrë që të zvogëlohet numri i votave të pavlefshme.*
- 6. Të përfshihen dispozita për kontestimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të publikuara nga KQZ-ja. Të qartësohen paqartësitë lidhur me ankesat që kanë të bëjnë me votimin, numërimin, procesin në QNR dhe afatet e tyre përkatëse.*

II. HYRJE

Me ftesë të Presidentes së Kosovës, BE-ja vendosi një Mision Vëzhgues të Zgjedhjeve (EOM) për të vëzhguar zgjedhjet për kuvendet komunale dhe për kryetarë të komunave që u mbajtën më 17 tetor 2021 në të 38 komunat e Kosovës dhe për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave më 14 nëntor

2021. Misioni ishte i pranishëm në Kosovë nga 5 shtatori deri më 5 dhjetor 2021. Misioni vlerësoi nivelin se sa procesi zgjedhor ishte në përputhje me ligjet e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Që prej vitit 2013, Bashkimi Evropian ka vendosur pesë misione EOM në Kosovë, përfshirë edhe për zgjedhjet komunale në vitet 2013 dhe 2017, dhe një mision ekspertësh të zgjedhjeve për zgjedhjet e parakohshme legislative në shkurt 2021.

EU EOM-në e udhëhoqi z. Lukas Mandl, deputet i Parlamentit Evropian nga Austria. Misioni përfshinte një Ekip Kryesor prej 10 anëtarësh, 22 vëzhgues afatgjatë (LTO), të cilët mbërritën në Kosovë me 13 shtator, dhe 34 vëzhgues afatshkurtër (STO) që ishin të pranishëm në Kosovë prej 12 deri me 20 tetor për raundin e parë të zgjedhjeve. Para raundit të dytë të zgjedhjeve që u mbajtën në 21 nga 38 komunat e Kosovës, numri i LTO-ve u reduktua në 14. Raundi i dytë i zgjedhjeve poashtu u vëzhgua nga 28 vëzhgues afatshkurtër të cilët ishin të pranishëm në Kosovë nga 10 deri më 17 nëntor.

EOM-ja u përforcua me vëzhgues të rekrutuar në Kosovë – gjithsej 26 për ditën e zgjedhjeve të 17 tetorit dhe nëntë për ditën e zgjedhjeve të 14 nëntorit – nga përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare të BE-së, si dhe nga Zyra e BE-së/EUSR dhe EULEX-i. Në total, misioni shpërndau 94 vëzhgues nga 22 shtete anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra për ditën e zgjedhjeve të 17 tetorit dhe 62 vëzhgues nga 21 shtete anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra për ditën e zgjedhjeve të 14 nëntorit. Përveç kësaj, një delegacion prej gjashtë anëtarësh të Parlamentit Evropian i kryesuar nga zonja Viola von Cramon-Taubadel poashtu vëzhgoi ditën e zgjedhjeve të 17 tetorit. Vëzhguesit e BE-së vizituan 400 vendvotime më 17 tetor dhe 269 vendvotime më 14 nëntor, ku vëzhguan votimin dhe numërimin.

EU EOM veprroi me mandat specifik dhe ishte i pavarur nga institucionet e BE-së, përfshirë nga Zyra e BE/Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë. Misioni veprroi nën një kod të sjelljes që kërkon neutralitet të rreptë dhe mosndërhyrje, duke e kryer punën e vet edhe në përputhje me Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve. Ky raport përfshin zhvillimet e vëzhguara nga misioni deri më 4 dhjetor 2021.

EU EOM dëshiron tu shpreh mirënjohjen e vet autoriteteve kosovare, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, Prokurorisë Publike, Komisionit të Pavarur për Media dhe institucioneve të tjera, Policisë, partive politike, mediave dhe shoqërisë civile për bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre gjatë gjithë pranisë së Misionit. EU EOM po ashtu i shpreh mirënjohjen e vet Zyrës së BE/EUSR në Kosovë, EULEX-it, KFOR-it, OSBE-së dhe përfaqësive diplomatike të shteteve anëtare, Norvegjisë dhe Zvicrës për mbështetjen e tyre.

III. KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet komunale u mbajtën vetëm tetë muaj pas zgjedhjeve të parakohshme legislative të cilat ndryshuan peizazhin politik në Kosovë pas fitores bindëse të LVV. Partia e cila për shumë vite kishte qenë në opozitë, fitoi mbi 50 për qind të votave dhe 58 ulëse nga 120 sa i ka Kuvendi i Kosovës. Qeveria e re e udhëhequr nga lideri i LVV-së, Albin Kurti, u formua më 22 mars 2021. Vjosa Osmani, e cila kishte kandiduar në listën e LVV-së, u zgjodh presidente nga Kuvendi i Kosovës më 4 prill. Që atëherë, LVV-ja kontrollon si degën legislative ashtu edhe atë ekzekutive të qeverisë.

Nga 120 deputetë në Kuvend, 100 përfaqësojnë komunitetin shqiptar të Kosovës, 10 komunitetin serb dhe 10 komunitetet tjera “jo-shumicë” (jo-shqiptare) të Kosovës (sistemi i kuotave është i përcaktuar me

Kushtetutën e vitit 2008). LVV-ja me 59 deputetët e saj¹ është partia më e madhe në Kuvend, e pasuar nga PDK me 18 deputetë, LDK me 15 deputetë, AAK me 8 deputetë dhe LS me 10 deputetë. Koalicioni qeveritar përbëhet nga 59 deputetë nga grupi i LVV-së dhe tetë deputetë që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë.²

Që nga zgjedhjet komunale të vitit 2017 ka pasur dinamika të luhatshme politike në komuna të ndryshme - ndryshimi i koalicioneve, duke mos reflektuar domosdoshmërisht koalicionet e Kuvendit të Kosovës, kryetarët e komunave dhe anëtarët e kuvendeve komunale që kalojnë nga një parti në tjetrën dhe zgjedhje të reja në disa komuna. LS fitoi nëntë kryetarë të komunave në vitin 2017, e pasuar nga LDK me tetë (e humbi një në vitin 2020) dhe PDK me pesë. LVV fitoi tri poste të kryetarit, por humbi dy prej tyre pas një ndarjeje brenda partisë e më vonë e fitoi një. PDK dhe LDK fituan shumicën e vendeve në njëmbëdhjetë dhe tetë kuvende komunale, respektivisht. LS fitoi shumicën në të dhjetë kuvendet e komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Zgjedhjet komunale 2021 përbënin test të rëndësishëm për LVV-në në pushtet dhe mundësi për të zgjeruar fuqinë e saj në nivel lokal. Për partitë kryesore opozitare që kanë dominuar peizazhin politik të Kosovës në periudhën pas konfliktit të armatosur, por që shënuan rezultatet e tyre më të këqija ndonjëherë në zgjedhjet legislative të vitit 2021, këto zgjedhje kishin të bënin me ruajtjen e pozitës së tyre në komuna.

Gjatë periudhës së fushatës para raundit të parë, politika në Kosovë u përqendrua rreth konfliktit mes Beogradit dhe Prishtinës për targat e automjeteve. Më 30 shtator ishte arritur një marrëveshje nën përkujdesjen e BE-së e cila ndër të tjera çoi në tërheqjen e policisë speciale të Kosovës nga veriu dhe vendosjen e KFOR-it, heqjen e bllokadave të rrugës në dy pikat e kalimit dhe një marrëveshje për zgjidhjen e çështjes së targave. Edhe pse kjo çështje ka dominuar hapësirën e informacionit, ajo në përgjithësi nuk ndikoi në fushatën zgjedhore apo në përgatitjet administrative për zgjedhjet. Pak para përfundimit të fushatës për raundin e parë, policia e Kosovës, së bashku me autoritetet doganore, kryen një operacion kundër kontrabandës në disa komuna, përfshirë edhe në Mitrovicën Veriore, aksion që çoi në protesta masive dhe herë-herë të dhunshme.

IV. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË MËHERSHME TË EU EOM-SË

Pothuajse të gjitha rekomandimet e dhëna nga EU EOM-të e mëhershme që nga viti 2013 mbeten të pa adresuara.

Përkundër faktit se të gjitha palët e interesuara e pranojnë nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse zgjedhore, e cila do të përfshinte edhe zbatimin e rekomandimeve të BE-së për zgjedhjet, asnjë reformë e tillë nuk është bërë në Kosovë që kur EU EOM-ja është vendosur për herë të parë në vitin 2013. Një nga pengesat kryesore të cituara nga bashkëbiseduesit e EU EOM-së ishte shpeshësia e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare (të mbajtura pothuajse çdo dy vjet), të cilat nuk i lanë Kuvendit të Kosovës kohë të mjaftueshme për t'i ndryshuar ligjet zgjedhore përmes një mekanizmi konsultativ mjaftueshëm gjithëpërfshirës.

¹ 58 deputetë sipas rezultateve zgjedhore dhe një ish-deputet i PDK-së i cili kaloi në LVV gjatë seancës për zgjedhjen e presidentit.

² Të përbërë nga tre deputetë boshnjakë, dy turq, një rom, një ashkali dhe një egjiptian të Kosovës.

Si pasojë, pothuajse të gjitha rekomandimet e nxjerra nga EU EOM-të e mëparshme, shumica e të cilave kërkonin ndryshime ligjore, mbeten të pa adresuara. Në këto rekomandime ndër të tjera hyjnë adresimi i mospërputhjeve, zbrastëtime dhe paqartësive të kornizës ligjore në tërësi, rishikimi i kriterëve të pranueshmërisë së kandidatëve, rritja e transparencës në financimin e fushatës, zbatimi efektiv i kërkesave për financimin e fushatës, rregullimi i programeve të sponsorizuara politike në mediat elektronike, zgjatja e afateve për paraqitjen dhe marrjen e vendimit për ankesat zgjedhore, kontestimi i rezultateve në të gjitha nivelet, masat plotësuese të sigurisë për votimin jashtë Kosovës, etj.

Disa rekomandime të mëparshme të EU EOM-së që nuk kërkojnë ndryshime ligjore janë zbatuar pjesërisht para këtyre zgjedhjeve, përfshirë me vendime të KQZ-së. Për shembull, Komisioni i Pavarur për Media ka vendosur me kohë ndëshkime ndaj stacioneve televizive për shkelje të rregullave të fushatës zgjedhore dhe është arritur progres në mbrojtjen e të dhënave personale sa i përket listës së votuesve jashtë Kosovës. Megjithatë, në mungesë të një reforme ligjore gjithëpërfshirëse, këto rekomandime nuk janë adresuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të plotë.

V. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Derisa korniza ligjore ofron bazë adekuate për zgjedhjet, ende nuk janë adresuar mangësitë dhe dispozitat kundërthënëse të identifikuara më herët.

Korniza ligjore e zgjedhjeve ofron bazë adekuate për të zhvilluar zgjedhje demokratike, në përputhje me standardet ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar në Kushtetutën e saj. Sipas ligjit themelor të saj, shtatë instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut³ që janë me rëndësi për zgjedhjet janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe, në rast konflikti, kanë epërsi ndaj ligjeve të Kosovës. Për më tepër, gjykatave u kërkohet t'i interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁴

Zgjedhjet komunale të vitit 2021 ishin të rregulluara kryesisht me Kushtetutën e vitit 2008, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të vitit 2008 (ndryshuar së fundmi në vitin 2010) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale (LZL) të vitit 2008.⁵ Përveç kësaj, aspekte të rëndësishme të procesit zgjedhor janë përfshirë në njëzet

³ Sipas nenit 22 të Kushtetutës, këto janë: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ); Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (KEDNJ); Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj (ICCPR); Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD); Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW), dhe që nga viti 2020, konventa e Këshillit të Evropës për luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).

⁴ Edhe pse nuk është shtet nënshkrues i asnjë traktati ndërkombëtar, më 11 qershor 2014, Kosova iu bashkua Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisionit të Venedikut), kështu që Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venedikut i vitit 2002 zbatohet edhe në Kosovë.

⁵ Legjislacionet tjera të aplikueshme përfshijnë Ligjin për financimin e subjekteve politike dhe fushatave zgjedhore (i vitit 2010, i ndryshuar në vitin 2013), Ligjin për partitë politike (2004), Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë (LMPDK), Ligjin për përdorimin e gjuhëve; Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale; Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligjin për Procedurën Administrative dhe Kodin Penal të vitit 2019.

rregullat e KQZ-së dhe jo në ligjin primar.⁶ Kjo nuk ofron garanci ndaj ndryshimeve të mundshme në momentin e fundit, në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.⁷

E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale është e garantuar me Kushtetutë dhe me Ligjin e vitit 2010 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDHP), i ndryshuar në thelb në vitin 2019 në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR).⁸ Pavarësisht disa zhvillimeve pozitive, korniza ligjore e zgjedhjeve nuk është plotësisht e harmonizuar me LMDHP-në, për shembull në lidhje me sigurimin e përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave dhe ruajtjen dhe shkatërrimin e të dhënave.⁹ Autoriteti përgjegjës për sigurimin e pajtueshmërisë me parimet e mbrojtjes së të dhënave, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP), u bë plotësisht funksionale në qershor 2021 kur u emërua përfundimisht Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror i saj.¹⁰

Me pak përjashtime, korniza ligjore e zgjedhjeve mbetet në thelb e pandryshuar nga viti 2010. Dobësitë afatgjate, përfshirë mangësitë dhe dispozitat kundërthënëse në tërë ciklin zgjedhor, kanë të bëjnë, mes tjerash, me: pranueshmërinë e kandidatëve, rregullat e fushatës zgjedhore, mungesën e mbikëqyrjes dhe zbatimit efektiv të financimit të partive politike dhe fushatave, procesin e votimit jashtë Kosovës, mangësitë në zgjidhjen e kontesteve zgjedhore, rregullat e fushatës në platformat online, përfaqësimin e pamjaftueshëm të grave në strukturat e partive politike dhe në pozitat e zgjedhura me votë, etj.

SISTEMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet komunale mbahen çdo katër vjet për t'i zgjedhur kryetarët e komunave dhe anëtarët e kuvendeve komunale. Kryetarët e 38 komunave zgjedhen drejtpërdrejt nga votuesit e komunës në një sistem të shumicës me dy raunde. Anëtarët e kuvendeve komunale zgjedhen sipas sistemit të përfaqësimit proporcional, me lista të hapura, ku votuesit votojnë për një subjekt politik dhe mund të shënojnë një kandidat preferencial tjetër nga bartësi i listës, i cili automatikisht i merr votat e subjektit politik.

Numri i ulëseve në kuvendet komunale është proporcional me numrin e banorëve në komunë, që sillet nga 15 deri në 41, me përjashtim të Prishtinës, e cila i ka 51 anëtarë. Një kuotë gjinore prej të paktën 30 për qind të gjinisë më pak të përfaqësuar aplikohet si për certifikimin e subjekteve politike ashtu edhe për shpërndarjen e mandateve në kuvendet komunale dhe në Kuvendin e Kosovës.¹¹

⁶ Rregulloret e punës së PZAP-së dhe KQZ-së ndër të tjera kanë të bëjnë me rregullat e fushatës, regjistrimin e partive politike, votimin jashtë Kosovës dhe numërimin dhe tabelimin.

⁷ Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venedikut, Seksioni II, 2, a. “Përveç rregullave për çështje dhe detajet teknike – të cilat mund të përfshihen në rregulloret e ekzekutivit – rregullat e ligjit zgjedhor duhet të kenë së paku nivelin e një statuti.” Statutet miratohen nga dega legjislativë dhe ndryshohen me të njëjtin proces ashtu siç janë miratuar në fillim.

⁸ Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (BE) (GDPR) 2016/679 u bë drejtpërdrejt e zbatueshme në Bashkimin Evropian më 25 maj 2018.

⁹ Në vitin 2021, KQZ-ja miratoi një rregullore që adresonte disa mangësi në mbrojtjen e të dhënave që kishin të bënin me listën e votuesve jashtë Kosovës dhe PZAP-ja caktoi një zyrtar për mbrojtjen e të dhënave.

¹⁰ Kuvendi i Kosovës emëroi komisionerin pas tri përpjekjeve të dështuara nga viti 2019.

¹¹ Për shembull, për kuvendin komunal, ulëset fillimisht i ndahen një subjekti politik sipas rezultateve të zgjedhjeve. Por nëse kjo ndarje nuk respekton kuotën prej 30 për qind për gjininë pakicë, atëherë kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë do të zëvendësohet nga kandidati tjetër i radhës i gjinisë pakicë për të arritur kuotën prej 30 për qind.

VI. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Përbërje gjithëpërfshirëse e KKZ-ve dhe KVV-ve dhe përgatitje me kohë e zgjedhjeve në përputhje me afatet ligjore.

Zgjedhjet komunale u administruan nga një strukturë e administratës së zgjedhjeve me tri nivele e përbërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), 38 Komisione Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe 2,505 Këshilla të Vendvotimeve (KVV) të vendosura në 883 Qendra të Votimit.

KQZ-ja, e përbërë nga një kryetar dhe dhjetë anëtarë, është krijuar si autoritet i përhershëm i pavarur me mandat për të administruar zgjedhjet dhe referendumet në mënyrë profesionale dhe të paanshme.¹² Përderisa mandati i kryetarit së saj është shtatë vjet, anëtarët nuk emërohen për mandat të përcaktuar pasi mandati i tyre është i lidhur me ciklin zgjedhor.¹³ Menaxhimi i operacioneve zgjedhore i është besuar Sekretariatit të KQZ-së (SKQZ), i cili është përballur me probleme të mëdha të hapësirës së kufizuar të zyrave dhe mungesës së stafit të përhershëm.¹⁴

Pas zgjedhjeve të parakohshme legjislativ të 14 shkurtit 2021 dhe zgjedhjes së më pastajme të Presidentes së re të Kosovës më 4 prill, më 12 maj u emëruan tetë anëtarë të rinj të KQZ-së, pas propozimit nga subjektet politike që kishin këtë të drejtë.¹⁵ Duke pretenduar se ka paqartësi ligjore,¹⁶ Presidentja e Kosovës është përmbajtur nga emërimi i dy anëtarëve të fundit dhe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (GJK) me kërkesë për interpretim të kësaj dispozite. GJK e hodhi poshtë kërkesën më 2 korrik dhe rrjedhimisht PDK emëroi një anëtar të dytë dhe VAKAT (komuniteti boshnjak) emëroi një, gjë që çoi në plotësimin e përbërjes së KQZ-së më vonë se afati ligjor.¹⁷

LZP përfshin garanci për pavarësinë dhe transparencën në funksionimin e KQZ-së, siç është mandati shtatëvjeçar i kryetarit, që mund të vazhdohet vetëm një herë, dhe dispozita që sigurojnë që komisionerët nuk mund të hiqen për ndonjë lëshim të vogël, duke ulur kështu mundësinë për ndërhyrje politike. Megjithatë, formulimi i paqartë i paragrafit (d) të nenit 61.5 të LZP-së që lejon largimin e kryetarit ose një anëtarë nëse ata sillen ose veprojnë “në atë mënyrë që e dëmton seriozisht statusin dhe integritetin e KQZ-së”¹⁸ nuk është në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare të cilat përcaktojnë se arsyet

¹² Neni 139, paragrafi 1 i Kushtetutës.

¹³ Sipas nenit 61.4 të LZP-së, mandati i anëtarëve të KQZ-së “fillon jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend”. I vetmi përjashtim është në nenin 61 paragrafi 3 (e) i LZP-së, që parashikon vazhdimin automatik të mandatit deri në 90 ditë pas certifikimit të rezultateve, nëse ai skadon 90 ose më pak ditë para zgjedhjeve ose deri në 90 ditë pas certifikimit të rezultateve.

¹⁴ Veçanërisht katër departamente të SKQZ-së kanë vetëm një punonjës: këto janë departamenti i Koordinimit në terren, TI-së, Trajnimit dhe Logjistikës.

¹⁵ Tetë anëtarët e rinj u emëruan si vijon: dy nga LVV dhe një nga LDK, PDK, AAK, IRDK (Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian), KDTP (komuniteti turk) dhe *Lista Serbe* (komuniteti serb).

¹⁶ Çështja kishte të bënte me nenin 139 paragrafin 4 të Kushtetutës në lidhje me “grupet më të mëdha parlamentare” që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të KQZ-së. Kjo çështje tashmë ishte sqaruar nga Gjykata në të kaluarën, e cila kishte vendosur se “përbërja e KQZ-së synon të pasqyrojë përbërjen e Kuvendit sipas rezultateve të zgjedhjeve, që do të thotë se subjektet politike që kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe që kanë fituar numrin më të madh të vendeve në Kuvend kanë të drejtë të drejtojnë anëtarë të KQZ-së të cilët emërohen nga Presidenti”.

¹⁷ Afati i fundit ishte 12 maj 2021.

¹⁸ Sipas nenit 61.5 të LZP-së, mandati i kryetarit të KQZ-së ose i çdo anëtarë mund të ndërpritet në këto rrethana: a) anëtarë dështon në plotësimin e kushteve dhe kriterëve që dalin nga ky ligj, b) anëtarë nuk merr pjesë, pa ndonjë motiv të arsyeshëm, në tri mbledhje të njëpasnjëshme të KQZ-së dhe ndërprerja e mandatit miratohet nga dy të tretat (2/3) e votave të shumicës së KQZ-së, c) anëtarë është i dënuar për veprë penale, d) anëtarë sillet ose vepron në atë mënyrë që e dëmton

për largim duhet të jenë “të përcaktuara qartë dhe në mënyrë kufizuese në ligj.”¹⁹

Veçanërisht, vendimi i Presidentes së Kosovës për shkarkimin e ish-kryetares së KQZ-së më 14 qershor, katër vjet para skadimit të mandatit të saj të dytë dhe vetëm një ditë para shpalljes së zgjedhjeve për kryetarë dhe kuvende komunale, u konsiderua nga partitë opozitare dhe shoqëria civile si i motivuar politikisht. Në këtë vendim ndër të tjera pretendohet se kryetarja kishte dëmtuar pavarësinë dhe integritetin e KQZ-së, kishte ushtruar presion të paprecedent mbi stafin e KQZ-së në njërin nga mbledhjet dhe se KQZ-ja kishte shpërfillur problemet që lidhen me listat e votuesve, trajnimin e komisionerëve dhe edukimin e votuesve. Edhe pse Avokati i Popullit hodhi poshtë kërkesën e ish-kryetares së KQZ-së, e cila kundërshtoi shkarkimin e saj, është e diskutueshme nëse arsyetimi i vendimit për shkarkim do të çonte në një përfundim të besueshëm rreth përgjegjësisë së kryetares së KQZ-së.²⁰

Rekomandimi: Ndryshimi i LZZP-së për të përcaktuar qartë dhe në mënyrë kufizuese arsyet për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të KQZ-së.

KKZ-të u formuan brenda 15 ditësh nga shpallja e zgjedhjeve, në përputhje me afatin ligjor. Emërimi i anëtarëve të KVV-ve u bazua në një formulë të përpunuar nga KQZ-ja, që reflekton strukturën e anëtarëve të KKZ-së që në përgjithësi balanconte kompleksitetin e përfaqësimit të subjekteve politike në Kuvendin e Kosovës dhe në kuvendet komunale, si dhe u përpoq të sigurojë përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë me prani të konsiderueshme në një komunë. Gratë ishin të nënpërfaqësuar në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore (*Shih Pjesëmarrja e Grave*).

PËRGATITJET PËR ZGJEDHJE

Diskutimet gjatë mbledhjeve të KQZ-së ku mori pjesë EU EOM-ja u zhvilluan në atmosferë kolegjiale, të hapur për mediat dhe vëzhguesit; vëzhguesit e EU EOM-së vërejtën po ashtu bashkëpunim të mirë ndërmjet anëtarëve të KKZ-ve.²¹ Shumica e vendimeve të KQZ-së janë miratuar në mënyrë unanime; megjithatë, ato as nuk u postuan në faqen zyrtare të internetit në mënyrë të vazhdueshme e as brenda një

seriozisht statusin dhe integritetin e KQZ-së, e) anëtari nuk është në gjendje t'i kryej detyrat e veta për më shumë se gjashtë muaj me radhë.

¹⁹ Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit Evropian për Demokracinë Përmes Ligjit (“Komisioni i Venedikut”), thekson në pikën 3.1f se “*Organet që caktojnë anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve nuk duhet të kenë dorë të lirë për t'i shkarkuar ata sipas dëshirës*”, ndërsa paragrafi 77 thotë se “*Përgjithësisht, organet që emërojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore nuk duhet të jenë të lira t'i shkarkojnë ata sa herë të duan, sepse kjo ngre dyshime për pavarësinë e tyre. Shkarkimi sipas diskrecionit është i papranueshëm, por shkarkimi për arsye disiplinore është i lejueshëm – me kusht që arsyet për këtë të jenë të qarta dhe të mbështetura në mënyrë rigorozë në ligj (arsye të paqarta të natyrës “akte që diskreditojnë komisionin” nuk janë të mjaftueshme).*”

²⁰ Për shembull, vendimi specifik nuk merr parasysh, ndër të tjera, se kryetari i KQZ-së nuk ka votë vendimtare në vendimet e miratuara nga KQZ-ja, për të cilat ishte akuzuar për veprim të gabuar, siç është mënyra e verifikimit të kërkesave për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës, për miratimin e të cilës kanë votuar njëzëri të gjithë anëtarët e KQZ-së, e cila po ashtu do të ishte *in pari delicto*. “Rekomandimet e vazhdueshme nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare për përmirësim të procesit”, të cilat kryetarja akuzohet se i ka shpërfillur, kërkojnë ndryshime ligjore që janë jashtë kompetencës së kryetares së KQZ-së. Ose, arsyeja tjetër e shkarkimit që thotë se “ish-kryetarja ka kontribuar në përshkallëzimin e situatës gjatë mbledhjeve të KQZ-së”, nuk është në përputhje me atë që është raportuar nga të gjitha misionet e vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtarë lidhur me sulmet verbale dhe obstrukcionet nga disa anëtarë të KQZ-së gjatë mbledhjeve.

²¹ Me përjashtim të KKZ-së në Graçanicë, ku ekipi i vëzhguesve afatgjatë raportoi se anëtarët e tij që përfaqësonin partitë politike shqiptare dukej se ishin të paangazhuar në proces dhe kryesuesi punonte kryesisht vetëm.

kohe të arsyeshme nga miratimi i tyre.²² Bashkëbiseduesit e EU EOM-së në përgjithësi shprehën siguri dhe besim në aftësinë e administratës së zgjedhjeve për të kryer detyrat e tyre në mënyrë profesionale.²³ Shumë anëtarë të KKZ-ve kishin përvojë të mëhershme me zgjedhjet.

Menaxhimi i operacioneve nga SKQZ u vlerësua pozitivisht nga të gjithë bashkëbiseduesit e EOM-së. SKQZ-ja i respektoi të gjitha afatet ligjore dhe përgatitjet në nivel qendror dhe komunal u kryen sipas planit operacional të KQZ-së,²⁴ përveç trajnimit të anëtarëve të KVV-ve, i cili u vonua shumë për shkak të komplikimeve me tenderin për shtypjen e manualeve të trajnimit.²⁵ Sidoqoftë, kjo nuk ndikoi në kohëzgjatjen e trajnimit.²⁶ Megjithatë, siç vërejtën vëzhguesit e BE-së, informacioni që u dha gjatë trajnimit në lidhje me përdorimin e dokumenteve të skaduara të identifikimit nuk ishte gjithmonë konsistent.

Kufizimet e qeverisë në lidhje me pandeminë COVID-19 bënë që administrata zgjedhore të kufizojë numrin e pjesëmarrësve në trajnime dhe pjesëmarrësve në mbledhjet e KKZ-ve dhe të inkurajojë vaksinimin e të gjithë stafit zgjedhor dhe vëzhguesve. Votuesit në karantinë për shkak të COVID-19 u lejuan të votojnë nga shtëpia, pas verifikimit nga KQZ-ja të të dhënave të tyre dhe informacioneve të marra nga autoritetet shëndetësore.²⁷ Në respektim të LMDHP-së, lista e votuesve të tillë nuk është bërë publike, por vetëm u është shpërndarë ekipeve mobile që kryenin votimin nëpër shtëpi.

Për raundin e dytë, KQZ-ja zgjati për katër ditë deri me 9 nëntor regjistrimin e votuesve me nevoja të veçanta (VNN) që detyrohen të qëndrojnë në shtëpi.²⁸ Edhe pse e rriti gjithëpërfshirjen e procesit, ky vendim nuk mori parasysh ndikimin e mundshëm në KKZ në rast të rritjes së madhe të numrit të votuesve me nevoja të veçanta dhe përgatitjes së ekipeve mobile, pasi afati i ri ishte më pak se një javë para ditës së zgjedhjeve.

Pas raundit të parë, KQZ-ja miratoi një formulë të re të përbërjes së KVV-ve për të siguruar që kandidatët raundin e dytë të përfaqësoheshin në KVV. Ajo po ashtu organizoi trajnime shtesë, si për anëtarët që tashmë kishin punuar në raundin e parë ashtu edhe për anëtarët e rinj të KVV-ve, pas zëvendësimit të 806 anëtarëve nga KQZ-ja dhe disa anëtarëve të tjerë të KVV-ve nga disa subjekte politike për shkak të performancës së dobët gjatë numërimit dhe pasaktësive në plotësimin e formularëve të rezultateve.

Rekomandim: Të krijohet një pozitë administrative jopartiake e sekretarit të KVV-së për të ofruar këshilla dhe asistencë të nevojshme për KVV-në për të përmirësuar efikasitetin dhe performancën e tyre.

²² Vendimet u publikuan herë pas here në faqen e KQZ-së, ndërsa disa vendime të miratuara në gusht 2021 nuk u publikuan deri në fillim të dhjetorit.

²³ Deri më tani, vetëm kandidatët që garojnë në zgjedhjet për kryetar të komunës së Dragashit i shprehën shqetësimet ekipit të vëzhguesve afatgjatë për neutralitetin e KKZ-së lokale.

²⁴ Plani operacional i KQZ-së për raundin e parë u miratua më 17 qershor dhe për raundin e dytë më 10 nëntor.

²⁵ Shtypja e manualeve të trajnimit dhe formularëve të rezultateve, furnizimi me pajisje mbrojtëse kundër COVID-19 dhe dokumentet identifikuese për vëzhguesit u prokuruan nga KQZ-ja në një tender të hapur në qershor 2021. Mirëpo, për shkak të ankesave të dorëzuara në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) nga kompanitë që humbën, nënshkrimi i kontratave ishte pezulluar në pritje të vendimeve të OSHP-së, ndërsa në të njëjtën kohë OSHP-ja kishte qenë jofunksionale nga marsi i vitit 2021. Në mbledhjen e datës 2 tetor, anëtarët e KQZ-së vendosën njëzëri që të fillojnë negociatat për shtypjen dhe furnizimin e materialeve me fituesit e tenderëve, siç e lejon Ligji për Prokurimet Publike në raste shumë urgjente.

²⁶ Trajnimi i anëtarëve të KVV-ve, i planifikuar për t'u zhvilluar mes 3 dhe 15 tetorit, filloi më 9 tetor.

²⁷ Udhëzimi Administrativ i KQZ-së Nr.01/2020.

²⁸ Vendimi KQZ Nr.2976/5-11-2021.

EDUKIMI I VOTUESVE

KQZ-ja filloi të ofrojë informacione për votuesit në qershor 2021 në mediat tradicionale dhe ato sociale,²⁹ ku i tërë materiali ishte zhvilluar në pesë gjuhë të ndryshme.³⁰ Në zbatim të rekomandimeve të mëparshme të EU EOM-ve,³¹ u prodhuan radio dhe video spote për secilën pjesë të procesit, si certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve, akreditimi i vëzhguesve, regjistrimi i votuesve, kontestimet e listës së votuesve, regjistrimi i personave me nevoja të veçanta, dokumentet e pranuar për identifikimin e votuesve, shenjimi i fletëvotimit, regjistrimi dhe votimi jashtë Kosovës dhe masat mbrojtëse kundër COVID-19. Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të EU EOM-ve, fokus i veçantë i është kushtuar informimit të votuesve se si t'i plotësojnë siç duhet fletëvotimet e tyre dhe, sipas KQZ-së, është rritur frekuenca e transmetimit dhe publikimit të këtyre informacioneve. Derisa video spotet në të gjitha gjuhët përfshinin edhe gjuhën e shenjave, siç kërkohet me nenin 108.2 të LZP-së, nuk kishte material për edukimin e votuesve në alfabetin Braille. Për këto zgjedhje, Shoqata e të Verbërve të Kosovës ka trajnuar rreth 1,200 votues me shikim të dëmtuar në mbarë Kosovën se si t'i shenjojnë fletëvotimet e tyre me prekje.

Pavarësisht se neni 107.3 i LZP-së udhëzoi KQZ-në që gjatë zhvillimit të fushatës për edukimin e votuesve “t'i kushtojë vëmendje të veçantë votuesve në zonat rurale, me aftësi të kufizuara dhe analfabetë”, aktivitetet e kryera nga KKZ-të, të cilat kanë qasje dhe i kuptojnë më mirë nevojat e votuesve në zonat rurale në komunat e tyre, ishin të kufizuara në vendosjen e afisheve informuese të dërguara nga KQZ-ja. Pandemia nuk lejoi aktivitete derë më derë siç ishte bërë në të kaluarën.

Rekomandim: Tu jepen më shumë përgjegjësi KKZ-ve lidhur me edukimin dhe informimin e votuesve si dhe të angazhohen organizatat e shoqërisë civile në mbarë Kosovën. Duhet të adresohen grupe të veçanta të synuara, si gratë, votuesit në zonat rurale, votuesit për herë të parë dhe personat me aftësi të kufizuara.

Edhe pse ka pasur një përmirësim të lehtë krahasuar me zgjedhjet komunale të vitit 2017 për sa i përket përqindjes së fletëvotimeve të pavlefshme, të cilat në raundin e parë arritën në pothuajse 7 për qind në zgjedhjet për kuvendet komunale dhe 1.6 për qind për zgjedhjet për kryetarë të komunave, të gjithë bashkëbiseduesit e EU EOM-së theksuan se aktivitetet e informimit të votuesve ishin të pamjaftueshme (*Shih* Tabelimi i rezultateve).³² Këtë e dëshmoi edhe përqindja e lartë e votimit me asistencë në të dy raundet, nën arsyetimin e mosnjohjes së procedurave të votimit, gjë që nuk përfshihet në mesin e arsyeve për votim me asistencë në LZP.

VII. REGJISTRIMI I VOTUESVE

²⁹ KQZ nënshkroi marrëveshje për shpërndarjen e materialeve me gjashtë portale lajmesh, tri stacione televizive kombëtare, tri stacione kombëtare të radios, tri stacione televizive kabllore dhe shtatë stacione televizive rajonale, si dhe përdori llogaritë e vet në Facebook, Instagram dhe YouTube për tua shpërndarë informacionin votuesve, përfshirë edhe përmes përmbajtjes së sponsorizuar.

³⁰ Në gjuhën shqipe, serbe, turke, boshnjake dhe rome.

³¹ Këto rekomandime u propozuan nga EU EOM-të në vitet 2013, 2014 dhe 2017.

³² Numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pavlefshme në zgjedhjet komunale ishte 8.7 për qind ku përqindja e fletëvotimeve të pavlefshme në zgjedhjet për kryetarë të komunave ishte 2.6 për qind, përfshirë edhe fletëvotimet e zbrazëta.

Listë përfundimtare e plotë dhe gjithëpërfshirëse e votuesve, por nevojiten përpjekje të mëtejshme të vazhdueshme për të përmirësuar saktësinë e saj, përfshirë edhe për procesin jashtë Kosovës.

Sipas nenit 45 të Kushtetutës, “çdo shtetas (...) që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.” LZP-ja e zgjeron të drejtën e votës jo vetëm për qytetarët e regjistruar në Regjistrin Qendror Civil, por edhe për personat që banojnë “jashtë Kosovës ose kanë lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t’i plotësojnë kriteret për të qenë qytetar i Kosovës”, si dhe për personat që “kanë fituar statusin e refugjatit në apo pas 1 janarit 1995, dhe kanë të drejtë për t’u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil”. Kufizimet e të drejtës për të votuar aplikohen për personat e shpallur të paafte mendërisht me vendim gjyqësor të formës së prerë, personat që janë duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) ose ata të akuzuar nga TPNJ që kanë dështuar t’i binden urdhrat për t’u paraqitur para Tribunalit.

Ekziston një sistem i regjistrimit “pasiv” të votuesve, bazuar në ekstraktet e paraqitura në KQZ nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) në tri intervale të ndryshme. Megjithatë, fakti që këto ekstrakte e kanë origjinën nga baza e të dhënave të dokumenteve të prodhuara të identifikimit, e cila përfshin edhe personat e vdekur dokumenti i identifikimit i të cilëve është ende i vlefshëm, ose personat që kanë hequr dorë nga shtetësia por janë ende në posedim të letërnjoftimeve të tyre, në vend se ta kenë në bazën e të dhënave të Regjistrit Qendror të Gjendjes Civile që tregon personat që kanë vdekur, çon në pasaktësi.³³

Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV) përmbante gjithsej 1,885,448 votues, që paraqet një rritje prej 90,586 votuesish (ose 5 për qind) krahasuar me zgjedhjet legislative të shkurtit 2021.³⁴ Rritja është si rezultat i personave që arrijnë moshën madhore dhe që fitojnë të drejtën për të votuar, shtimit të 7,378 poseduesve të letërnjoftimeve të vjetra të UNMIK-ut që morën letërnjoftime të Kosovës pas një vendimi të KQZ-së të shkurtit 2021 për të hequr nga lista e votuesve të gjithë votuesit e regjistruar me letërnjoftime të UNMIK-ut,³⁵ dhe i përfshirjes së sërishme të një numri të konsiderueshëm të votuesve që ishin regjistruar me sukses në janar për votim jashtë Kosovës.³⁶ KQZ-ja hoqi të dhënat e 18,252 personave të vdekur dhe për herë të parë hoqi edhe ata që kishin hequr dorë nga shtetësia e tyre kosovare.³⁷

³³ Arsyeja që ekstraktet e dorëzuara në KQZ vijnë nga baza e të dhënave të letërnjoftimeve të prodhuara është se menjëherë pas luftës, UNMIK-u filloi krijimin e regjistratit të qytetarëve, i cili më pas përdorej për prodhimin e letërnjoftimeve. Për disa vite ajo ishte konsideruar si baza më e besueshme e të dhënave.

³⁴ Numri i votuesve për herë të parë që kishin mbushur moshën 18 vjeç pas zgjedhjeve paarrake arrin në 24,697, ndërsa votues të përfshirë për herë të parë në Regjistrin Qendror Civil ishte 8,937.

³⁵ Letërnjoftimet e UNMIK-ut u janë lëshuar nga nëntori i vitit 2000 “banorëve të rezident të Kosovës” mbi moshën 16 vjeçare pas regjistrimit në Regjistrin Qendror Civil (RQC). Si banorë rezidentë janë definuar ata persona që kanë lindur, ose njëri prind i të cilëve ka lindur në Kosovë, ose ata që mund të dëshmonin se kanë banuar në Kosovë për të paktën pesë vjet me radhë.

³⁶ Vëzhguesit e BE-së në komunat veriore u informuan për raste të serbëve të Kosovës që u përballën me vështirësi në marrjen e letërnjoftimit të lëshuar nga Kosova. Sipas ARC-së, aplikimi për dokument identifikimi të Kosovës është i mundur vetëm në tri fshatra në komunat veriore, gjegjësisht në Bistricë në Leposaviq, në Lipë në Zvečan dhe Çabër në Zubin Potok.

³⁷ Vendimi i KQZ-së Nr.1935/12.08.2021.

Duke adresuar një rekomandim të EU EEM 2021³⁸ lidhur me mbrojtjen e pamjaftueshme të të dhënave të qytetarëve në publikimin e listës së votuesve jashtë Kosovës, KQZ-ja vendosi që datën e lindjes ta zëvendësojë me vitin e lindjes.³⁹

Pas vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 14 korrik 2021 për vazhdimin e vlefshmërisë së letërnjoftimeve të skaduara të Kosovës edhe për gjashtë muaj për shkak të mungesës së prodhimit, KQZ-ja vendosi t'i pranojë këto letërnjoftime të skaduara për regjistrim dhe votim për votuesit jashtë Kosovës dhe për identifikimin e votuesve në qendrat e votimit në ditën e zgjedhjeve.⁴⁰ Megjithatë, ky vendim nuk u aplikua edhe për pasaportat e Kosovës dhe patentë shoferët e skaduar.

Saktësia e listës së votuesve ka qenë një pikë kryesore e mosmarrëveshjes në të gjitha zgjedhjet e kaluara, kryesisht për shkak të raportimit se një numër i madh i personave të vdekur janë në listë. Një përditësim i plotë i listës së votuesve u bë midis zgjedhjeve legislative të vitit 2019 dhe 2021, gjë që çoi në heqjen e rreth 143,000 votuesve (rreth 7 për qind e listës së vitit 2019).⁴¹

Analizën e listës së votuesve e pengon fakti se nuk ka të dhëna të sakta për popullsinë në komunat serbe të Kosovës, ku ishte bojkotuar regjistrimi i popullsisë në vitin 2011. Analiza nga EU EOM-ja e të dhënave për votuesit e moshuar konfirmon se ka pasur përparim në heqjen e personave të vdekur. Megjithatë, procesi i pastrimit [të listës] nuk ka qenë uniform, ku komunat më të mëdha duket se kanë qenë më efikase se sa ato më të voglat. Sfidat e mëtejshme për saktësinë e listës së votuesve kanë të bëjnë me mungesën e një sistemi unik të adresave në Kosovë, pasi ekstraktet e Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC) nuk përfshijnë kodet e rrugëve, dhe mungesën e një sistemi standard që do të përdorej nga niveli komunal dhe qendror për emërtimin e rrugëve.⁴²

Rekomandim: Të fillojë të aplikohet një mekanizëm për heqjen automatike të personave të vdekur nga regjistri civil dhe nga baza e të dhënave të letërnjoftimeve të lëshuara pasi ARC-ja të ketë marrë informatën nga spitalet dhe institucionet fetare.

Rekomandim: Të përshpejtohet zhvillimi i një sistemi unik të adresave për të bërë më të saktë caktimin e votuesve në qendrat e votimit.

Ndonëse e pranuan se lista e votuesve mund të përmirësohet edhe më tej, bashkëbiseduesit e EU EOM-së nuk konsideruan se mos saktësia mund të përdorej për manipulim në ditën e zgjedhjeve; megjithatë ajo mbetet një çështje shqetësuese për shumicën e palëve të interesuara.

REGJISTRIMI I VOTUESVE JASHTË KOSOVËS

Banorët e përhershëm të Kosovës të regjistruar në Regjistrin Qendror Civil dhe që banojnë përkohësisht jashtë vendit, si dhe ata që janë regjistruar si votues jashtë Kosovës për zgjedhjet e mëparshme, mund t'ia parashtrajnë një kërkesë me email KQZ-së për t'u përfshirë në Regjistrin e votuesve jashtë Kosovës për

³⁸ Të “harmonizohet legjislacioni i zgjedhjeve dhe rregullat e KQZ-së me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve për privatësinë e të dhënave të tyre personale”.

³⁹ Vendimi i KQZ-së Nr.2004/24.08.2021.

⁴⁰ Vendimi i KQZ-së Nr.1948/12.08.2021.

⁴¹ 133,000 prej atyre që ishin larguar ishin posedues të letërnjoftimeve të vjetra të UNMIK-ut.

⁴² Agjencia Kadastrale e filloi në vitin 2010 zbatimin e një projekti të financuar nga BE-ja për të krijuar një sistem të adresave, i cili po ashtu do të krijonte kodet e rrugëve. Projekti është duke vazhduar ende.

zgjedhjet komunale, që është një procedurë e vështirë e cila në mënyrë të pashmangshme çon në gabime.⁴³ Për këto zgjedhje, periudha 40-ditore e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës zgjati prej 10 korrikut deri më 18 gusht 2021; periudha e konfirmimit dhe ankesave ishte nga 24 gushti deri më 7 shtator. KQZ-ja pranoi 18,852 aplikacione, nga të cilat 3,320 i refuzoi për shkak se aplikuesit nuk i plotësonin kriteret e përshtatshmërisë, ishin nën moshën 18 vjeç dhe/ose kishin hequr dorë nga shtetësia e tyre kosovare.

Pas tërheqjes së vendimit të saj të kontestuar të marrë gjatë zgjedhjeve të shkurtit 2021 për verifikimin përmes telefonit të të gjitha aplikacioneve për regjistrim jashtë Kosovës, KQZ-ja miratoi një vendim tjetër për të verifikuar në mënyrë të rastësishme vetëm dy për qind të të gjitha aplikacioneve. Përveç kësaj, u verifikuan aplikacionet që kishin përdorur të njëjtin numër të telefonit ose adresë të emailit për aplikuesit me më shumë se dy mbiemra të ndryshëm, si dhe ato raste që SKQZ-ja i konsideronte të dyshimta. Përkundër përpjekjeve të KQZ-së për të parandaluar çdo veprim mashtrues në lidhje me regjistrimin e votuesve për votim jashtë Kosovës, kjo metodë e verifikimit nuk mund të garantojë plotësisht integritetin e procesit.

Gjithsej 1,172 e të gjitha aplikacionet të refuzuara ishin dorëzuar nga aplikuesit me banim në Mal të Zi nga llogari të postës elektronike që konsideroheshin të dyshimta dhe që nuk mund të verifikoheshin për shkak të mos përgjigjes së vazhdueshme në telefonata, numrave joekzistues të telefonit ose personave që u përgjigjën duke thënë se nuk kishin aplikuar.⁴⁴ Gjithsej 583 nga refuzimet janë kontestuar në PZAP, e cila ka hedhur poshtë 561 dhe ka miratuar 22, duke urdhëruar KQZ-në t'i përfshijë këta aplikues në listën e votuesve jashtë Kosovës. EU EOM-ja shqyrtoi 265 vendime të përzgjedhura rastësisht të PZAP-së dhe i vlerësoi ato si të arsyeshme dhe të justifikuar.⁴⁵

Për këto zgjedhje, lista e votuesve jashtë Kosovës përbante 15,532 votues, që paraqet 0.82 për qind të numrit të përgjithshëm të votuesve.⁴⁶ Aplikuesit e regjistruar mund të votonin me postë prej 15 shtatorit deri me 15 tetor për raundin e parë, ndërsa për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, periudha e votimit u zhvillua nga 29 tetori deri më 12 nëntor. Për t'u konsideruar të vlefshme dhe për t'u përfshirë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, fletëvotimet prej jashtë Kosovës duhej të pranoheshin 24 orë para ditës së zgjedhjeve.⁴⁷ Ruajtja e zarfeve me fletëvotime deri në tabelimin e tyre në QNR ishte siguruar nga Ministria e Infrastrukturës.

Rekomandim: Të modernizohet metoda e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, për shembull përmes një vegëze (link) në faqen e internetit të KQZ-së me masa të sigurisë, siç është verifikimi me dy hapa i

⁴³ Siç deklaruan disa punonjës të stafit të SKQZ-së, metoda e aplikimit për votim jashtë Kosovës përmes postës elektronike pashmangshëm çon në gabime njerëzore kur futen në mënyrë manuale të dhënat e aplikuesve në sistem.

⁴⁴ Bazuar në vendimin e KQZ-së nr.1977/2021 të datës 18.08.2021, i cili mundëson refuzimin e aplikuesve të dyshimtë, të cilët nuk mund të kontaktohen përmes numrit të telefonit që e kanë dhënë.

⁴⁵ Nga 260 ankesat e refuzuara, 254 ishin nga Mali i Zi, ndërsa nga të tjerat dy ishin nga SHBA-ja, tri nga Austria dhe një nga Gjermania. Vetëm tri prej tyre përfshinin ca dokumente mbështetëse por PZAP-ja nuk i konsideroi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimin e tyre. PZAP-ja konstatoi se aplikimi i ankuesve për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës ishte i pakompletuar dhe se ata nuk i plotësonin kriteret e përcaktuara në nenin 5.1.a të LZP-së dhe nenin 3.1 të Rregullores 03/2013.

⁴⁶ Gjermania me 37.1 për qind të aplikacioneve dhe Zvicra me 31.9 për qind përbënin mbi dy të tretat e votuesve jashtë Kosovës; e treta, Austria, përbënte vetëm 5.9 për qind të aplikacioneve. Në anën tjetër, vetëm njëzet aplikacione jashtë Kosovës janë pranuar nga Serbia.

⁴⁷ Ligjshmëria e kërkesës për dorëzimin e fletëvotimeve prej jashtë Kosovës pas afatit 24 orë para zgjedhjeve është kundërshtuar në të kaluarën nga PZAP dhe Gjykata Supreme, ku në fund Gjykata Kushtetuese kishte vendosur njëzëri më 5 janar 2021 se afati ligjor për arritjen e votave nga jashtë ishte në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës.

aplikuesve në mënyrë që të sigurohet mbrojtja nga mashtrimi dhe nga paraqitja e personave në emër të dikujt tjetër.

VIII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Regjistrimi i kandidatëve ishte gjithëpërfshirës përkundër disa mangësive procedurale, por ligji përmban kufizime joproporcionale që janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.

Certifikimi i subjekteve politike dhe i kandidatëve ishte përgjithësisht i rregullt dhe gjithëpërfshirës.⁴⁸ Janë regjistruar gjithsej 89 subjekte për të garuar në zgjedhjet komunale të vitit 2021, duke përfshirë 34 parti politike. Këto subjekte kanë paraqitur 166 kandidatë për kryetarë të komunave dhe 5,199 kandidatë për kuvendet komunale. Tri partitë më të mëdha politike (LVV, PDK dhe LDK) kanë regjistruar gjithsej 933 (38 për qind prej tyre gra), 905 (38 për qind prej tyre gra) dhe 847 (30 për qind prej tyre gra) kandidatë përkatësisht.

Për t'u certifikuar, një subjekt politik duhej të dorëzonte listën e kandidatëve, një sërë dokumentesh të kërkuara dhe të bënte një pagesë prej 200 € për listë. Në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare, subjekteve politike iu kërkua gjithashtu që të mbledhin 100 nënshkrime mbështetëse të votuesve të regjistruar në komunat ku ata synonin të garonin.⁴⁹ Siç kërkohet nga LZP-ja, KQZ kërkoi verifikimin e të dhënave penale të të gjithë kandidatëve nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), i cili menaxhon Sistemin Qendror të Evidencës Penale të Kosovës. Ky hap kyç procedural nxori në pah disa mangësi, pasi që në disa raste informacionet mbi evidencën penale mbërritën me vonesë ose nuk ju transmetuan kurrë KQZ-së.⁵⁰ Për shembull në rastin e Ivan Todosijeviqit i cili udhëhoqi *Listën Serbe* për kuvendin komunal në Zveçan, informacioni për dënimin e tij të formës së prerë i qershorit 2021 nuk arriti kurrë në KQZ, dhe ai u certifikua si kandidat dhe fitoi një ulëse në kuvendin komunal. Vetëm në datën 23 nëntor, pas shpalljes së rezultateve të certifikuar, KQZ-ja e anuloi zgjedhjen e tij për shkak të dosjes penale.⁵¹

Rekomandim: Të sigurohet një mekanizëm për transmetimin e saktë dhe me kohë të të dhënave nga KGJK-ja për t'i mundësuar KQZ-së të kryejë një verifikim efikas dhe të besueshëm të evidencës penale të kandidatëve.

KQZ-ja në fund përjashtoi 176 kandidatë për shkak të dosjeve të tyre penale në tri vitet e fundit, sipas LZP-së.⁵² Kjo dispozitë ligjore është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare pasi shpërfill peshën e krimit⁵³ dhe në të kaluarën ka qenë burim i interpretimeve të ndryshme pasi që nuk është as në përputhje

⁴⁸ Subjektet janë parti politike, koalicione, iniciativa qytetare dhe kandidatë individualë.

⁴⁹ Komisioni i Venedikut, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore neni 1.3 “*Ligji nuk duhet të kërkojë mbledhjen e nënshkrimeve të më tepër se 1% të votuesve në zonën përkatëse zgjedhore*”. Sipas LZP-së, subjektet politike që kanë fituar së paku një ulëse në zgjedhjet e mëparshme komunale nuk janë të detyruar të dorëzojnë nënshkrime mbështetëse.

⁵⁰ Për shembull, një kandidat për kuvendin komunal në Klinë me dënim penal të formës së prerë nga gushti i vitit 2021, fillimisht u aprovua nga KGJK, por më vonë u decertifikua nga KQZ-ja, para publikimit të listës përfundimtare të kandidatëve dhe fillimit të fushatës zgjedhore.

⁵¹ Në bazë të nenit 29.4 të LZP-së, KQZ-ja mund ta decertifikonte atë, pasi për shkak të dënimit penal të formës së prerë ai nuk kishte të drejtë të kandidohej (neni 29,1,q).

⁵² LZP, neni 29.1.q “*një person i shpallur fajtor për (ndonjë) vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë në tri vitet e fundit*” nuk ka të drejtë të kandidojë.

⁵³ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) Komenti i përgjithshëm 25, neni 4 “*Çdo kusht që zbatohet për ushtrimin e të drejtave të mbrojtura nga neni 25 duhet të bazohet në kritere objektive dhe të arsyeshme*”; Seksioni I.1.1.d Kodi i Praktikës së Mirë të Komisionit të Venedikut në Çështjet Zgjedhore “*i. dispozita [...] për privimin e*

me dispozitat e Kushtetutës dhe të Kodit Penal.⁵⁴ Subjektet politike u lejuan të zëvendësojnë kandidatët e refuzuar dhe me përjashtim të 16 kandidatëve të cilët nuk u zëvendësuan fare, subjektet politike propozuan kandidatë të tjerë të përshtatshëm dhe procesi u mbyll pa polemika.

Rekomandim: Parashikimi i papranueshmërisë së kandidatit në ligjin zgjedhor vetëm për një dënim penal të formës së prerë për vepra të rënda penale dhe në bazë të një vendimi gjyqësor që i heq shprehimisht të drejtën për tu kandiduar.

Ligji gjithashtu lejon që PZAP-ja t'ia marrë të drejtën një personi deri në gjashtë vjet në rast të kryerjes së shkeljeve që cenojnë integritetin e zgjedhjeve. Këto dispozita janë më kufizuese se ato të Kodit Penal, sipas të cilit gjykata mund të shqiptojë këtë sanksion deri në katër vjet. Ato po ashtu janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.⁵⁵

Gjatë procesit të certifikimit, PZAP-ja pranoi 16 ankesa, të cilat u refuzuan si të pabazuara ose për gabime procedurale. Pesë kandidatë të refuzuar më tej iu drejtuan Gjykatës Supreme (GJS), e cila i la në fuqi të gjitha vendimet e PZAP-së. EU EOM-ja vlerësoi se vendimet ishin në përputhje me dispozitat ligjore.

IX. AMBIENTI I FUSHATËS

Fushatë e qetë e cila u intensifikua para raundit të dytë me respektim të të gjitha lirive themelore.

FUSHATA PARA RAUNDIT TË PARË

Fushata zgjedhore para raundit të parë filloi më 16 shtator dhe zgjati 30 ditë. Duke pasur parasysh numrin e lartë të infektimeve me COVID-19, disa parti politike opozitare sugjeruan shkurtimin zyrtar të fushatës në pesë ditë. Ky mocion, megjithatë, u refuzua nga partia në pushtet, ndërsa KQZ-ja nuk gjeti bazë ligjore për një kufizim të tillë.

Fushata ishte përgjithësisht e profilit të ulët. Duke pasur parasysh masat kundër pandemisë dhe burimet e pakta financiare që rezultuan nga një fushatë shteruese dhe e kushtueshme para zgjedhjeve legjislativë të 14 shkurtit, kandidatët reduktuan fushën e aktiviteteve të tyre të planifikuara fillimisht dhe u fokusuan në mediat sociale dhe në paraqitjet e tyre televizive (debate). Gjithandej Kosovës u mbajtën takime kryesisht të vogla, dhe në ambiente të jashtme, zakonisht me një audiencë të synuar dhe duke respektuar kufizimet sanitare. U vëzhguan edhe aktivitete derë më derë. Fushata u intensifikua dy javë para zgjedhjeve, kryesisht në komunat ku pritej raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar të komunës.

Garuesit që u takuan me EU EOM-në deklaruan se gëzonin të drejta të barabarta për lirinë e tubimit, shprehjes dhe lëvizjes. Përderisa të gjitha takimet dhe tubimet publike duhej të miratoheshin nga KKZ-të dhe policia e Kosovës, bashkëbiseduesit e EU EOM-së nuk shprehën shqetësime lidhur me këtë procedurë.

individëve nga e drejta e tyre për të votuar dhe për t'u zgjedhur, [...] duhet të parashikohet me ligj; duhet respektuar parimi i proporcionalitetit; [...] mund të vendoset vetëm me vendim të shprehur të një gjykate.”

⁵⁴ Kushtetuta, neni 45 “Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.” Sipas Kodit Penal të vitit 2019, neni 60, vetëm ata që janë dënuar për njëmbëdhjetë lloje të veprave penale kundër të drejtave të votimit ose vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënimi me së paku dy vjet burgim mund të diskualifikohen si kandidatë deri në katër vite.

⁵⁵ Idem 55 dhe 56.

Sipas të dhënave të KQZ-së, janë miratuar gjithsej 1,023 tubime, 28 prej të cilave nuk i respektojnë masat kundër COVID-19.⁵⁶

Të gjitha ngjarjet e fushatës të vëzhguara nga EU EOM-ja u vlerësuan si të qeta. Vëzhguesit afatgjatë të BE-së morën pjesë në 66 ngjarje të fushatës (në 21 komuna) duke përfshirë 28 tubime dhe 16 takime më të vogla me votues. 47 nga këto ngjarje u zhvilluan në zonat urbane dhe 19 në zonat rurale. Vëzhguesit e BE-së nuk ishin dëshmitarë të asnjë rasti të frikësimit apo dhunës.

Garat për kryetarë të komunave e dominuan fushatën e decentralizuar dhe konkurruese. Derisa liderët e partive, zyrtarët e lartë dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës morën pjesë aktive në ngjarjet publike, fushata u udhëhoq nga personalitetet e kandidatëve dhe jo nga programet e partive të tyre. Subjektet kryesore politike nuk kishin platforma të centralizuara, përveç LVV-së e cila përsëriti agjendën e saj tradicionale kundër korrupsionit. Infrastruktura komunale ishte tema kryesore, pasuar nga shëndetësia, arsimiti, zhvillimi i bujqësisë dhe industrisë, planet e investimit dhe zhvillimi ekonomik, papunësia, mjedisi dhe menaxhimi i ujit si dhe gjendja në veri. Masat e reciprocitetit për targat e makinave shpesh ishin pjesë e diskursit politik. Akuzat për keqmenaxhim, korrupsion, mungesë transparence, keqpërdorim të resurseve administrative si dhe mashtrime të mundshme zgjedhore, përfshirë blerjen e votave, u intensifikuan në javën e dytë të fushatës. Në një numër të komunave konkurrenca ishte e ngushtë dhe ishte e vështirë për t'u parashikuar rezultatet.

Disa komuna nuk caktuan asnjë hapësirë publike falas për garuesit në zgjedhje dhe në disa komuna këto hapësira iu ndanë ekskluzivisht kompanive të reklamave në ambiente të jashtme.⁵⁷ Në kundërshtim me dispozitat ligjore, asnjë KKZ nuk raportoi në PZAP asnjë shkelje të rregullores të fushatës.⁵⁸

Në ditët e fundit të fushatës, kryeministri Kurti dhe ministrat e qeverisë zhvilluan fushatë aktive në mbështetje të kandidatëve të LVV-së, shpeshherë duke premtuar investime nga buxheti qendror. Derisa bashkëbiseduesit nga LVV-ja hodhën poshtë akuzat se veprime të tilla përbënin shkelje të rregullores së fushatës, partitë opozitare argumentuan se ky ishte një keqpërdorim i qartë i resurseve administrative. Në ditën e fundit të fushatës u organizuan disa tubime të mëdha me deri në 600 pjesëmarrës nga kandidatë të njohur për kryetarë të komunave (kryesisht nga LVV) në kundërshtim me masat sanitare. EU EOM-së iu raportuan pretendime për blerje të votave, por asnjë prej tyre nuk mund të konfirmohej.

Pas raundit të parë të zgjedhjeve komunale, u zgjodhën anëtarët e të 38 kuvendeve komunale si dhe 17 nga 38 kandidatët për kryetarë të komunave që morën mbi 50 për qind të votave të vlefshme. Pjesëmarrja në mbarë Kosovën në zgjedhjet e 17 tetorit ishte 43 për qind, por në komunat me shumicë serbe të Kosovës pjesëmarrja ishte dukshëm më e lartë në 61 për qind.

⁵⁶ Të gjitha takimet dhe tubimet publike duhet të miratohen nga Zyrtarët Komunal të Zgjedhjeve (ZKZ), të cilët po ashtu ishin përgjegjës për mbajtjen e shënimeve për çdo shkelje serioze gjatë tubimeve publike dhe duhet t'i kenë raportuar ato në PZAP. Ligji ndalon përdorimin e resurseve ose punonjësve publikë, frikësimin e votuesve, përdorimin ose kërcënimin me dhunë, shfaqjen e materialeve zgjedhore, gjuhën e urrejtjes dhe përpjekjet për blerje të votave.

⁵⁷ Për shembull në Deçan dhe Glllogoc.

⁵⁸ Për shembull KKZ-të në Ferizaj, Glllogoc, Vushtrri, Skenderaj, Mitrovicë të Veriut, Mitrovicë të Jugut, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq.




Figura 1. Komunat ku kryetarët e komunave u zgjodhën në raundin e parë (kaltër) dhe ku u zhvillua raundi i dytë (gjelbër).

FUSHATA PARA RAUNDIT TË DYTË TË ZGJEDHJEVE

Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave u zhvillua në 21 komunat e mbetura, përfshirë edhe në dy qytetet më të mëdha, Prishtinën dhe Prizrenin, mes dy kandidatëve kryesorë në secilën komunë. Ndërmjet dy raundeve u bënë një varg koalicionesh *ad hoc* ndërmjet subjekteve politike për të mbështetur kandidatët në raundin e dytë. Shpesh, këto ishin aleanca taktike të krijuara pavarësisht ndarjeve ideologjike dhe duke shpërfillur balancën e pushtetit në nivel qendror.⁵⁹

Fushata e raundit të dytë filloi zyrtarisht më 8 nëntor dhe zgjati vetëm pesë ditë deri më 12 nëntor në mesnatë, në përputhje me vendimin përkatës të KQZ-së.⁶⁰ Meqë korniza ligjore nuk përcakton ndonjë ndëshkim për zhvillim të fushatës jashtë kësaj periudhe dhe KQZ-ja nuk ndërmori asnjë masë,⁶¹ shumica e garuesve rifilluan aktivitetet e tyre të fushatës menjëherë pas raundit të parë, veçanërisht në mediat sociale, duke mos respektuar periudhën zyrtare 5-ditore të fushatës.⁶²

Rekomandim: Të zhvillohen masa për të zbatuar kufizimet e periudhës zyrtare të fushatës për raundin e dytë të zgjedhjeve ose të lejohet që fushata të fillojë menjëherë pas raundit të parë.

⁵⁹ Partitë të cilat ishin opozitë e partisë në pushtet në Kuvendin e Kosovës shpesh herë bënë koalicione me njëra-tjetrën në nivel komunal.

⁶⁰ Megjithatë, ky vendim i KQZ-së nuk ishte në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) i cili përcakton një periudhë të heshjes zgjedhore prej 24 orësh para hapjes së vendvotimeve në orën 7.00. Si rezultat, u vërejt zhvillimi i fushatës në platformat online edhe pak para orës 7.00 të datës 13 nëntor.

⁶¹ Sipas nenit 126 të LZP-së, KQZ-ja mund të kishte nxjerrë një rregullore që përcakton ndëshkime dhe gjoba për shkeljet e dispozitave të LZP-së.

⁶² PZAP-ja hodhi poshtë ankesën e vetme në lidhje me aktivitetet para fushatës në mediat sociale (të paraqitur nga LDK) duke shpjeguar se mund të ndëshkojë vetëm shkeljet e kodit të sjelljes gjatë periudhës zyrtare të fushatës.

Fushata mbeti konkurruese dhe e decentralizuar, pothuajse ekskluzivisht e bazuar në personalitetet e kandidatëve dhe jo në programet e partive të tyre politike. Garuesit që u takuan nga EU EOM-ja deklaruan se ata vazhdonin të gëzojnë të drejta të barabarta në lirinë e tubimit, të shprehjes dhe të lëvizjes. Infrastruktura komunale vazhdoi të ishte tema kryesore, e pasuar nga shëndetësia, arsimiti, bujqësia dhe zhvillimi ekonomik.

Të gjitha ngjarjet e fushatës të vëzhguara nga EU EOM-ja u vlerësuan si të qeta edhe pse toni i fushatës ishte paksa më i ashpër se në raundin e parë, kryesisht për shkak të sulmeve të ndërsjella ndërmjet kandidatëve për kryetarë të komunave. Fillimisht, ngjarjet ishin të vogla dhe kryesisht në ambiente të jashtme në sheshe, parqe dhe kafene. Fushata u intensifikua dy javë para ditës së zgjedhjeve të raundit të dytë me takime më të mëdha të mbajtura para fillimit të periudhës zyrtare të fushatës. EU EOM-ja vëzhgoi 42 tubime të fushatës në 15 komuna⁶³ gjatë fushatës së raundit të dytë, duke përfshirë disa tubime me mbi 500 pjesëmarrësve të organizuara në ditët e fundit të fushatës.⁶⁴ Këto tubime u zhvilluan në një atmosferë festive, por në masë të madhe duke injoruar masat anti-COVID. Tridhjetë nga këto ngjarje u zhvilluan në zonat urbane dhe 12 në zonat rurale. Të gjitha ngjarjet e vëzhguara të fushatës u vlerësuan si të qeta.

Në tubime vazhduan të merrnin pjesë liderët e partive kryesore si dhe zyrtarët e qeverisë. Deputetët e Kuvendit të Kosovës u angazhuan në fushatë deri në atë masë sa disa seanca të parapara plenare të Kuvendit të Kosovës u desh të anuloheshin për shkak të mungesës së kuorumit.

Kandidatët e LVV-së e portretizuan veten si lehtësues apo edhe garantues të fondeve dhe projekteve të financuara nga buxheti qendror. Këtë mesazh e kanë përsëritur kryeministri, ministrat dhe deputetët e LVV-së. Për më tepër, mes dy raundeve, qeveria shpalli një rritje të përkohshme të përfitimeve sociale për muajt nëntor dhe dhjetor 2021.⁶⁵ Derisa qeveria i prezantoi këto masa si pjesë e pakos së rimëkëmbjes ekonomike të miratuar në qershor 2021, dhe si një mjet për të luftuar inflacionin e madh, koha e këtij vendimi i dha një përparësi të padrejtë kandidatëve të LVV-së, në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare.⁶⁶ Shumë bashkëbisedues të EU EOM-së ngritën shqetësime se këto masa përbënin blerje indirekte të votave dhe keqpërdorim të resurseve shtetërore nga partia në pushtet. Qeveria i hodhi poshtë këto pretendime dhe informoi EU EOM-në se një pjesë e konsiderueshme e bonuseve të miratuara u jepej përfituesve përmes komunave. Pra, nëse këto masa do të kishin ndonjë ndikim tek votuesit, do të ishte në dobi të kryetarëve në detyrë të të gjithë spektrit politik.

⁶³ Sipas të dhënave të KQZ-së ishin miratuar gjithsej 110 tubime të kandidatëve.

⁶⁴ Tubimet e vëzhguara me mbi 500 pjesëmarrës përfshinin: Ngjarjet e AAK në Gjakovë, Istog dhe Junik; takimi i Demokratëve për Drenasin (DD) në Gillogoc; tubimet e LDK-së në Gjilan dhe Istog; LVV në Gjilan, Gjakovë, Prishtinë dhe Prizren, NISMA në Malishevë, PDK në Malishevë, Prizren dhe Vushtrri.

⁶⁵ Më 27 tetor, qeveria miratoi një shtesë të një hershme prej 100 € në pensionet në nëntor dhe dyfishoi pagesat e ndihmës sociale për nëntor dhe dhjetor. Buxheti për këto masa i tejkaloi 35 milionë euro dhe nga këto pritjet të përfitojnë rreth 300 mijë familje.

⁶⁶ Udhëzimi II.B.1.3 i Komisionit të Venedikut 2016 dhe OSBE/ODIHR Udhëzimet e përbashkëta për parandalimin dhe reagimin ndaj keqpërdorimit të resurseve administrative gjatë proceseve zgjedhore thekson se “për të parandaluar keqpërdorimin e resurseve administrative për çekuilibrimin e kushteve të barabarta gjatë garave zgjedhore, korniza ligjore duhet të theksojë se gjatë fushatave nuk duhet të ketë asnjë njoftim i rëndësishëm që lidhet ose që synon krijimin e një perceptimi të favorshëm ndaj një partie apo kandidati të caktuar”.

ANKESAT NË LIDHJE ME FUSHATËN ZGJEDHORE

PZAP-ja ka pranuar 22 ankesa lidhur me fushatën për të dy raundet, i aprovoi tri prej tyre dhe shqiptoi gjoba në shumën prej 14,100 euro për tri parti politike (LVV, LDK dhe PDK).⁶⁷ 60 ankesa të tjera kishin të bënin me thyerjen e heshtjes zgjedhore dhe ndalimin e fushatës në ditën e zgjedhjeve, shumica prej tyre kishin të bënin me fushatën në platformat online. PZAP-ja i aprovoi 19 prej tyre dhe shqiptoi gjoba në total prej 26,050 euro për gjashtë subjekte politike. PZAP-ja në përgjithësi i ka gjykuar ankesat në mënyrë profesionale dhe me kohë, përkundër kornizës së pamjaftueshme ligjore që rregullon fushatën zgjedhore.

X. FINANCIMI I FUSHATËS

Mungesa e mekanizmave efektivë për zbatimin e rregullave të financimit të fushatës çon në respektim të kufizuar të atyre rregullave nga garuesit, e kjo pastaj në mungesë të madhe të transparencës dhe llogaridhënies.

Në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare, korniza ligjore parashikon kufizime të donacioneve dhe shpenzimeve për fushatë, por, për shkak të mangësive themelore, nuk siguron raportim të saktë, zbulim në kohë dhe zbatim kuptimplotë.⁶⁸ Përderisa shumë bashkëbisedues të EU EOM-së theksuan nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse, projektligji për financimin e fushatës (në pritje në Kuvendin e Kosovës që nga viti 2019) i cili do të kishte kontribuar në përmirësimin e kornizës ende nuk është shqyrtuar nga legjislativi i tanishëm.⁶⁹ Përfaqësuesit e partive në të gjithë spektrin politik ndanë me EU EOM-në synimin e tyre për të ndryshuar projektligjin dhe për të hequr disa nga kërkesat që gjykohen si tepër të vështira, siç është raportimi i përkohshëm i financave të fushatës përpara ditës së zgjedhjeve.⁷⁰ Megjithatë, një vendim i tillë do të binte ndesh me parimin e transparencës.

Në legjislacionin aktual, afati i fundit për raportimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës është 45 ditë pas zgjedhjeve, duke kufizuar mundësinë e shqyrtimit publik para ditës së zgjedhjeve. Derisa shpenzimet e kandidatëve individualë mund të jenë të konsiderueshme,⁷¹ veçanërisht në garën për kryetar të komunës, atyre nuk u kërkohet të dorëzojnë raporte të veçanta të fushatës dhe partitë në përgjithësi nuk i pasqyrojnë këto shpenzime në pasqyrat e tyre financiare.⁷² Shpenzimet e pa raportuara pengojnë

⁶⁷ Kjo paraqet një rënie të ndjeshme të numrit të ankesave, krahasuar me zgjedhjet lokale të vitit 2017, kur ishin parashtruar 223 ankesa për fushatën zgjedhore.

⁶⁸ Donacionet për një subjekt të vetëm politik nga persona fizikë dhe juridikë janë të kufizuara në 2,000 €, përkatësisht 10,000 € në vit. Kufijtë e shpenzimeve ndryshojnë sipas komunave, bazuar në numrin e votuesve të regjistruar (0,5 € për votues ose 0,7 € në komunat më pak të populluara). Kufiri mesatar i shpenzimeve për komunë është 25,000 €, ku kufiri më i lartë është në Prishtinë (rreth 97,800 €) dhe më i ulët në Kllokot (rreth 2,600 €).

⁶⁹ Projektligji u vlerësua pozitivisht nga Komisioni i Venedikut, shih [Opinionin 922/2018 për Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike](#). Projektligji tashmë ka kaluar në lexim të parë në dy legjislaturat e mëparshme dhe duhet ta kalojë për herë të tretë në përbërjen aktuale të Kuvendit.

⁷⁰ Raportet e përkohshme i referohen raportimit të burimeve të financimit dhe shpenzimeve gjatë periudhës së fushatës, për t'u dhënë mundësi organeve mbikëqyrëse që të adresojnë çdo problem të mundshëm të hasur para ditës së zgjedhjeve.

⁷¹ Në Deçan, një kandidat për kryetar komune e informoi EU EOM-në se shpenzimet e tij për fushatën e kishin kaluar kufirin. Më tej, në një [intervistë publike](#) kryetari i zgjedhur i Prishtinës sugjeroi që shpenzimet e tij individuale të fushatës, të financuara nga kompania e tij private, mund të vlerësoheshin midis 200,000 dhe 300,000 €, që e tejkalon për dy ose tri herë kufirin e aplikueshëm, të përcaktuar në rreth 97,800 €.

⁷² Përderisa ligji nuk përmban ndonjë kërkesë të qartë të raportimit për shpenzimet e bëra nga kandidatët individualë, interpretimi i shumicës së palëve të interesuara është se legjislacioni përmban një detyrim për subjektet politike për të

transparencën e procesit dhe i bëjnë joefektive kufizimet e shpenzimeve. KQZ-ja publikon raportet vjetore të partive dhe të fushatës në faqen e saj të internetit menjëherë pas pranimit të tyre, duke kompensuar afatin tepër të gjatë për publikim nga subjektet politike. Megjithatë, ato nuk ofrojnë të dhëna në një format lehtësisht të kërkueshëm.⁷³ Në shumicën e këtyre aspekteve, legjislacioni largohet nga praktika e mirë ndërkombëtare.⁷⁴

Derisa financimi i fushatës nga palët e treta mbetet i parregulluar, EU EOM-ja vërejtë se afër një e treta e reklamave të fushatës që qarkullojnë në Facebook dhe Instagram para raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave ishin të sponsorizuara nga palët e treta.⁷⁵ Kjo ngrit pyetje nëse financimi nga palët e treta, i bërë online shpesh nën mburojë të anonimitetit, përdoret nga konkurrentët ose individët e lidhur me ta për t'i anashkaluar kërkesat e raportimit dhe kufijtë e shpenzimeve. Shpenzimet e pazbuluara nga palët e treta e ulin edhe më tej transparencën dhe llogaridhënien për financimin e fushatës dhe, në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare, ky fenomen kërkon që të paraqiten kërkesat për raportim (*Shih Komunikimi Digjital*).⁷⁶

Rekomandim: Ligji të parasheh raportimin e përkohshëm të të ardhurave dhe shpenzimeve të garuesve gjatë periudhës së fushatës, si dhe raportimin përfundimtar brenda 30 ditësh nga dita e zgjedhjeve. Raportimi duhet t'i përfshijë financat e kandidatëve të emëruar nga partitë dhe të subjekteve që bëjnë fushatë për garuesit (palët e treta). Ligji të përcaktojë një afat të shkurtër për autoritetet mbikëqyrëse dhe subjektet politike që t'i publikojnë të gjitha raportet financiare në mënyrë që të mund të kërkojnë me lehtësi.

Mungesa e auditimit të rregullt dhe zbatimi selektiv i ndëshkimeve nga KQZ-ja ka rezultuar në mbikëqyrjen e financave të fushatës vetëm *pro-forma* dhe nuk i ka nxitur garuesit që të respektojnë rregullat.⁷⁷ Nga Kuvendi i Kosovës kërkohej që të organizojë auditime financiare të të gjitha subjekteve

pasqyruar këtë lloj shpenzimi. Edhe pse shumica e përfaqësuesve të partive janë dakord me këtë interpretim, ata nuk e zbatojnë atë në praktikë.

⁷³ Subjektet politike duhet t'i dorëzojnë raportet vjetore në KQZ brenda muajit mars dhe t'i publikojnë ato në faqet e tyre të internetit brenda korrikut të vitit pasues. Për sa i përket raporteve të fushatës, ato duhet t'i dorëzojnë në KQZ brenda 45 ditëve dhe t'i publikojnë brenda gjashtë muajve nga dita e zgjedhjeve. Kjo nuk siguron zbulim me kohë. Ndonëse KQZ-së i kërkohej të publikojë pasqyrat financiare të partive në faqen e saj të internetit, nuk ka asnjë afat ligjor lidhur me këtë kërkesë. Si KQZ ashtu edhe ato pak parti që publikojnë raportet e tyre në faqen e tyre të internetit paraqesin vetëm kopje të skanuara.

⁷⁴ Paragrafi 200 i Udhëzimit e Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës dhe OSBE/ODIHR të vitit 2011 për rregullimin e partive politike thekson se “*Raportet për financimin e fushatës duhet tu dërgohen autoriteteve përkatëse brenda një periudhe jo më të gjatë se 30 ditë pas zgjedhjeve. Raportet e tilla duhet të kërkojnë jo vetëm për partinë si tërësi por edhe për kandidatët individualë dhe listat e kandidatëve. Shih gjithashtu paragrafin 259 të Udhëzimit e Komisionit të Venedikut dhe ODIHR 2020 për rregullimin e partive politike.*

⁷⁵ Monitorimi nga EU EOM-ja i reklamave të fushatës në Facebook dhe Instagram tregoi se partitë dhe kandidatët blenë 279 reklama unike ndërsa palët e treta sponsorizuan 121. Duke qenë se këto platforma online nuk ofrojnë informacione për koston e reklamave me pagesë, nuk është e mundur të vlerësohet shuma e fondeve të shpenzuara për këtë komponent të fushatës.

⁷⁶ Paragrafi 256 i Udhëzimeve të Komisionit të Venedikut dhe ODIHR 2020 për rregullimin e partive politike deklaroi se “[...] është e rëndësishme që disa forma të rregullimit, me detyrime dhe kufizime të krahasueshme siç zbatohen për partitë dhe kandidatët, të aplikohen edhe për palët e treta që janë të përfshira në fushatë, për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie. Palët e treta duhet tu nënshtrohen rregullave të ngjashme për donacionet dhe shpenzime sikurse partitë politike për të shmangur situatat kur palët e treta mund të përdoren për të anashkaluar rregulloret për financimin e fushatës.”

⁷⁷ Derisa në vitin 2021, KQZ-ja gjobiti subjektet politike që nuk i dorëzuan me kohë pasqyrat e tyre financiare, ajo nuk ndëshkoi ata që nuk i publikuan në faqet e tyre të internetit. Vetëm dy nga 28 garuesit për zgjedhjet e parakohshme

politike çdo vit. Në praktikë, auditimeve u mungon financimi i mjaftueshëm, kryhen me vonesë disavjeçare dhe vetëm për partitë parlamentare, duke penguar çdo verifikim kuptimplotë të financave të partive dhe zbatimin me kohë të ndëshkimeve.⁷⁸ Përveç kësaj, disa bashkëbisedues të EU EOM-së vunë në pikëpyetje proporcionalitetin dhe fuqinë parandaluese të ndëshkimeve në dispozicion (kryesisht gjoba që sillen nga 1,000 € deri në 5,000 €), të perceptuara si shumë të ulëta në krahasim me shumat për të cilat bëhet fjalë në fushën e financave të partive.

Fushëveprimi i mbikëqyrjes është edhe më shumë i kufizuar pasi nuk ka asnjë mekanizëm për t'i identifikuar fondet e pa raportuara dhe institucioneve mbikëqyrëse u mungojnë mjetet për të monitoruar shpenzimet e konkurrentëve në mediat sociale, ku shumica e partive përqendruan aktivitetet e tyre të fushatës (*Shiko* Komunikimi Digjital).

Rekomandim: Të sigurohet një mekanizëm i pavarur për mbikëqyrjen efektive të financave të partive dhe fushatave, të cilit i jepet mandati, autoriteti, si dhe burimet financiare dhe njerëzore për të monitoruar dhe hetuar në mënyrë efektive dhe proaktive parregullsitë e supozuara në financimin e partive dhe fushatave, përfshirë edhe të ardhurat dhe shpenzimet e paraportuara dhe shqiptimin e ndëshkimeve.

EU EOM-ja vuri në dukje ndërgjegjësimin dhe respektimin e kufizuar të rregullave të financimit të fushatës. Përderisa disa garues informuan EU EOM-në se nuk ishin në dijeni të kërkesës për hapjen e një llogarie të vetme bankare, shumë të tjerë treguan se kontributet e marra në nivel të komunës mbeten të paraportuara. Pastaj, rezultatet e auditimit të fundit treguan se afër një e treta e subjekteve politike që morën pjesë në zgjedhjet e parakohshme legjislativë të vitit 2019 dhe rreth gjysma e partive me përfaqësim parlamentar ndërmjet viteve 2018 dhe 2020 nuk mbanin llogaritë e duhura financiare, duke penguar auditorët në kryerjen e ndonjë vlerësimi kuptimplotë. Së fundi, në kundërshtim me legjislacionin, shumica e subjekteve politike nuk kanë zbatuar asnjë kontroll të brendshëm financiar.

Duke pasur parasysh mungesën e madhe të transparencës, shumë bashkëbisedues shprehën shqetësime për prejardhjen e fondeve të shpenzuara për fushatë dhe problemin e vjetër të lidhjeve financiare të pazbuluara mes partive dhe bizneseve me ndikim, duke rezultuar në dhënie preferenciale të kontratave të prokurimit publik. Derisa ligji ndalon donacionet nga bizneset që përfitojnë nga kontratat publike, nuk ka një mekanizëm efektiv për të kontrolluar respektimin e kësaj kërkesë.⁷⁹ Pavarësisht një rekomandimi të mëparshëm të EU EOM-së, nuk është mundur verifikimi i tërthortë i këtyre donatorëve duke bërë krahasimin me bazën e thjeshtë të të dhënave të kontraktuesve të prokurimit publik.

XI. MEDIAT

legjislativë të vitit 2021 publikuan raportet e tyre të fushatës dhe vetëm katër i bënë të disponueshme deklaratat e tyre vjetore për vitin 2020.

⁷⁸ Buxheti që duhej të përdorej për auditimin e raporteve të fushatës për zgjedhjet komunale 2021 u shterua për të bërë verifikimin e vonuar të raporteve financiare për tri vitet e fundit (2018-2020), i filluar në korrik dhe i përfunduar në tetor 2021. Sipas përfaqësuesve të Kuvendit të Kosovës, mungesa e fondeve në dispozicion, e kombinuar me mungesën e prituri të interesimit nga auditorët e kualifikuar, mund të shkaktojë sërish vonesa të konsiderueshme në kryerjen e auditimit.

⁷⁹ Neni 11 i Ligjit për financimin e partive politike ndalon donacionet nga bizneset të cilat zbatojnë kontrata të prokurimit publik, përfshirë edhe një periudhë prej tri vitesh pas përfundimit të tyre.

Mediat, përfshirë transmetuesit publikë dhe privatë, kontribuan pozitivisht në informimin e votuesve dhe u dhanë qasje garuesve, ndërsa sistemit të sanksionimit të KPM-së i mungonte qartësia dhe konsistenca.

MJEDISI MEDIAL

Kosova ka një ambient pluralist dhe të gjallë mediatik. Burimet kryesore të informimit janë televizioni krahas rrjeteve sociale dhe faqeve të lajmeve në internet.⁸⁰ Transmetuesi publik Radio Televizioni i Kosovës (RTK) përbëhet nga katër kanale televizive, dy radiostacione dhe një faqe e lajmeve në internet. RTK nuk është plotësisht i pavarur pasi financohet kryesisht nga buxheti i shtetit dhe pa rregulla të qarta se si të përcaktojë buxhetin e tij vjetor, duke e bërë atë të cenueshëm ndaj ndikimeve politike.⁸¹ Në korrik 2021, Kuvendi i Kosovës votoi për shkarkimin e Bordit të RTK-së duke theksuar keqmenaxhimin afatgjatë të buxhetit të tij.⁸² Anëtarët e bordit të RTK emërohen me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi i Kosovës, duke çuar potencialisht në një bord të përzgjedhur kryesisht nga shumica qeverisëse. Megjithatë, procesi i përzgjedhjes së Bordit të ri të RTK-së u vëzhgua nga afër prej organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe u vlerësua si transparent, dhe vendimet për kandidatët u morën në mënyrë kolegjiale nga një komision shumëpartiak ad hoc i Kuvendit të Kosovës. Një projektligj që synon të përmirësojë Pavarësinë financiare të RTK-së nga Kuvendi i Kosovës u shqyrtua dhe diskutua nga Kuvendi i Kosovës në vitet e fundit, por nuk u miratua asnjë herë.

Rekomandim: Të forcohet pavarësia e transmetuesit publik nga ndërhyrjet e mundshme politike, duke rishikuar sistemin e financimit të tij.

Mediat transmetuese kontribuojnë në një peizazh mediatik pluralist, me një numër të madh kanalesh televizive që raportohet se gëzojnë një shkallë të konsiderueshme të audiencës kombëtare dhe ofrojnë qasje në një numër të madh qëndrimesh. Megjithatë, ka shumë pak media që investojnë dhe prodhojnë analiza të thella dhe gazetari hulumtuese.⁸³ Kanalet televizive më të njohura janë *Klan Kosova*, *T7*, *TV Dukagjini*, *RTV21*, *KTV*, *ATV* dhe *Kanal 10*. Pavarësisht pluralizmit ekzistues, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) nuk ka zhvilluar një kornizë rregullative për të siguruar pluralitetin e mediave dhe për të parandaluar përqendrimin në tregun mediatik. Për më tepër, KPM-ja jep informacione të kufizuara ose nuk jep fare informacione publike mbi pronësinë e transmetuesve të licencuar.⁸⁴

⁸⁰ Shih [Sondazhi Besimi në media në Kosovë 2021 - IPSOS](#)

⁸¹ Ligji për RTK-në (2012) për nenin e tij 21.4 parasheh që për një periudhë të përkohshme trevjeçare (2012-2015), derisa të aplikohet një sistem financimi i bazuar në abonime, RTK do të marrë 0.7 për qind të Buxhetit Vjetor të Kosovës. Që nga përfundimi i kësaj periudhe të përkohshme, nuk janë ndërmarrë masa të tjera dhe buxheti vjetor i RTK-së vendoset nga qeveria pa kriteret e qarta. ICCPR, neni 19, Komenti i Përgjithshëm 34 para. 16 “Shtetet palë duhet të sigurojnë që shërbimet e transmetimit publik të funksionojnë në mënyrë të pavarur. Në këtë drejtim, shtetet palë duhet të garantojnë pavarësinë e tyre dhe lirinë redaktuese. Ato duhet të sigurojnë financim në një mënyrë që të mos cenojë pavarësinë e tyre.”

⁸² Raportet e dy komisioneve të Kuvendit të Kosovës në arsyetimin e tyre për shkarkimin e Bordit të RTK-së përmendën, ndër të tjera, mungesën e transparencës në menaxhimin financiar të RTK-së dhe refuzimin e tij për të bashkëpunuar me Auditorin e Përgjithshëm të Shtetit.

⁸³ Përjashtim bën OJQ Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese - [BIRN Kosovë](#).

⁸⁴ ICCPR, neni 19, KDNJ GC 34 para 40 “Shtetet palë duhet të ndërmarrin veprimet e duhura, në përputhje me Paktin, për të parandaluar dominimin ose përqendrimin jo të duhur të mediave nga grupet e mediave të kontrolluara në mënyrë private në situata monopoliste që mund të jenë të dëmshme për diversitetin e burimeve dhe qëndrimeve.”

Rekomandim: Të fillojë zbatimi i dispozitave rregullative specifike që synojnë sigurimin e pluralitetit mediatik dhe transparencës mbi pronësinë e mediave.

Dy mediat e fundit të shkruara ndërprejnë botimin në vitin 2020. Përderisa ka një numër të faqeve të lajmeve në internet që janë aktive në Kosovë, pak prej tyre respektojnë standardet profesionale dhe etike dhe paraqesin informacionet mbi pronësinë e tyre.

Peizazhi mediatik në Kosovë mbetet i ndarë ndërmjet komuniteteve që flasin gjuhën shqipe dhe serbe. Burimi kryesor i lajmeve për komunitetin serb të Kosovës janë mediat transmetuese nga Serbia. Ekziston një pluralizëm i kufizuar në mediat lokale serbe të Kosovës pasi shumica e tyre konsiderohen të jenë të afërta me autoritetet serbe dhe pak media janë të pavarura. Për më tepër, RTK2, kanali televiziv publik kabllor në gjuhën serbe dhe gjuhët joshumicë nuk është i qashtëm në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës.⁸⁵ Kjo është në kundërshtim me rregulloret kombëtare dhe zvogëlon edhe më shumë qasjen në informacion për qytetarët që jetojnë në ato komuna.⁸⁶

KORNIZA LIGJORE PËR MEDIA

Korniza ligjore për media në përgjithësi është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ofron garanci të forta për lirinë e mediave. Kushtetuta garanton “*lirinë dhe pluralizmin e mediave*” dhe ndalon censurën, ndërsa etiketimi dhe shpifja nuk janë vepër penale. Legjislacioni përfshin ligje për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe sigurimin e qasjes në informacionin publik.⁸⁷ Megjithatë, korniza ligjore ekzistuese shpesh nuk zbatohet ose zbatohet në mënyrë të ngadaltë dhe herë-herë joefektive, si për shembull për hetimin dhe ndjekjen penale nga gjyqësori të kërcënimeve të izoluara ndaj gazetarëve, apo gjykimin e padive për shpifje. Gjatë periudhës së zgjedhjeve, gazetarët kishin mundësi të ushtrojnë lirisht profesionin e tyre, me përjashtim të një incidenti të madh që nuk kishte të bënte me raportimin për zgjedhjet.⁸⁸

Mediat transmetuese rregullohen me akte nënligjore të nxjerra nga KPM-ja.⁸⁹ Shtatë anëtarët e KPM-së dhe tre anëtarët e Bordit të Ankesave të KPM-së emërohen me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi i Kosovës. Shumica e bashkëbiseduesve të EU EOM-së nga shoqëria civile e konsiderojnë organin rregullator joefektiv në zbatimin dhe zhvillimin e rregulloreve.⁹⁰ Gjatë periudhës së vëzhguar të zgjedhjeve, KPM-ja kishte vetëm katër nga shtatë anëtarët, duke ndikuar kështu në kapacitetin e organit rregullator për të arritur kuorumin prej katër anëtarësh për të marrë vendime. Për më tepër, Bordi i Ankesave të KPM-së nuk ishte

⁸⁵ Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

⁸⁶ Neni 9.2 i Rregullores për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale, Akti nënligjor i KPM-së 2020/01 “*Të licencuarit (operatorët kabllorë) obligohen të shpërndajnë pa kompensim kanalet e transmetuesit publik, si dhe kanalet e tjera komerciale me transmetim tokësor me statusin e bartjes së obligueshme.*”

⁸⁷ Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (2012), Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë (2013), Ligji për Qasje në Dokumente Publike (2019).

⁸⁸ Më 13 tetor 2021 në Mitrovicën e Veriut, disa gazetarë serbë dhe shqiptarë të Kosovës që mbulonin përleshjet mes policisë së Kosovës dhe demonstruesve, u kërcënuan dhe u penguan në punën e tyre. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Shoqata e Gazetarëve të Serbisë (UNS) në Kosovë e dënuan sulmin. Në vitin 2020, AGK-ja raportoi dhjetë kërcënime verbale dhe gjashtë sulme fizike ndaj mediave dhe për arrestimin e një gazetari.

⁸⁹ Ligji për KPM (2012), i cili përcakton përgjegjësitë e tij, ishte në rishikim gjatë periudhës së vëzhguar dhe qeveria paraqiti një projektligji të ri për konsultim publik më 15 nëntor 2021.

⁹⁰ Në qershor të vitit 2021, Drejtori Ekzekutiv i KPM-së dhe Drejtori i Administratës dhe Financave u arrestuan nga policia nën dyshimin për korrupsion çka ndikoi edhe më shumë në reputacionin e KPM-së. Gjykimi ishte duke vazhduar gjatë periudhës së vëzhguar.

funksional pasi mandati i njërit prej tre anëtarëve të tij kishte skaduar, duke zgjatur në mënyrë drastike çdo proces ankimor dhe duke dëmtuar të drejtën për të kërkuar mjete juridike efektive. Emërimi i vonuar i anëtarëve të KPM-së dhe anëtarëve të Bordit të Ankesave të KPM-së nga Kuvendi i Kosovës rrezikon veprimtarinë e organit rregullator.⁹¹

Mbulimi i fushatës zgjedhore nga mediat rregullohet kryesisht nga LZP-ja, i cili, ndër të tjera, kërkon që mediat transmetuese të sigurojnë mbulim të drejtë dhe të barabartë të të gjitha subjekteve politike të certifikuara dhe parasheh një sasi minimale të kohës së transmetimit falas.⁹² LZP-ja gjithashtu kërkon që transmetuesit t'i dorëzojnë KPM-së raporte javore me informacion të detajuar për kohën e transmetimit falas dhe mbulimin me pagesë që i ofrohet secilit subjekt politik, përfshirë edhe çmimin. Përmbajtja me pagesë duhet të tregojë qartë se është paguar dhe nga kush, dhe nuk lejohet jashtë periudhës zyrtare të fushatës.⁹³ Përveç spoteve politike me pagesë, garuesit mund të blejnë kohë transmetimi nga kanalet televizive për të transmetuar video lidhur me fushatën pa kufizim të sasisë së mbulimit politik me pagesë që një transmetues mund të transmetojë gjatë fushatës zgjedhore.

Mbikëqyrja e sjelljes së mediave transmetuese nga KPM-ja vë në pikëpyetje kapacitetin e saj të përgjithshëm për të zbatuar rregulloret që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Gjatë dy periudhave të fushatës KPM-ja ka monitoruar gjithsej 22 kanale televizive. Pavarësisht zbulimit sipas detyrës zyrtare të disa shkeljeve dhe njoftimit të shkelësve, gjatë fushatës 30-ditore të raundit të parë, KPM-ja mbajti vetëm një takim për të diskutuar shkeljet lidhur me zgjedhjet dhe nuk sanksionoi asnjë transmetues. Megjithatë, gjatë fushatës zyrtare pesëditore për raundin e dytë, KPM-ja zbuloi shkelje, mbajti tri takime brenda një jave dhe sanksionoi shkelësit me kohë gjatë fushatës. Shumica e shkeljeve kishin të bënin me emërtimin e gabuar të përmbajtjes politike me pagesë dhe përdorimin e fëmijëve në spote dhe programe me pagesë të lidhura me fushatën.⁹⁴ KPM-ja nuk sanksionoi kanalet televizive si p.sh *TV Dukagjini*, që gjatë të dy periudhave të fushatës publikuan dhe komentuan në mënyrë të përsëritur sondazhet zgjedhore të zhvilluara përmes faqeve të tyre në Facebook, të cilat ishin në kundërshtim me kërkesat ligjore, duke mashtruar potencialisht votuesit dhe duke dëmtuar kandidatët.⁹⁵ KPM-ja informoi EU EOM-në se disa transmetues, përfshirë edhe kanalet televizive kryesore, nuk i kanë dorëzuar këto raporte, të cilat duhet të përfshijnë edhe çmimet për përmbajtjet politike me pagesë, duke dëmtuar kështu transparencën mbi reklamën politike. KPM-ja pas raundit të parë dhe të dytë të zgjedhjeve publikoi raporte për monitorimin e mediave, duke treguar se në përputhje me ligjin transmetuesit kishin ofruar një mbulim mjaft të balancuar.⁹⁶

⁹¹ Mandati i dy anëtarëve të KPM-së përfundoi në nëntor 2020 dhe i një tjetri në prill 2021. Njëri nga tre anëtarët e Bordit të Ankesave të KPM-së i dha fund mandatit të tij në mars 2021. Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të rinj të Bordit të Ankesave të KPM-së dhe të KPM-së ishte duke vazhduar gjatë periudhës së vëzhguar.

⁹² Vetëm mediat transmetuese që pranojnë të transmetojnë reklama politike janë të detyruara të ofrojnë një sasi minimale të kohës së transmetimit falas. Mediat e transmetuara mund të vendosin se kur dhe në çfarë formati do të japin kohën e transmetimit falas.

⁹³ Neni 2.2 dhe Neni 14.6 i aktit nënligjor 2017/07 mbi Komunikimin Komercial Audiovizual, ndalon përmbajtjet politike me pagesë jashtë periudhës së fushatës zgjedhore.

⁹⁴ Neni 9.7 i Kodit të Etikës, akt nënligjor i KPM-së 2016/03, ndalon përdorimin dhe praninë e fëmijëve në përmbajtje promovuese politike.

⁹⁵ Neni 47.5 i LZP-së, kërkon që hulumtimet e opinionit të publikuara nga transmetuesit të përfshijnë informacione “Për numrin e gjithmbarshëm të respondentëve, emrin e kompanisë realizuese, emrin e partisë përgjegjëse për atë hulumtim dhe margjinën e gabimit.” Udhëzimet e KPM-së e specifikojnë atë “Termet hulumtim dhe anketë përdoren për të përfshirë çdo raportim të matjeve të mbështetjes publike apo qëndrimeve ndaj subjekteve politike të certifikuara, apo çdo gjë që lidhet me zgjedhjet”.

⁹⁶ KPM-ja publikoi raportet e saj të monitorimit të mediave më 2 nëntor dhe me 3 dhjetor 2021.

Procesi sanksionues i KPM-së nuk është i përcaktuar qartë dhe nuk është efektiv në planin afatgjatë. KPM-ja sanksionoi çdo kanal televiziv me gjobë kumulative për shkelje të ndryshme të kryera gjatë secilës fushatë zgjedhore, duke përfshirë edhe shkeljet që nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me mbulimin e zgjedhjeve. Kjo dëmtoi qartësinë e sanksioneve që aplikohen aktualisht për shkeljet e lidhura me zgjedhjet.⁹⁷ Bashkëbiseduesit e EU EOM-së treguan se në përgjithësi shumica e gjobave të shqiptuara ndaj transmetuesve nuk përbën masë parandaluese për shkeljen e ligjit.⁹⁸ Për më tepër, KPM-ja informoi EU EOM-në se pesë nga tetë transmetuesit e gjobitur gjatë zgjedhjeve legislative të shkurtit 2021 dhe gjashtë nga dhjetë transmetuesit e gjobitur gjatë zgjedhjeve të vitit 2019 nuk i kanë paguar ende gjobat e tyre. Sipas KPM-së, transmetuesit përfitojnë nga procesi i gjatë i ankesave në Bordin e Ankesave të KPM-së, si dhe nga një procedurë poashtu e gjatë për të mbledhur gjobat nga agjencitë përmbartimore private.⁹⁹

Rekomandim: Të emërohen me kohë të gjithë anëtarët e KPM-së dhe të Bordit të Ankesave të KPM-së përmes një procesi përzgjedhës konkurrues dhe transparent për të nxitur pavarësinë, mbikëqyrjen dhe fuqinë sanksionuese të organit rregullator.

Në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare, faqet e lajmeve në internet mbështeten në një sistem vetërregullues të bazuar në vullnetin e tyre, të udhëhequr nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK).¹⁰⁰ KMSHK pranon dhe gjykon ankesat nga kushdo që pretendon se është dëmtuar nga informacionet e publikuara nga faqet e lajmeve në internet. Ndonëse bashkëbiseduesit e EU EOM-së vlerësuan rolin pozitiv të këtij organi vetërregullues, KMSHK-ja përballet me sfida organizative dhe financiare të cilat ndikojnë në efektivitetin e saj të përgjithshëm.

MONITORIMI I MEDIAVE NGA EU EOM

Kanali televiziv publik, *RTK1*, përmbushi rolin e tij të shërbimit publik gjatë të dy periudhave të fushatës zgjedhore.¹⁰¹ Ai ofroi mbulim të balancuar dhe neutral të garuesve në lajmet dhe emisionet e tij të bisedave, megjithëse u fokusua në partitë e përfaqësuara në parlament.¹⁰² *RTK1* kontribuoi pozitivisht në informimin e votuesve duke organizuar debate zgjedhore ndërmjet kandidatëve për kryetarë të komunave

⁹⁷ Më 18 tetor, KPM sanksionoi *RTK1*, *Klan Kosova*, *KTV*, *Kanali 10* dhe *TV Dukagjini* me një gjobë prej 2000 euro secilin për shkelje të ndryshme, përfshirë ato lidhur me zgjedhjet. Më 20 tetor, *RTV21* dhe *ATV* u gjobitën me 1000 euro secili për shkelje të lidhura me zgjedhjet. Më 11 nëntor, KPM-ja gjobiti *T7* me 4000 € dhe *TV Dukagjini* me 3,000 € për shkelje të ndryshme, përfshirë shkeljet lidhur me zgjedhjet, të kryera gjatë fushatës zgjedhore të raundit të dytë.

⁹⁸ KPM-ja informoi EU EOM-në se për zgjedhjet komunale të tetorit vendosi të ulë gjobat në krahasim me zgjedhjet e parakohshme legislative të shkurtit për të marrë parasysh ndikimin financiar që tashmë kishte pandemia e COVID 19 tek transmetuesit.

⁹⁹ Kur Bordi i Ankesave i KPM-së nuk është funksional, transmetuesit duhet të ankohen ndaj vendimeve të KPM-së në gjykatat themelore.

¹⁰⁰ KMSHK është krijuar si një organ vetërregullues për median e shkruar, por me kalimin e viteve të gjitha u shndërruan në media ekskluzivisht online. Në vitin 2019, KMSHK-ja ndryshoi Kodin e saj të Mediave të Shkruara për të përfshirë faqet e lajmeve në internet. Që nga nëntori 2021, ajo numëron [42 anëtarë](#).

¹⁰¹ EU EOM-ja gjatë periudhës zgjedhore monitoroi mbulimin në kohën kryesore të transmetimit të dy kanaleve televizive publike (*RTK1* dhe *RTK2*), katër kanaleve televizive private në gjuhën shqipe (*Klan Kosova*, *T7*, *Kanali 10* dhe *TV Dukagjini*) si dhe transmetimin e lajmeve në kohën kryesore të dy kanaleve televizive lokale në gjuhën serbe (*TV Most* dhe *TV Puls*). Monitorimi përfshiu gjithashtu një mostër të faqeve të lajmeve në internet: *RTK Live*, *Gazetaexpress*, *Telegrafi*, *Koha.net*, *Indeksonline*, *Insajderi*, *KoSSev* and *Kosovo-Online*. Shih *Shtojca II* për rezultatet e hollësishtme.

¹⁰² Gjatë raundit të parë, *RTK1* ia kushtoi 19 për qind të mbulimit të saj të lajmeve në kohën kryesore AAK-së, 18 për qind PDK-së, 17 për qind LDK-së dhe 16 për qind LVV-së. Gjatë fushatës zyrtare zgjedhore 5-ditore për raundin e dytë, *RTK1* ia kushtoi 26 për qind të mbulimit të saj të lajmeve në kohën kryesore LVV-së, 21 për qind PDK-së, 20 për qind LDK-së dhe 14 për qind AAK-së, duke reflektuar në mënyrë të drejtë numrin e kandidatëve të secilës parti që merrte pjesë në raundin e dytë.

dhe për kuvendet komunale, të cilat ishin të strukturuar mirë dhe u mundësonin votuesve të informoheshin për garuesit dhe propozimet e tyre për qeverisjen e komunave.¹⁰³ Megjithatë, transmetuesi publik nuk ishte i balancuar në mbulimin e fushatës të bërë në faqen e tij të internetit ku ofroi më shumë mbulim për PDK-në në raundin e parë dhe për LDK-në në raundin e dytë. Në përputhje me ligjin, *RTK* transmetoi spotet informuese për votuesit të marra nga KQZ-ja.

Transmetuesit privatë që u monitoruan, në përgjithësi respektuan ligjin e zgjedhjeve. Megjithatë, ata ofruan një mbulim shumë të kufizuar, por mjaft të balancuar të lajmeve. Kanalet televizive pretenduan se nuk kishin kapacitet për të mbuluar zgjedhjet lokale. Prandaj, ata kontribuan në informimin e votuesve kryesisht duke organizuar debate zgjedhore, intervista me kandidatë dhe përmes bisedave politike. Mbulimi në emisionet e bisedave politike në raundin e parë në përgjithësi ishte mjaft i balancuar me kanalet televizive që pasqyronin mjedisin pluralist medial dhe u jepnin pak më shumë hapësirë shtesë disa partive të ndryshme. *Klan Kosova* ofroi mbulimin më të balancuar ndër transmetuesit e monitoruar. *TV Dukagjini* i ofroi më shumë hapësirë LVV-së në emisione politike, 36 për qind, që është 24 për qind më shumë se partia e tretë më e mbuluar, PDK-ja me 12 për qind. *T7* ia kushtoi pjesën më të madhe të mbulimit, 52 për qind, me një ndarje të barabartë, LDK-së dhe PDK-së, ndërsa *Kanal 10* i ofroi më shumë mbulim AAK-së, 26 për qind, ndaj partive tjera kryesore të cilat kishin nga 15 deri në 16 për qind secila.¹⁰⁴ Kanalet televizive ftuan në emisionet e tyre të debateve analistë që shprehnin një shumësi qëndrimesh politike dhe nuk shfaqnin ndonjë paragjykim të drejtpërdrejtë pozitiv apo negativ ndaj konkurrentëve. Para raundit të dytë, mbulimi redaktues i të gjithë transmetuesve privatë të monitoruar u fokusua në LVV dhe LDK.

Garuesit mirëpritën qasjen në media të ofruar në debatet e shumta zgjedhore të organizuara nga transmetuesit privatë, si dhe mundësinë për të përdorur për qëllimet e tyre të fushatës videot e debateve të transmetuara drejtpërdrejt nga kanalet televizive në Facebook.¹⁰⁵ Shumica e debateve ishin të strukturuar mirë dhe informuese (*TV Dukagjini*, *Klan Kosova* dhe *T7*), ndërkohë që para raundit të dytë, ato më shpesh rezultuan duke pasur kandidatë që adresonin akuza personale në vend që të adresonin planet e tyre për komunat, një tendencë e nxitur nga moderimi i kufizuar i moderatorëve televizivë, si p.sh, debatet e *Kanalit 10*. Përveç kandidatëve për kryetarë të komunave, debatet zgjedhore të organizuara në *TV Dukagjini* përfshinin edhe nga një kandidatë (grua) nga secila listë për kuvendet komunale për të rritur qasjen shumë të kufizuar në media që u ofrohet grave që garojnë për tu zgjedhur.¹⁰⁶ Edhe kanalet televizive lokale organizuan debate zgjedhore dhe ftuan kandidatët për kryetarë të komunave, megjithëse garuesit shpesh preferonin të merrnin pjesë në debatet e organizuara nga kanalet televizive më të njohura, me qendër në kryeqytet.¹⁰⁷

¹⁰³ Derisa gjatë fushatës së raundit të parë, RTK1 ishte në gjendje të organizojë debate për 25 nga 28 komuna, në raundin e dytë ia doli të mbajë debate vetëm në 2 nga 19 komunat për të cilat u përpoq, pasi në shumicën e rasteve njëri nga dy garuesit nuk mori pjesë.

¹⁰⁴ Duhet të merret parasysh se, siç raportohet, përfaqësuesit e LVV-së në përgjithësi u përmbajtën nga pjesëmarrja në debatet politike në *T7*, siç bënë përfaqësuesit e PDK-së për *TV Dukagjini*, duke pretenduar për një paragjykim ndaj tyre nga këto kanale televizive.

¹⁰⁵ *Klan Kosova*, *Kanal 10*, *TV Dukagjini* dhe *T7* gjatë fushatës së raundit të parë organizuan 67 debate me kandidatë për kryetarë të komunave për shumicën e 28 komunave me shumicë shqiptare, ndërsa arritën të organizojnë 26 debate për 11 nga 19 komunat me shumicë shqiptare që garuan në raundin e dytë. Asnjë debat nuk u organizua nga *T7* për raundin e dytë.

¹⁰⁶ Të gjitha debatet zgjedhore në *TV Dukagjini* u organizuan nga BIRN Kosova.

¹⁰⁷ Ndër kanalet televizive lokale që organizuan debate zgjedhore ishin *TV Besa* dhe *TV Prizreni* (Prizren) *TV Llapi* (Podujevë), *RTV Fontana* (Istog), *TV Syri Vizion* (Gjakovë), *TV Malisheva* (Malishevë) dhe *Plus TV* (Viti).

Në përputhje me ligjin, transmetuesit publikë dhe privatë nuk transmetuan përmbajtje politike me pagesë jashtë periudhave të fushatës zgjedhore, por monitorimi i mediave nga EU EOM-ja zbuloi shkelje të tjera të rregullave për reklamimet politike gjatë fushatave.¹⁰⁸ PDK-ja bleu shumicën dërmuese të përmbajtjeve politike me pagesë në të gjithë transmetuesit e monitoruar: 78 për qind gjatë fushatës zgjedhore të raundit të parë dhe 68 për qind gjatë fushatës për raundin e dytë.¹⁰⁹

Faqet e monitoruara të lajmeve në internet ofruan mbulim të kufizuar dhe nganjëherë të njëanshëm të lajmeve të fushatës.¹¹⁰ Pavarësisht nga kërkesa e Kodit të Mediave të Shkruara të KMSHK-së për të dalluar qartë ndërmjet përmbajtjes redaktuese dhe asaj me pagesë, bashkëbiseduesit e EU EOM-së theksuan praktikën nga faqet e lajmeve në internet për të ofruar mbulim me pagesë për garuesit pa i emërtuar artikujt e publikuar në faqet e tyre të internetit si të paguara.¹¹¹ Në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare, dispozitat e reklamimit politik në ligjin për zgjedhjet për mediat transmetuese nuk janë përshtatur dhe nuk zbatohen për faqet e lajmeve në internet, duke kufizuar kështu transparencën.¹¹²

Transmetuesit në gjuhën serbe pasqyruan një fushatë të profilit shumë të ulët. *RTK2*, kanali televiziv kabllor publik në gjuhët e popullsisë joshumicë, bëri përpjekje për të qenë i balancuar dhe ofroi kohë të gjatë transmetimi falas për kandidatët jo-shumicë, por vetëm disa prej tyre e shfrytëzuan këtë mundësi. Me gjithë tentativat e përsëritura, kanali i televizionit publik nuk ishte në gjendje të zhvillojë asnjë debat zgjedhor pasi kandidatët nuk shfaqën interesim. Kanalet televizive lokale serbe të Kosovës të monitoruara ia kushtuan shumicën e lajmeve të tyre raportimit mbi aktivitetet e zyrtarëve shtetërorë serbë: 76 dhe 71 për qind respektivisht në *TV Most* dhe *TV Puls*.

XII. KOMUNIKIMI DIGJITAL DHE MEDIAT SOCIALE

Derisa kandidatët ndanë informacione të dobishme përmes platformave online, mungesa e transparencës së reklamimit politik me pagesë në internet kufizoi llogaridhënien.

Penetrimi i internetit në Kosovë është ndër më të lartit në Evropë. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 96 për qind e familjeve kanë pasur qasje në internet në vitin 2020, 95 për qind e popullsisë kanë qasje në internet përmes lidhjeve fikse dhe 55 për qind përmes lidhjeve mobile.¹¹³ Afër 57 për qind i përdorën mediat sociale që nga janari 2021.¹¹⁴

Facebooku është platformë kryesore online, e pasuar nga Instagrami, LinkedIn dhe Twitter. Facebooku deri më tani ka qenë rrjeti social më i rëndësishëm i përdorur nga garuesit për të komunikuar me votuesit

¹⁰⁸ Shkeljet si emërtimi jo i duhur i përmbajtjes politike me pagesë dhe përdorimi i fëmijëve në spote dhe programe politike me pagesë.

¹⁰⁹ Pjesa më e madhe e përmbajtjeve politike me pagesë gjatë të dy raundeve përbëhej nga programet politike me pagesë, 88 për qind, kundrejt 12 për qind që ishin spote të shkurtra politike me pagesë.

¹¹⁰ Faqet e lajmeve në internet nuk janë të detyruara me ndonjë kërkesë ligjore për të ofruar mbulim të drejtë dhe të barabartë.

¹¹¹ Seksioni XII, Neni. 1 Kodi i mediave të Shkruara i KMSHK: “Reklamimi komercial e politik, si dhe materiali sponsorues përfshirë këtu edhe artikujt apo shtojca, duhet të jetë qartë i dallueshëm nga përmbajtja editoriale dhe të identifikohet qartë se çfarë është.”

¹¹² Deklarata e Përbashkët 2020 për lirinë e shprehjes dhe zgjedhjet në epokën digjitale (OKB, OSBE, OAS) “Të gjitha rregullat për shpenzimet zgjedhore që janë parapara për të krijuar kushte të barabarta për zgjedhje duhet të zbatohen për mediat e vjetra dhe digjitale, duke marrë parasysh dallimet e tyre, përfshirë edhe rregullat për transparencën e reklamimit politik.”

¹¹³ Raporti i progresit i BE-së për Kosovën 2021

¹¹⁴ Ne jemi social' / Hootsuite, Digital 2021, Raporti i Kosovës

dhe nga institucionet publike si platformë kryesore për të shkëmbyer informacione. Ndonëse edhe Instagrami është i popullarizuar, Twitter përdoret kryesisht nga gazetarët, politikanët dhe opinionistët për t'ia komunikuar mesazhet një audience ndërkombëtare. Viber është aplikacioni më i popullarizuar për mesazhet e çastit.¹¹⁵

KORNIZA LIGJORE PËR MEDIAT SHOQËRORE

Liria e shprehjes është një e drejtë kushtetuese, e përcaktuar sipas parimeve të përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Përveç kësaj, Kosova ka një numër ligjesh që synojnë të mbrojnë lirinë e fjalës dhe lirinë e shtypit (*Shih Media*).¹¹⁶ Korniza ligjore ofron një bazë të mjaftueshme për të adresuar nxitjen e urrejtjes. Megjithatë, komunikimet digjitale mbeten kryesisht të parregulluara.

Legjislacioni zgjedhor ka mbetur kryesisht i pandryshuar për më shumë se një dekadë dhe nuk pasqyron në mënyrë eksplicite rëndësinë e shtuar të komunikimit digjital në zgjedhje. Derisa dispozitat ligjore në lidhje me keqpërdorimin e resurseve publike, periudhën e heshtjes zgjedhore, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale interpretohen si të zbatueshme edhe për sferën digjitale, nuk ekziston asnjë dispozitë për zhvillimin e fushatës online dhe shpërndarja e reklamave zgjedhore në platformat online mbetet e parregulluar.

Rekomandim: Të përfshihen dispozita për reklamën zgjedhore në platformat online dhe rregullat ekzistuese të fushatës të zgjerohen në mënyrë eksplicite edhe për sferën digjitale.

Një nismë e mirë e organizatave të shoqërisë civile e mbështetur edhe nga KQZ-ja solli për herë të parë nënshkrimin e një Deklarate për Sjellje të Mirë të Partive Politike dhe Kandidatëve në rrjetet sociale. Qëllimi i saj ishte t'i bindte partitë politike që të shmangnin përhapjen e gjuhës së urrejtjes, dezinformimit dhe gjuhës shpifëse në rrjetet sociale, si dhe të rriste llogaridhënien për shpenzimet e fushatës për reklamën politike digjitale dhe të rriste transparencën e komunikimit të fushatës së konkurrentëve në internet. Megjithatë, vetëm disa bashkëbisedues politikë të EU EOM-së treguan se kanë njohuri për të, duke zbuluar se numri i ulët i nënshkruesve e ka kufizuar efikasitetin e përpjekjes.¹¹⁷

GJETJET E MONITORIMIT TË MEDIAVE SOCIALE

EU EOM-ja monitoroi përmbajtjen në internet lidhur me zgjedhjet që nga fillimi i fushatës për raundin e parë deri në raundin e dytë të zgjedhjeve duke përdorur një qasje sasiore për të analizuar një mostër

¹¹⁵ [Statistikat e përdorimit të aplikacionit të mesazheve nëpër botë - MessengerPeople nga Sinch](#)

¹¹⁶ Kushtetuta (neni 40, para. 2) dhe Kodi Penal (neni 141) përcaktojnë bazën ligjore për trajtimin e nxitjes së urrejtjes, e cila adresohet edhe me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme që ndalon përdorimin e gjuhës nxitëse ose provokuese, si dhe inkurajimin, mbështetjen ose miratimin e kërcënimeve me dhunë ose frikësimin gjatë procesit zgjedhor (Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, neni 33 dhe 34).

¹¹⁷ Vetëm 6 parti (LDK, PDK, LV, SDU, AKR dhe NISMA), 6 media (KosovaLive, Telegrafi.com, Kosovo-Online.com, Reporter.net, Komisioni i Mediave të Shkruara të Kosovës dhe Ballkani.info) dhe 8 OJQ (Demokracia +, Lëvizja FOL, Bashkimi Rinor e Ardhmja e Nditur, OJQ Aktiv, Young Active Gracanica, Instituti Kosovar i Drejtësisë, D4D dhe Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve) nënshkruan [Deklaratën për Sjellje të Mirë të Partive Politike dhe Kandidatëve në Mediat Sociale](#) para fillimit të periudhës së fushatës.

postimesh në Facebook dhe Instagram të publikuara nga kandidatët për kryetarë të komunave, parti, faqe të palëve të treta, si dhe nga aktorët institucionalë.¹¹⁸

Të gjitha partitë bënë fushatë kryesisht përmes faqeve të tyre kryesore në Facebook dhe faqeve të administruara nga degët e tyre komunale, si dhe përmes llogarive zyrtare dhe personale të kandidatëve të tyre. Në një shkallë më të vogël, edhe Instagrami u përdor për fushatë. Vetëm disa kandidatë shpërndanë përmbajtje zgjedhore në platforma të tjera. Në përgjithësi, LVV-ja ishte partia më aktive, e pasuar nga PDK-ja dhe LDK-ja. Platformat online u përdorën nga garuesit kryesisht për të promovuar politikat e tyre dhe për të mobilizuar elektoratin, por edhe për të njoftuar për ngjarje online dhe me prani fizike, si dhe pjesëmarrjen e kandidatëve në programet televizive dhe të radios dhe mesazhet e informimit të votuesve.




Figura 2. Raundi i parë – Facebook, qëllimi i postimit
Bazë: “mobilizim” 656, “njoftim” 121, “tjetër” 198




Figura 3. Raundi i dytë – Facebook, qëllimi i postimit
Bazë: “mobilizim” 717, “njoftim” 108, “tjetër” 283




Figura 4. Raundi i parë – Instagram, qëllimi i postimit
Bazë: “mobilizim” 370, “njoftim” 67, “tjetër” 141




Figura 5. Raundi i dytë – Instagram, qëllimi i postimit
Bazë: “mobilizim” 294, “njoftim” 32, “tjetër” 104

¹¹⁸ Gjatë fushatës së raundit të parë u analizua një mostër e rastësishme prej 975 postimesh në Facebook dhe 578 postimesh në Instagram të publikuara nga 534 faqe dhe grupe publike në Facebook dhe 145 llogari në Instagram. Për raundin e dytë të zgjedhjeve, mostra u përshtat për listën më të vogël të garuesve të përfshirë në garë dhe përbëhej nga 1,108 postime në Facebook dhe 430 postime në Instagram të publikuara nga 234 faqe dhe grupe publike në Facebook dhe nga 58 llogari në Instagram (shih *Aneksi III*).

Me përjashtim të disa rasteve të izoluara të shkeljeve të dyshuara të rregullave të fushatës nga kandidatët në llogaritë e tyre në Facebook dhe Instagram, korniza ligjore në fuqi u respektua në përgjithësi.¹¹⁹

Fushata online rifilloi menjëherë pas raundit të parë, shumë kohë para fillimit të periudhës zyrtare të fushatës. Ndryshe nga retorika e qetë e vërejtur në raundin e parë, gjatë raundit të dytë toni u bë më negativ. Disa kandidatë iu drejtuan kundërshtarëve me gjuhë të ashpër, duke u përpjekur herë pas here t'i delegjitimonin ata. Një rritje e vazhdueshme e reklamave në Facebook nga kandidatët, partitë dhe palët e treta është vërejtur ndërmjet dy raundeve. Një analizë e përmbajtjes së tyre tregoi se, ndonëse kandidatët në përgjithësi përdornin reklama në internet për të promovuar programet e tyre, reklamat e palëve të treta u përdorën kryesisht për të diskredituar konkurrentët, duke përfshirë edhe akuza personale.

Megjithëse reklamat me pagesë në internet dukej se përdorshin gjerësisht, mungesa e rregullave të transparencës dëmtoi llogaridhënien (*Shih* Financimi i Fushatës). Raporti i transparencës në Google për reklamat politike nuk është në dispozicion për Kosovën, kështu që reklamat lidhur me fushatën që shfaqen nëpër produktet e saj nuk mund të gjurmohen dhe vlerësohen në mënyrë gjithëpërfshirëse.¹²⁰ Në një hap të mirëpritur, Meta vuri në dispozicion komponentin politik të veglës së saj të transparencës publike 'Biblioteka e reklamave' [Ad Library] në shkurt 2021. Megjithatë, nuk u vendos si kusht që reklamuesit politikë të regjistroheshin për të vendosur reklama zgjedhore në platformat e saj.¹²¹ Si rezultat, depoja (repository) e saj publike ofroi qasje në reklamat zgjedhore vetëm në ditën e qarkullimit të tyre dhe nuk dha informacione të detajuara mbi shumën e shpenzuar për reklamat, kontribuesit e tyre si dhe për shtrirjen e reklamave nëpër shumë tregues demografikë.¹²² Aktiviteti monitorues sistematik i reklamave politike në Facebook dhe Instagram nga njësia e mediave sociale e EU EOM-së tregoi se kjo kufizoi aftësinë e përdoruesve për të analizuar burimet e informacionit politik me pagesë të përhapur përmes produkteve Meta.¹²³ Miratimi i arkivave të reklamave të mediave sociale do të mundësonte një nivel të shqyrtimit të përmbajtjes me pagesë, në përputhje me standardet ndërkombëtare për transparencë dhe qasje në informata.¹²⁴

¹¹⁹ Shkeljet e dyshuara kishin të bënin me përdorimin e imazhit të fëmijëve dhe figurave fetare në fushatë, si dhe me ndalimin e përdorimit të resurseve publike për qëllime të fushatës.

¹²⁰ Google, që është pronar i YouTube, mban vetëm arkivat e reklamave në Australi, BE, Indi, Izrael, Zelandë të Re, Tajvan, MB dhe SHBA.

¹²¹ Për Kosovën, reklamuesit politikë vetëm "inkurajohen" të autorizohen. EU EOM-ja mundi të identifikoi vetëm tre kandidatë të regjistruar dhe duke mohura përgjegjësinë duke vendosur në reklama shprehjen "paguar nga", për të specifikuar se kush ka paguar për to.

¹²² Përderisa në shumicën dërrmuese të rasteve këto përmbajtje qëndruan aktive për disa ditë, nuk është e mundur të vlerësohet se sa njerëz janë kontaktuar pasi që reklamuesve nuk u kërkohet të regjistrohen për të rritur përmbajtjen dhe Meta nuk mban arkivat publike të reklamave, si në Kosovë.

¹²³ Njësia e mediave sociale të EU EOM-së përcillte çdo ditë në mënyrë manuale reklamat zgjedhore me pagesë në Facebook dhe Instagram. Midis dy raundeve, EU EOM-ja identifikoi dhe analizoi 279 reklama zgjedhore të shpërndara nga kandidatët dhe partitë dhe 121 reklama zgjedhore të nxitura nga palë të treta pa asnjë deklaram "paguar nga" për heqjen e përgjegjësisë.

¹²⁴ OKB, Neni 7.4: "Çdo Shtet Palë, në përputhje me parimet themelore të ligjit të brendshëm, duhet të përpiqet të miratojë, mirëmbajë dhe forcojë sistemet që promovojnë transparencën [...]"; OKB, CAC, neni 7.3: "Çdo Shtet Palë do të konsiderojë gjithashtu marrjen e masave të duhura legislative dhe administrative, [...] për të rritur transparencën në financimin e kandidatëve për poste të zgjedhura publike dhe, kur është e aplikueshme, financimin e partive politike". dhe neni 13(b) "Çdo Shtet Palë do të sigurojë që publiku të ketë qasje efektive në informacione."; Deklaratë e përbashkët për lirinë e shprehjes dhe zgjedhjet në epokën digjitale nga UNHRC, OSBE dhe OAS, "Rekomandime për shtetet, qasja në informacione në lidhje me zgjedhjet: ii) Partive dhe kandidatëve duhet t'u kërkohet që të jenë transparente në kohën e duhur, duke përfshirë ndaj mediave, lidhur me shpenzimet e tyre për zgjedhjet dhe, në veçanti, shpenzimet për mediat tradicionale dhe digjitale dhe përpjekjet e tjera të komunikimit digjital." Shih po ashtu: Demokracia Evropiane: Komisioni

Rekomandim: Të nxitet bashkëpunimi ndërmjet administratës së zgjedhjeve dhe ofruesve kryesorë digjitalë për të inkurajuar aplikimin e arkivave të detyrueshme për reklamat zgjedhore në internet me qëllim që të rritet transparenca dhe llogaridhënia për shpenzimet e fushatës. Mund të aplikohet një rregullore për subjektet politike dhe kandidatët që synojnë të zhvillojnë fushatë në platformat online për t'u regjistruar si reklamues politikë.

Derisa kandidatët ndanë informacione të dobishme përmes platformave online, EU EOM-ja vërejtë se faqet jotransparente në Facebook u përdorën për t'iu drejtuar konkurrentëve me një retorikë negative përmes përmbajtjes çorientuese.¹²⁵ Disa nga këto faqe u prezantuan rrejshëm si media pa dhënë informacione të sakta për të verifikuar vërtetësinë e tyre, disa u krijuan gjatë gjashtë javëve para raundit të dytë dhe disa të tjera ndryshuan emrat e tyre disa herë prej krijimit të tyre.¹²⁶ Edhe pse nuk ishin pjesë e fushatës zyrtare të kandidatëve, ato kontribuan në bëjnë një çrregullim të informacionit, duke shpërndarë reklama mashtruese zgjedhore për të diskredituar garuesit pa transparencë rreth asaj se kush ka paguar për këtë përmbajtje. Këto faqe kishin për qëllim të çorientonin votuesit, duke dobësuar aftësinë e tyre për të dalluar burimet e tyre të informacionit politik për të marrë një vendim plotësisht të informuar, duke ndikuar kështu negativisht në të drejtën e tyre për të formuar opinione për çështje politike pa ndërhyrje manipuluese.¹²⁷

Ndonëse Facebook nuk lejon paraqitjen e rrejshme lidhur me pronësinë ose kontrollin e një faqeje, krijuesve të një faqeje nuk u kërkohet të dëshmojnë identitetin e tyre dhe misioni u informua se Facebook nuk verifikon nëse janë të sakta informacionet e kontaktit të vëna në dispozicion përmes seksionit "Rreth" [About] të një faqeje.¹²⁸ Bashkëpunimi strategjik midis palëve të interesuara në zhvillimin e programeve të verifikimit të fakteve në periudha zgjedhore do të kontribuonte pozitivisht në kultivimin e një mjedisi më të sigurt të fushatës digjitale. Megjithatë, EU EOM-ja vuri në dukje se iniciativat aktive të verifikimit të fakteve ishin të pakta dhe nuk ishin të përqendruara vazhdimisht në demaskimin e çështjeve lidhur me fushatën.¹²⁹

përcakton ligje të reja mbi reklamimin politik, të drejtat zgjedhore dhe financimin e partive, Deklaratë për shtyp e Komisionit Evropian, 25 nëntor 2021.

¹²⁵ Një video e promovuar nga faqja Podujeva Post prej 3 deri më 14 nëntor, e cila pretendonte rrejshëm se LDK-ja kishte bërë aleancë me partinë Lista Serbe për raundin e parë duke prekur në çështjen e ndjeshme të ndarjeve etnike regjistroi mbi 630.000 shikime. Në një mjedis ku votuesit ndjekin vijat etnike, një deklaratë e tillë mund të ketë ndikuar në përcaktimin e votuesve. Në një postim tjetër i shfaqur për tre ditët e fundit para raundit të dytë nga e njëjta faqe, përmbajtja e të cilës ishte demaskuar nga portali online Kallxo.com, një parti u akuzua për blerje votash. Kallxo.com është pjesë e Rrjetit Ndërkombëtar për Verifikuesit e Fakteve të Institutit Poynter (IFCN).

¹²⁶ EU EOM-ja identifikoi 20 faqe të errëta në Facebook, gjysma e të cilave pretendonin se ishin burime lajmesh pa dhënë detaje të sakta për të verifikuar vërtetësinë e tyre. Këto faqe janë përdorur për të shfaqur 60 reklama çorientuese politike që përçonin një retorikë negative. Të gjitha ndërprejnë përhapjen e reklamave politike pas 14 nëntorit, katër më nuk ishin të qasshme në ditën pas zgjedhjeve dhe, në kohën e shkrimit të këtij raporti, 12 ishin joaktive që atëherë.

¹²⁷ Shih Komiteti i Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Njeriut, Komenti i Përgjithshëm nr. 25, paragrafi 19: "Votuesit duhet të jenë në gjendje të formojnë opinione në mënyrë të pavarur, pa dhunë apo kërcënim të dhunës, detyrim, nxitje apo ndërhyrje manipuluese të çfarëdo lloji."

¹²⁸ "Në përputhje me angazhimin tonë për autenticitet, ne nuk i lejojmë njerëzit të paraqesin veten rrejshëm në Facebook, të përdorin llogari të rreme, të rrisin në mënyrë artificiale popullaritetin e përmbajtjes ose të përfshihen në sjellje që kanë për qëllim të mundësojnë shkelje të tjera sipas Standardeve të Komunitetit tonë. [...] Mos: [...] Fshihni qëllimin e faqes duke mashtruar përdoruesit në lidhje me pronësinë ose kontrollin e asaj Faqeje", Qendra e Transparencës në Facebook.

¹²⁹ Deklarata e përbashkët për lirinë e shprehjes dhe "lajmet e rrejshme", dezinformimin dhe propagandën nga OKB, OSBE, OAS dhe ACHPR thekson se: "Të gjitha palët e interesuara – duke përfshirë ndërmjetësuesit, mediat, shoqërinë civile dhe akademinë – duhet të mbështeten në zhvillimin e nismave pjesëmarrëse dhe transparente për të kuptuar më mirë

XIII. PJESËMARRJA E GRAVE

Numri shumë i ulët i grave në garat për kryetarë të komunave pasqyroi realitetin e vrazhdë të pjesëmarrjes së grave në politikë në Kosovë, i konfirmuar edhe nga rezultatet e zgjedhjeve.

Parimi i barazisë gjinore është i mishëruar në Kushtetutën e Kosovës dhe instrumentet kryesore të drejtave të njeriut që mbrojnë të drejtat e grave dhe barazinë gjinore zbatohen drejtpërdrejt, duke pasur përparësi ndaj ligjeve vendore. Sipas LZP-së dhe LZL-së, zbatohet një kuotë gjinore prej të paktën 30 për qind për gjininë më pak të përfaqësuar, si për certifikimin e subjekteve politike dhe shpërndarjen e ulëseve në kuvendet komunale ashtu edhe për Kuvendin e Kosovës.¹³⁰ Megjithatë, kjo nuk korrespondon me kuotën prej 50 për qind për të gjitha institucionet legjislative, ekzekutive dhe publike që kërkohet sipas Ligjit për Barazinë Gjinore 2015..¹³¹

Për zgjedhjet për kryetarë të komunave të vitit 2021, gjithsej 14 kandidatë ishin gra (8 për qind), por vetëm dy ishin në bastionet e partive të tyre politike (në Graçanicë dhe Ranillug); të dyja u zgjodhën, duke përfaqësuar LS-në.¹³²

Gjithsej 1,937 gra (37 për qind) kandiduan për kuvendet komunale duke respektuar kuotën minimale gjinore prej 30 për qind, dhe 36 prej tyre (12 për qind) kryesonin listat e tyre. Vetëm 364 gra u zgjodhën (36 për qind) – 221 u zgjodhën përmes votave të fituara (61 për qind e të gjitha grave të zgjedhura) dhe 143 për shkak të mekanizmit të kuotës (39 për qind).¹³³ Ndër partitë më të mëdha, LVV dhe PDK kishin regjistruar 38 për qind kandidatë [gra] për kuvendet komunale, ndërsa LDK-ja 30 për qind. Përkundër propozimit të numrit të nevojshëm të kandidatëve [gra], partitë politike, të cilat kryesisht dominohen nga meshkujt, ende nuk e kanë adresuar seriozisht çështjen e pabarazisë gjinore në programet dhe statutet e tyre dhe janë larg përmbushjes së obligimeve ligjore që dalin nga Ligji për Barazi Gjinore.¹³⁴

Rekomandim: Partitë politike të marrin parasysh miratimin e politikave të brendshme për të promovuar pjesëmarrjen e grave dhe për të integruar çështjet gjinore në platformat partiake.

Vetëm një nga 11 anëtarët e KQZ-së është grua, ndërsa numri i përgjithshëm i grave anëtare të KKZ-ve ishte 46 nga 243 (19 për qind) dhe kishte vetëm pesë kryetare [gra] të KKZ-ve.¹³⁵ Në këto zgjedhje, për herë të parë KQZ-ja ftoi organizatat e shoqërisë civile që të propozojnë gra për 16 KKZ-të ku subjektet

ndikimin e dezinformimit dhe propagandës në demokraci, në liri të shprehjes, në gazetari dhe hapësirë qytetare, si dhe në reagimin e duhur ndaj këtyre fenomeneve.”

¹³⁰ Për kuvendin komunal, vendet fillimisht i ndahen një subjekti politik sipas rezultateve të zgjedhjeve. Por nëse kjo ndarje nuk respekton kuotën gjinore prej 30 për qind, atëherë sipas ligjit, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë do të zëvendësohet nga kandidati tjetër i duhur i gjinisë pakicë për të arritur kuotën 30 për qind.

¹³¹ Neni 5, para. 2, Ligji për Barazinë Gjinore “Çdo dispozitë, e cila është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas këtij ligji shfuqizohet”. Neni 6, paragrafi 8 i Ligjit për Barazi Gjinore “Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.”

¹³² Asnjë nga kryetarët në largim nuk ishte grua.

¹³³ Për zgjedhjet për Kuvendin Komunal të vitit 2017, 67 për qind e grave fituan për shkak të kuotës, ndërsa 33 për qind u zgjodhën drejtpërdrejt.

¹³⁴ Neni 14, Ligji për Barazinë Gjinore “Partitë politike me aktet e tyre obligohen të zbatojnë masat për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të meshkujve dhe femrave në organet dhe trupat e partive, në pajtim me dispozitat e nenit 6 të këtij ligji.”

¹³⁵ Këto ishin KKZ-të e Istog, Prishtinë, Shtime, Fushë Kosovë dhe Zubin Potok.

politike nuk e kishin respektuar Deklaratën e shtatorit 2015 dhe nuk kishin propozuar gra.¹³⁶ Megjithatë, vetëm 18 për qind e vendvotimeve të vizituara nga vëzhguesit e BE-së gjatë të dy raundeve kishin nga një grua si kryetare e KVV-së. Gratë si anëtare të KVV-ve u vërejtën vetëm në 31 për qind të vendvotimeve të vizituara gjatë raundit të parë dhe vetëm në 25 për qind të vendvotimeve të vëzhguara gjatë raundit të dytë. Mbi 20 për qind e KVV-ve të vëzhguara në të dy raundet nuk kishin asnjë grua në mesin e anëtarëve të tyre.

Dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me zëvendësimin e deputetëve të kuvendeve komunale ose të Kuvendit të Kosovës nga kandidati i duhur i radhës “i të njëjtës gjini” janë shpallur nga GJK-ja¹³⁷ të jenë në mospërputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në dhe se duhet të ndryshohen për të qenë plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare.¹³⁸ GJK vendosi që zëvendësimi i kandidatëve për deputetë të bëhet duke respektuar fillimisht kuotën gjinore prej 30 për qind dhe nëse plotësohet kuota, atëherë mandati do të caktohet sipas votave të marra.

XIV. PJESËMARRJA E KOMUNITETEVE

Derisa votuesit votuan sipas vijave etnike, zgjedhjet në komunat me shumicë serbe të Kosovës u monopolizuan nga LS-ja, gjë që kufizoi zgjedhjen e votuesve.

Përveç “shumicës” shqiptare të Kosovës, komunitete “joshumicë” janë serbët, turqit, goranët, boshnjakët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët e Kosovës.

Kosova ka një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për të drejtat dhe mbrojtjen e komuniteteve joshumicë që është në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ekzistojnë mekanizma të veçantë të mbrojtjes për përfaqësimin e komuniteteve joshumicë, siç janë vendet e rezervuara në Kuvendin e Kosovës, organet e veçanta komunale si p.sh. nënkryetari për komunitete dhe zëvendës kryesuesi i kuvendit komunal, zëvendëskryeministri dhe ministrat. Prej 38 kryetarëve të komunave të zgjedhur në vitin 2017, 27 ishin nga komuniteti shqiptar i Kosovës, dhjetë nga komuniteti serb i Kosovës dhe një nga komuniteti turk i Kosovës. Situata u përsërit edhe në këto zgjedhje duke konfirmuar edhe një herë se votuesit i bëjnë zgjedhjet e tyre kryesisht sipas vijave etnike.

Statistikat lidhur me përbërjen etnike të Kosovës janë të diskutueshme dhe të kontestuara nga komunitetet. Ata u shtrembëruan më tej nga fakti se shumica dërrmuese e serbëve bojkotuan regjistrimin e fundit të 2011, sipas të cilit shqiptarët e Kosovës përbënin 92.9 për qind të popullsisë, boshnjakët 1.6 për qind, serbët 1.5 për qind, turqit 1.1 për qind, ashkalinjtë 0.9 për qind, egjiptianët 0.7 për qind, goranët 0.6 për qind, romët 0.5 për qind dhe të tjerët 0.1 për qind. Numri i përgjithshëm i popullsisë sipas atij regjistrimi ishte 1,739,825 njerëz. Regjistrimi i ri ishte planifikuar këtë vit, por u shtye për shkak të pandemisë.

Kandidatët jo-shumicë bënë fushatë pothuajse ekskluzivisht në komunitetet e tyre. *Lista Serbe* ka monopolizuar jetën politike në komunat ku serbët e Kosovës janë shumicë duke kufizuar kështu

¹³⁶ Deklarata e shtatorit 2015 është nënshkruar nga 16 subjekte politike për propozime të balancuara gjinore në nivel qendror, komunal dhe vendvotime. LZP-së i mungojnë dispozita për të siguruar pjesëmarrjen e grave në administratën e zgjedhjeve.

¹³⁷ Aktgjykimi i GJK AGJ 1739/21, i datës 29 mars 2021, në rastet KI 45/20 dhe KI 46/20.

¹³⁸ ICCPR, Neni 25, “Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: (a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirishit.”

konkurrencën politike dhe mundësitë e votuesve për të zgjedhur. Në katër komuna,¹³⁹ Kandidati i LS-së ishte i vetmi kandidat serb i Kosovës që garonte për kryetar të komunës. Gjithashtu, në katër komuna,¹⁴⁰ LS-ja ishte e vetmja listë e serbëve të Kosovës në garën për kuvendet komunale. Rastet e frikësimit dhe presionit të drejtpërdrejtë (shpesh kolektiv) nga kandidatët dhe aktivistët e LS-së janë përmendur nga disa bashkëbisedues të EU EOM-së. Ky presion përbëhej kryesisht nga kërcënimet për humbjen e përfitimeve ekonomike (përfshirë vendet e punës). Asnjë nga këto pretendime nuk mundi të konfirmohej.

Gjithsej 188 anëtarë të kuvendeve komunale janë zgjedhur nga partitë joshumicë, duke përfshirë 147 anëtarë të LS-së, 11 të KDTP-së dhe 6 nga Partia Turke e Drejtësisë e Kosovës, kurse të tjerët janë anëtarë të subjekteve më të vogla politike. Ka pasur shumë pak shembuj të kandidatëve nga komunitetet joshumicë që kandiduan në listat e partive shqiptare.

Lëvizja Opre Roma Kosovo (ORK) e udhëhequr nga pesë OSHC ka nisur një sërë aktivitete për të edukuar komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës mbi rëndësinë e votimit, mashtrimin në votim, votën me bindje, pjesëmarrjen politike si dhe të drejtat e njeriut dhe anti-diskriminimi. Qëllimi kryesor i kësaj ishte parandalimi i praktikave të raportuara të përhapura të blerjes së votës në radhët e këtyre komuniteteve. “Takimet publike” të kandidatëve me votuesit romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës u mbajtën në nëntë komuna para ditës së zgjedhjeve. Mbi pesëdhjetë vëzhgues kanë ndjekur aktivitetet e ditës së zgjedhjeve në raundin e parë dhe rreth 30 në raundin e dytë.

Jo të gjitha këto nisma ishin të dukshme sa pritej dhe nuk e ulën blerjen e votave sipas bashkëbiseduesve të EU EOM-së, por ato sigurisht që përbëjnë një hap përpara për sa i përket kundërshtimit të blerjes së votës në këto grupe të cenueshme.

XV. PJESËMARRJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE GRUPEVE TË TJERA TË CENUESHME

Duhet të bëhen më shumë përpjekje për t’ua lehtësuar votuesve me aftësi të kufizuara ushtrimin e të drejtave të tyre.

Kushtetuta ndalon diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar dhe disa instrumente të të drejtave të njeriut që mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Edhe pse Kosova nuk është nënshkruese e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK), ajo ka përfshirë përkufizimin e KDPAK-së për aftësinë e kufizuar në Planin e saj Kombëtar të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar, e cila synon të harmonizojë legjislacionin e Kosovës me KDPAK-në dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare.

Personat me aftësi të kufizuara përfshihen në grupin e personave me nevoja të veçanta që mund të regjistrohen si votues nga shtëpia dhe, në disa komuna organizatat që merren me e aftësinë e kufizuar kanë ndihmuar shumë në regjistrimin e tyre.

Njësia e monitorimit të mediave sociale e EU EOM-së vëzhgoi disa postime të fushatës së LDK-së, PDK-së dhe LVV-së që u drejtoheshin votuesve me aftësi të kufizuara në Facebook dhe Instagram. KQZ-ja përfshiu gjuhën e shenjave në mesazhet për edukimin e votuesve dhe vazhdoi të sigurojë fletëvotimet me

¹³⁹ Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Novobërdë, Ranillug.

¹⁴⁰ Graçanicë, Leposaviq, Novobërdë, Ranillug.

prekje, si dhe broshurat me kandidatët në alfabetin Braille. Për herë të parë në shumë qendra votimi kishte në dispozicion kabinë më të ulët të votimit për personat me karrocë invalidësh ose për të moshuarit. Megjithatë, gjatë raundit të parë, vëzhguesit e BE-së raportuan se vetëm në 67 për qind të vendvotimeve të vizituara ishte siguruar qasja për votuesit me mundësi të kufizuara të lëvizjes, ndërsa në 78 për qind të tyre hapësirat ishin të përshtatshme për votuesit në karrocë invalidësh. Gjatë raundit të dytë, ekipet e BE-së vunë në dukje se vetëm 65 për qind e vendvotimeve të vëzhguara ishin të qasshme për votuesit me aftësi të kufizuara të lëvizjes, ndërsa struktura e vendvotimit ishte e përshtatshme për votuesit në karrocë invalidësh në rreth 85 për qind të vendvotimeve të vizituara. Fletëvotimet me prekje nuk ishin në dispozicion në 33 për qind të qendrave të votimit të vizituara.

Rekomandim: Të miratohet dhe transpozohet KDKPAK e OKB-së në Kushtetutë, në mënyrë që të zbatohen të drejtat e garantuara në të.

XVI. VËZHGIMI NGA SHOQËRIA CIVILE DHE NDËRKOMBËTARE

Mijëra vëzhgues afatshkurtër vendor që përfaqësonin subjektet politike dhe, në një masë më të vogël shoqërinë civile, vëzhguan votimin dhe numërimin, duke rritur kështu transparencën.

Për raundin e parë, numri i përgjithshëm i vëzhguesve dhe mediave të akredituar arriti në 24,593, prej të cilëve 23,092 përfaqësonin subjekte politike; nuk janë vërejtur probleme në procesin e akreditimit.¹⁴¹ Nga 768 vëzhgues të shoqërisë civile, rreth 100 ishin nga Demokracia në Veprim (DnV), koalicioni kryesor vendor për vëzhgim jopartiak, i cili kësaj radhe nuk kreu asnjë vëzhgim gjithëpërfshirës të procesit zgjedhor për shkak të fondeve të kufizuara.

Në tërësi u akredituan 216 vëzhgues ndërkombëtarë, përfshirë edhe ata nga EU EOM-ja, Rrjeti Evropian i Organizatave për Vëzhgimin e Zgjedhjeve dhe nga disa ambasada.

Gjatë raundit të dytë, koalicioni DnV angazhoi rreth 100 vëzhgues të shoqërisë civile në ditën e zgjedhjeve, si në raundin e parë. Vetëm gjysma e vëzhguesve të organizatave të shoqërisë civile të akredituar për raundin e parë i konfirmuan KQZ-së pjesëmarrjen e tyre edhe në raundin e dytë, derisa u akredituan edhe 12 vëzhgues të rinj të OSHC-ve. Subjektet politike akredituan edhe 814 vëzhgues të tjerë dhe duhej të konfirmonin në KQZ përfaqësuesit e tyre që tashmë ishin akredituar për raundin e parë.

XVII. KONTESTET ZGJEDHORE

Procesi ankesave dhe parashtresave dhe në përgjithësi u zhvillua në mënyrë transparente dhe të paanshme, pavarësisht afatit shumë të shkurtër për gjykim. Disa zbrazëti dhe anomali në kornizën ligjore mbeten për t'u adresuar.

PZAP-ja shqyrton të gjitha ankesat dhe parashtresat zgjedhore, përveç ankesave për listën e votuesve dhe ankesave lidhur me mediat. PZAP-ja përbëhet nga 10 gjyqtarë, përfshirë kryesuesin, që emërohet nga gjyqtarët e Gjykatës Supreme (GJS). Ankesat dhe parashtresat mund të bëhen në faza të ndryshme të

¹⁴¹ Sipas nenit 54.1 të LZP-së, “Subjektet politike të certifikuar, OJQ-të dhe organizatat qeveritare e ndër-qeveritare, sikurse edhe organizatat ndërkombëtare (...) kanë të drejtë të kërkojnë akreditim të vëzhguesve”; prandaj ligji nuk bën dallim në përdorimin e fjalës “vëzhgues” bazuar në faktin nëse ata përfaqësojnë një subjekt politik apo organizatë të shoqërisë civile.

procesit zgjedhor nga kushdo që ka interes ligjor ose të cilit i janë shkelur të drejtat zgjedhore.¹⁴² Megjithatë, korniza ligjore përmban dispozita konfuze dhe kundërthënëse, të shpërndara në kapituj të ndryshëm të LZP-së, në lidhje me afatet e caktuara për ankesa dhe parashtrësia.¹⁴³ Sipas ligjit, ankesat dhe parashtrësit mund të dorëzohen brenda një afati prej 24-orësh në PZAP, i cili pastaj i ka 72 orë për të marrë vendim. Ankesa pastaj mund të parashtrëhet brenda 24 orësh në GJS, shkalla e fundit, e cila ka 72 orë për të vendosur. Këto afate u vlerësuan nga të gjithë bashkëbiseduesit e EU EOM-së si jashtëzakonisht të shkurtra, si për palët për të mbledhur prova të forta ashtu edhe për organet e ankesës për t'i vlerësuar dhe shqyrtuar ato në mënyrë gjithëpërfshirëse.¹⁴⁴

Rekomandim: Të zgjaten afatet për paraqitjen e ankesave apo parashtrësive për zgjedhje, dhe për PZAP-në dhe GJS-në për t'i gjykuar ato (në tri deri në pesë ditë, si për paraqitjen e ankesave dhe parashtrësive ashtu edhe për gjykimin e tyre).

Ekziston një anomali në kornizën ligjore në lidhje me afatet kohore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe shpalljen e rezultateve. Ligji nuk parasheh asgjë për ankesat kundër rezultateve përfundimtare, por vetëm për ankesat që kanë të bëjnë me votimin dhe numërimin në qendrat e votimit dhe për procesin e tabelimit në QNR.¹⁴⁵ Këto duhet të dorëzohen brenda një afati prej 24-orësh në PZAP,¹⁴⁶ i cili më pas i ka 72 orë për të vendosur. Megjithatë, kjo krijon vështirësi për PZAP-në, i cili duhet të vlerësojë ndikimin e shkeljeve të supozuara në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve para se rezultatet të publikohen nga KQZ-ja. PZAP-ja e pranon se ekziston kjo anomali dhe, në praktikë, i refuzon ankesat e tilla si të papranueshme ose të parakohshme, por ua mundëson ankuesve t'i parashtrojnë sërish ato pasi KQZ-ja të shpallë rezultatet përfundimtare.

Rekomandim: Të përfshihen dispozita për kontestimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të publikuara nga KQZ-ja. Të qartësohen paqartësitë në lidhje me ankesat lidhur me votimin, numërimin, procesin në QNR dhe afatet e tyre përkatëse.

Procesi i gjykimin në përgjithësi është kryer nga PZAP-ja dhe GJS-ja në mënyrë transparente dhe të paanshme. PZAP-ja ishte në gjendje të përballet me një numër të madh të kërkesave, veçanërisht për zgjedhjet për kuvendet komunale, brenda afateve shumë të shkurtra ligjore. Disa vendime të PZAP-së që urdhëronin një numër të konsiderueshëm të rinumërimeve në zgjedhjet për kuvendet komunale, anulimin e votave jashtë Kosovës për një komunë, anulimin e zgjedhjeve komunale në një tjetër, nxorën në pah disa dobësi të caktuara në kornizën ligjore të cilat duhet të adresohen për të mbrojtur më mirë e drejta themelore për të votuar. Të gjitha parashtrësit, ankesat dhe vendimet janë publikuar në faqen e internetit të PZAP-së, edhe pse qasja do të mund të ishte më e lehtë për përdoruesit.

Për sa i përket votimit, numërimit dhe procesit të tabelimit, janë paraqitur gjithsej 60 ankesa në PZAP pas të dy raundeve të zgjedhjeve, para publikimit të rezultateve përfundimtare. PZAP-ja refuzoi 37 prej tyre si të papranueshme dhe një për shkak të paraqitjes pas afatit.¹⁴⁷ Trembëdhjetë ankesa u refuzuan sepse

¹⁴² Kandidatët, subjektet politike, votuesit.

¹⁴³ Sipas nenit 122.1 të LZP-së, ankesat kundër vendimeve të KQZ-së duhet të parashtrëhen brenda 24 orësh pas shpalljes së vendimit të KQZ-së, ndërsa neni 10 i Rregullores së Punës së PZAP-së për të njëjtat ankesa përcakton një afat prej pesë ditësh.

¹⁴⁴ Komisioni i Venedikut, Kodi i Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore, Udhëzimi II 3.3. g, Raport Shpjegues, para. 95. "Afate kohore për paraqitjen dhe vendosjen për ankesat duhet të jenë të shkurtra (tri deri në pesë ditë për secilën në shkallë të parë)".

¹⁴⁵ Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve i referohen rezultateve paraprake, sipas terminologjisë së përdorur nga KQZ-ja.

¹⁴⁶ 24 orë nga mbyllja e qendrës së votimit, përkatësisht nga momenti kur ankuesi është njoftuar për shkeljen e pretenduar.

¹⁴⁷ Ankuesve iu mundësua të paraqitnin sërish ato pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja.

nuk ishin dorëzuar dëshmi relevante, dhe në gjashtë raste PZAP-ja i ka pranuar pjesërisht ankesat dhe ka sanksionuar disa anëtarë të KVV-ve për parregullsi të vogla. Vetëm tri nga këto ankesa u miratuan nga PZAP-ja. Në dy prej rasteve, EU EOM-ja arriti në përfundim se vendimet e PZAP-së nuk ishin plotësisht në përputhje me ligjin, por të dyja ishin korrigjuar me vendimet e GJS-së pas ankesave.

Në rastin e parë, PZAP-ja çuditërisht anuloi rezultatet e zgjedhjeve për kryetar të komunës në Hanin e Elezit për shkak të pretendimit për blerje votash dhe presion ndaj votuesve nga kandidati i PDK-së për kryetar të komunës. Kjo ankesë nuk u gjykua mirë nga PZAP-ja pasi që dëshmitë e ofruara nga ankuesi ishin të dobëta dhe arsyetimi ligjor i PZAP-së ishte i pamjaftueshëm. Vendimi u anulua nga GJS-ja dhe paneli i ri i PZAP-së e gjobiti PDK-në me €10,100 për thyerjen e heshtjes zgjedhore. GJS-ja e la në fuqi këtë vendim.

Në rastin e dytë, PZAP-ja aprovoi ankesën e PDK-së lidhur me zgjedhjet për kryetar të komunës në Dragash dhe, pas një hetimi, i anuloi të gjitha fletëvotimet prej jashtë Kosovës për shkak të praktikave të manipulimit (*Shih* Tabelimi i rezultateve).¹⁴⁸ Kjo përmbysi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pasi PZAP-ja nuk urdhëroi përsëritjen e votimit jashtë Kosovës në këtë komunë siç parashihet me ligj.¹⁴⁹ Baza ligjore e vendimit nuk ishte përcaktuar qartë dhe disa nga arsyet për shpalljen e pavlefshme nuk parashiheshin në kornizën ligjore.¹⁵⁰ GJS-ja urdhëroi KQZ-në që të përsërisë votimin jashtë Kosovës në këtë komunë. Ky rast demonstroi kornizën e dobët ligjore për votimin jashtë Kosovës, të cilës, ndër të tjera, i mungojnë rregulla gjithëpërfshirëse për pavlefshmërinë e zarfeve prej jashtë Kosovës dhe masat themelore të sigurisë për mbrojtjen e votave.

PZAP-ja po ashtu e aprovoi ankesën e GI *Srpska Narodna Sloga* kundër *Listës Serbe* në Kllokot për blerje të votave dhe praktika të frikësimit në mes të dy raundeve të zgjedhjeve dhe gjobiti *Listën Serbe* me €10,100. GJS e la në fuqi këtë vendim.

Vetëm shtatë ankesa janë paraqitur në PZAP kundër vendimit të KQZ-së për rezultatet përfundimtare për të dy raundet e zgjedhjeve për kryetarë të komunave, në lidhje me mospërputhjet e ndryshme ose për manipulime të pretenduara të rezultateve. Pesë prej tyre ishin refuzuar nga PZAP-ja si të pabazuara, një si *res judicata* dhe një ishte miratuar.¹⁵¹

Numri më i madh i ankesave kishte të bënte me rezultatet përfundimtare për zgjedhjet për kuvendet komunale, kundër të cilave në PZAP u paraqitën 352 ankesa për shkak të pretendimeve për gabime në numërim ose mospërputhje të ndryshme ndërmjet formularëve të rezultateve të vendvotimeve dhe rezultateve përfundimtare të KQZ-së. PZAP-ja mori 92 vendime për 630 rinumërim, duke përfshirë rinumërimet pothuajse të plota në Podujevë dhe Mitrovicën Jugore.¹⁵² Megjithatë, sipas analizës së

¹⁴⁸ Bëhet fjalë për 308 fletëvotime prej jashtë Kosovës të pranuar në 132 pako me zarfe të dërguara me postë nga Austria, Sllovenia, Zvicra, Gjermania dhe Franca. PZAP-ja konsideroi se votimi ishte organizuar në mënyrë të paligjshme, pasi vulat në zarfe kishin përfaqësuar të njëjtën kohë dhe datë, dhe pakot e ndryshme kishin të njëjtin dorëshkrim (nëntë nga 94 pako nga Austria, pesë nga 11 pako nga Gjermania, 19 nga 25 pakot nga Zvicra).

¹⁴⁹ Sipas nenit 120.1.b, LZP-ja kur anuloi rezultatet e një vendvotimi apo qendre të caktuar të votimit PZAP-ja duhet po ashtu të urdhërojë KQZ-në të përsërisë votimin.

¹⁵⁰ 24 zarfe me fletëvotimeve ishin nga adresa të ndryshme nga ajo e shënuar si vendbanim kur ishin regjistruar votuesit, dhe kjo u konsiderua e paligjshme nga PZAP-ja. Megjithatë, ligji hesht për këtë çështje.

¹⁵¹ Një ankesë ishte paraqitur nga GI *Srpska Narodna Sloga* kundër *LS-së* në Kllokot, duke denoncuar blerjen e votave gjatë raundit të parë të zgjedhjeve për kryetar të komunës, nga katër persona të cilët u arrestuan për këtë vepër zgjedhore dhe aktualisht janë nën aktakuzë. PZAP-ja e miratoi dhe e gjobiti LS-në me €8.100. GJS-ja e la në fuqi këtë vendim.

¹⁵² Pjesa tjetër e ankesave kundër rezultateve përfundimtare për kuvendet komunale në përgjithësi u refuzuan nga PZAP-ja për mungesë provash. Kundër këtyre vendimeve janë paraqitur 26 ankesa në GJS, e cila i ka refuzuar 24 prej tyre si të pabazuara. Vetëm një u pranua dhe GJS urdhëroi KQZ-në të verifikojë votat e fituara nga ankuesi Dardan Krasniqi

rezultateve të bërë nga EU EOM-ja, në shumë raste, shkalla e gabimeve të pretenduara nga ankuesit do të ishte e pamjaftueshme për të përmbysur rezultatin dhe dëshmitë e ofruara nganjëherë ishin të kufizuara ose jo të përshkruara qartë në arsyetimin ligjor të vendimit.¹⁵³ Rinumërimi çoi në ndryshime në rezultatet në tri raste.

Pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike (në PZAP dhe GJS), në rast të shkeljes së të drejtave dhe lirive individuale, ankuesit mund ta referojnë rastin në GJK, brenda një afati prej katër muajsh nga vendimi i GJS-së. Në praktikë, përmes disa vendimeve, GJK-ja ka vendosur për zbatimin e dispozitave të paqarta të LZP-së, si për shembull atyre që kanë të bëjnë me afatin për pranimin e fletëvotimeve prej jashtë Kosovës, procedurën për zëvendësimin e deputetëve dhe disa kushte për certifikimin e kandidatëve. Këto vendime mund të përfshihen në një reformë të ardhshme zgjedhore për të shmangur zbatimin antikushtetues të ligjit nga KQZ-ja dhe shkalla e apelit.

XVIII. VOTIMI DHE NUMËRIMI

Një votim i organizuar mirë, por numërimi dhe veçanërisht plotësimi i formularëve të rezultateve u karakterizua me vështirësi në gjysmën e vendvotimeve të vizituara.

RAUNDI I PARË I ZGJEDHJEVE PËR KRYETARË DHE KUVENDE TË KOMUNAVE, 17 TETOR 2021

Në ditën e zgjedhjeve¹⁵⁴ vëzhguesit e BE-së raportuan nga rreth 385 vendvotime në të 38 komunat. Në përgjithësi, votimi u zhvillua në mënyrë të qetë dhe të rregullt dhe dita e zgjedhjeve u vlerësua nga vëzhguesit e BE-së si shumë e mirë ose e mirë në 99 për qind të vendvotimeve të vizituara.

Hapja e vendvotimeve është vëzhguar në 41 vendvotime në 28 komuna. Rreth 22 për qind e vendvotimeve të vizituara (9 VV) u hapën me 10 minuta vonesë, ndërsa vetëm një u hap me tridhjetë minuta vonesë. Materiale të fushatës ishin të pranishme në afërsi prej 100 metrash në katër për qind të vendvotimeve të vizituara.

Gjatë votimit, janë vërejtur probleme procedurale në dy për qind të vendvotimeve të vizituara, si p.sh. moskontrollimi i duhur i ngjyrës në hyrje të vendvotimit; megjithatë kjo nuk ndikoi në integritetin e përgjithshëm të votimit. Veçanërisht, në 78 nga 385 vendvotimet e vizituara, votuesit me letërnjoftime të skaduara nuk u lejuan të votojnë, në kundërshtim me vendimin përkatës të KQZ-së. Kjo tregon se ka pasur mungesë të trajnimit. Vetëm në 18 për qind e vendvotimeve të vëzhguara kryesuesja e KVV-së ishte grua, ndërsa në 20 për qind të këtyre vendvotimeve nuk kishte asnjë grua në mesin e anëtarëve të KVV-së.

(Demokratët për Drenasin), në komunën e Gllgocit, për shkak të mospërputhjeve në mes të numrit të votave që ankuesi kishte në FRK dhe rezultateve përfundimtare të publikuara nga KQZ-ja. Megjithatë, edhe pas këtij verifikimi rezultatet nuk ndryshuan.

¹⁵³ Analiza e EU EOM-së për 92 vendimet e PZAP-së për aprovimin e rinumërimeve tregon se: në 11 për qind të rasteve ankuesi veç e kishte fituar një ulëse në kuvendin komunal bazuar në rezultatet përfundimtare; diferenca në numrin e votave ndërmjet ankuesit dhe kandidatit të fundit të kualifikuar që mori një ulëse në kuvend ishte prej zero deri në dhjetë vota në 14 për qind të rasteve, prej njëmbëdhjetë deri në pesëdhjetë vota në 22 për qind të rasteve, dhe më shumë se 51 vota në rastet e tjera.

¹⁵⁴ Për raundin e parë, periudha e votimit jashtë Kosovës zgjati 31 ditë nga 15 shtatori deri më 15 tetor. Janë pranuar gjithsej 5649 pako të fletëvotimeve prej jashtë Kosovës me 10.934 fletëvotime me postë; prej tyre, 9,610 u konfirmuan si të vlefshme para se të dërgoheshin në QNR për numërim.

Votimi me asistencë është vërejtur në 72 për qind të vendvotimeve të vizituara. Arsyeja e asistencës është shënuar në librin e votimit, siç kërkohet, në 92 për qind të atyre vendvotimeve.¹⁵⁵ Në nëntë për qind të vendvotimeve të vizituara është vërejtur votimi në grup/familje. Vëzhguesit e BE-së raportuan praninë e vëzhguesve të partive politike në 92 për qind të vendvotimeve të vizituara dhe të vëzhguesve vendorë jopartiakë në vetëm 14 për qind të tyre.

Nuk janë vërejtur raste tensioni, përveç në një vendvotim në Mamushë, ku numri tepër i madh i vëzhguesve partiakë të pranishëm gjatë mbylljes ka çuar në rrëmujë dhe ndërhyrje të policisë. Në pesë komuna, gjashtë incidente lidhur me zgjedhjet, të cilat u hetuan nga Prokurori i Shtetit, çuan në arrestimin e trembëdhjetë personave nën pretendimin se kanë kryer vepra penale kundër të drejtave të votimit sipas Kodit Penal.¹⁵⁶

Numërimi i votave ishte më pak pozitiv. Në gjashtë nga 31 numërimet e vëzhguara, u vlerësua si i keq ose shumë i keq, kryesisht për shkak të mospërputhjeve në respektimin e disa procedurave. Prania e personave të paautorizuar është vërejtur në pesë vendvotime, ndërsa persona që kanë ndërhyrë në mënyrë të padrejtë në proces janë vërejtur gjithashtu në pesë vendvotime. Kryesisht, këta persona kanë qenë kryesues të vendvotimeve të tjera në të njëjtëven QV ose koordinatorë të VV-ve, duke ndihmuar kryesuesit e VV-ve të këtyre vendvotimeve të plotësojnë formularët e rezultateve për të përshpejtuar procesin. Numërimi u krye në prani të vëzhguesve të partive politike në 93 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, ndërsa vëzhguesit vendorë jopartiakë ishin të pranishëm vetëm në pesë nga 31 vendvotimet e vëzhguara. Probleme me përputhjen e fletëvotimeve janë vërejtur në shtatë nga 31 vendvotimet e vëzhguara. Vështirësi në plotësimin e formularëve të rezultateve për kryetar të komunës dhe kuvende janë vërejtur në 16 vendvotime dhe formularët e rezultateve të kandidatëve për kuvend në 12 nga 31 vendvotimet e vëzhguara. Në përgjithësi, gabime apo lëshime të konsiderueshme procedurale janë vërejtur në shtatë nga 31 vendvotimet e vëzhguara.

Ekipe të BE-së vëzhguan marrjen e materialeve nga vendvotimet në 28 KKZ; nuk kishte vëzhgues të tjerë të pranishëm në asnjë prej KKZ-ve. Në 13 KKZ është dashur të bëhen korrigjime para pranimi të materialeve. Në të gjitha KKZ-të përveç njëjës, procesi u karakterizua si i mirë ose shumë i mirë nga vëzhguesit e BE-së.

Rekomandim: Të intensifikohet trajnimi i stafit zgjedhor për të adresuar mangësitë e vazhdueshme si mosrespektimi konsekuent i procedurave të numërimit të votave dhe plotësimi i gabuar i formularëve të rezultateve.

RAUNDI I DYTË I ZGJEDHJEVE PËR KRYETARË TË KOMUNAVE, 14 NËNTOR 2021

Në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave,¹⁵⁷ vëzhguesit e BE-së vizituan 263 vendvotime në të 21 komunat ku u zhvillua raundi i dytë. Vëzhgimi i hapjes së vendvotimeve u bë në 19 nga 21

¹⁵⁵ Neni 89.5 i LZP-së përcakton se një person, i cili nuk duhet të jetë anëtar i KVV-së apo vëzhgues, mund të ndihmojë vetëm një votues për të hedhur votën e tij/saj. Megjithatë, nuk ka asnjë mënyrë praktike që kryetari i KVV-së të verifikojë nëse personi ka ndihmuar votuesit e tjerë në vendvotimet e tjera. Me synimin për të penguar manipulimin e votuesve përmes votimit të ndihmuar, gjatë procesit aktual zgjedhor KQZ-ja prezantoi kushtin që kryetari i KVV-së të mbajë shënime për personat që ndihmuar votuesit dhe të shënojë në Librin e Votimit arsyen e ndihmës për secilin rast.

¹⁵⁶ Në Kllokot, Suharekë, Malishevë, Skenderaj, Fushë Kosovë. Incidentet kishin të bënin me shkelje si blerja e votës, pengimi i procesit të votimit, cenimi i fshehtësisë dhe falsifikimi i rezultateve.

¹⁵⁷ Për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunës, periudha e aplikimit për votim jashtë Kosovës zgjati 15 ditë nga data 29 tetor deri më 12 nëntor. Janë pranuar gjithsej 1,571 pako të fletëvotimeve prej jashtë Kosovës me 2,658 fletëvotime me postë dhe 2,379 janë konfirmuar si të vlefshme para se të vazhdohet me numërimin e tyre.

komunat. Vëzhguesit e BE-së raportuan se shumica e vendvotimeve u hapën me kohë ose me një vonesë të shkurtë prej më pak se 10 minutash. Kryesuesi i KVV-së ishte mashkull në 81 për qind të vendvotimeve të vizituara, ndërsa vetëm 31 për qind e të gjithë anëtarëve të KVV-ve në vendvotimet e vizituara ishin gra. Për më tepër, 24 për qind e VV-ve të vëzhguara nuk kishin asnjë grua në mesin e anëtarëve të KVV-së.

Votimi ka vazhduar gjatë tërë ditës në mënyrë të qetë dhe të rregullt, me përjashtim të incidenteve të izoluar në Junik.¹⁵⁸ Dy persona janë arrestuar për blerje të votës në Kamenicë.

Në të gjitha vendvotimet e vizituara është respektuar fshehtësia e votës. Megjithatë, në 13 për qind të vizitave, votuesit me letërnjoftime të skaduar të Kosovës nuk janë lejuar të votojnë, ndërsa në shumë vendvotime të vizituara janë pranuar lloje të ndryshme të dokumenteve të skaduar për identifikimin e votuesve (përfshirë pasaportat dhe patentë shoferët), të gjitha këto në mospërputhje me vendimin përkatës të KQZ-së.

Votimi me asistencë u regjistrua në librat e votimit në 70 për qind të vendvotimeve të vizituara. Mosnjohja e procedurave të votimit, moshja e shtyrë, shikimi i dobët dhe analfabetizmi përbënin shumicën dërrmuese të arsyeve të paraqitura për votim me asistencë. Sipas të dhënave preliminare të ndara nga KQZ-ja të nxjerra nga 67,28 për qind e vendvotimeve në Kosovë, janë shënuar 32,109 raste të votimit me asistencë. Votimi në grup/familje është vërejtur në 6 për qind të vendvotimeve të vizituara.

Rekomandimi: Votimi me asistencë në vendvotime të rregullohet në mënyrë më të rreptë, për shembull duke kërkuar që personi që ndihmon një votues të jetë i regjistruar në të njëjtin vendvotim.

Prania e vëzhguesve të akredituar të subjekteve politike gjatë votimit është vërejtur në 97 për qind të vendvotimeve të vizituara, por vëzhgues të shoqërisë civile në vetëm 4 për qind. Në përgjithësi, vëzhguesit e EU EOM-së e vlerësuan votimin si shumë të mirë ose të mirë në 99 për qind të vendvotimeve të vizituara, në të 21 komunat.

Numërimi u krye në mënyrë transparente ku vëzhguesit e partive politike ishin të pranishëm në të 22 vendvotimet ku EU EOM-ja e vëzhgoi numërimin; vëzhguesit e shoqërisë civile ishin të pranishëm vetëm në dy nga vendvotimet e vizituara. Procedurat lidhur me përputhjen e fletëvotimeve nuk u respektuan plotësisht në rreth një të tretën e 22 vendvotimeve të vëzhguara, gjë që çoi në vështirësi në plotësimin e Formularit të Përputhjes së Rezultateve (FPR) në tri prej atyre vendvotimeve. Megjithatë, procedura e përgjithshme e numërimit u vlerësua si shumë e mirë në 64 për qind dhe e mirë në 36 për qind të vendvotimeve të vëzhguara.

Procedurat e pranimit të materialit në KKZ u vlerësuan si të qeta, të shpejta dhe efikase nga të gjithë vëzhguesit e BE-së. Në gjashtë nga 20 KKZ-të e vizituara nga vëzhguesit e BE-së është dashur të bëhen korrigjime për sa i përket materialeve që nuk ishin paketuar si duhet dhe formularëve të rezultateve që nuk ishin plotësuar tërësisht. Nuk janë vërejtur gabime procedurale në asnjë nga KKZ-të e vizituara. Në përgjithësi, vëzhguesit e BE-së e vlerësuan procedurën e pranimit të materialeve si shumë të mirë në 80 për qind dhe si të mirë në 20 për qind të KKZ-ve të vizituara.

¹⁵⁸ Djali i kandidatit të LDK-së e kërcënoi menaxherin e vendvotimit se ia kishte ndaluar hyrjen në vendvotim (ai nuk ishte vëzhgues i akredituar). Në një rast tjetër, një ish-deputet i LVV-së pati një grindje me një zyrtar të zgjedhjeve. Në të dyja rastet u detyrua të ndërhyjë policia.

XIX. TABELIMI I REZULTATEVE DHE MJEDISI PASZGJEDHOR

Tabelimi i organizuar mirë dhe efikas i rezultateve u krye me transparencë të plotë, por rinumërimet e shumta shfaqën dobësi të numërimit në nivel të KVV-ve.

TABELIMI I REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE PËR KUVENDET KOMUNALE DHE TË RAUNIT TË PARË PËR KRYETARË TË KOMUNAVE

Gjatë ditëve të zgjedhjeve të të dy raundeve, KQZ-ja publikoi në faqen e saj të internetit të dhëna për pjesëmarrjen e votuesve dhe, pas përfundimit të numërimit, rezultatet e parakohshme preliminare të zgjedhjeve për kryetarë të komunave dhe rezultatet e subjekteve politike të zgjedhjeve për kuvendet komunale, por jo votat preferenciale për kandidatët. Derisa KKZ-të përgatisin rezultatet preliminare bazuar në FPR, siç parasheh neni 68.1(g) i LZP-së, kjo nuk është bërë në mënyrë konsekuente dhe as nuk është publikuar, pasi KQZ-ja është mbështetur në të dhënat e K-Vote të mbledhura nga stafi i vendosur në të gjitha qendrat e votimit. Kjo u dha subjekteve politike mundësi që t'i krahasojnë rezultatet e parakohshme të KQZ-së me rezultatet e mbledhura nga vëzhguesit e tyre në vendvotime.

Materialet e ndjeshme të zgjedhjeve janë bartur nga KKZ-të në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) në Prishtinë. Gjatë procesit të pranimit, QNR-ja identifikoi një numër të vogël të vendvotimeve me probleme në lidhje me ndryshimin e numrave të vulave të sigurisë së kutive të votimit, formularë të panëshkruar të rezultateve dhe mospërputhje mes numrit të nënshkrimeve të votuesve në Listën e Votuesve me Kusht (LVK) dhe numrit të zarfeve të fletëvotimeve me kusht (ZVK). Për këto arsye është bërë rinumërimi i tetë kutive të votimit për zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe 15 kutive për zgjedhjet për kuvendet komunale.

Pas procesit të futjes së të dhënave “në mënyrë të dyfishtë të verbër” dhe auditimit të formularëve që paraqitnin probleme, u rinumëruan edhe tetë kuti të tjera për zgjedhjet për kryetarë të komunave. Tabelimi i rezultateve për zgjedhjet për kuvendet komunale doli të ishte më i ndërlikuar pasi u urdhërua rinumërimi i 35 kutive të votimit kryesisht për shkak të gabimeve matematikore në përputhje.

Procesi i mëpastajmë i auditimit¹⁵⁹ evidentoi mospërputhje të tjera dhe vazhdoi me rinumërimet të tjera të 91 kutive të votimit për një varg arsyesh, kryesisht për shkak të mospërputhjeve në formularët e rezultateve të zgjedhjeve për kuvendet komunale mes numrit të votave të fituara nga subjektet politike (Formulari i Përputhjes së Rezultateve – FPR) dhe nga kandidatët e tyre (Formulari i Rezultateve të Kandidatëve – FRK). Edhe rinumërimi i plotë i 200 kutive të tjera të votimit për zgjedhjet për kuvendet komunale është urdhëruar kryesisht për të njëjtën arsye. Këto rinumërimet nisën më 30 tetor dhe përfunduan më 2 nëntor.

KQZ-ja shpalli rezultatet e zgjedhjeve për kryetarë të komunave më 28 tetor dhe i certifikoi ato për 34 komuna më 29 tetor. Pas shqyrtimit të ankesave nga PZAP-ja, rezultatet e zgjedhjeve për kryetar të komunës të tri komunave u certifikuan më 3 nëntor dhe rezultatet për kryetar të komunës së fundit

¹⁵⁹ Siç parashihet në Rregullën e KQZ-së 06/2013, QNR ka bërë një auditim të mostrës së rastësishme prej 10 për qind të rezultateve të vendvotimeve për zgjedhjet për kuvendet komunale. Nga 255 vendvotimet e përzgjedhura dhe të audituara në mënyrë të rastësishme, më 29 tetor KQZ-ja urdhëroi rinumërimin e plotë të 91 prej tyre (ose 36 për qind). Lista e vendvotimeve që do të auditoheshin është përgatitur para ditës së zgjedhjeve. Për të ruajtur autenticitetin e mostrës së rastësishme, ajo nuk u bë publike as për KKZ-të dhe as për KVV-të.

(Kllokot) u certifikuan më 5 nëntor, ndërsa rezultatet për kuvendet komunale po ashtu u shpallën në të njëjtën ditë.

Në total, pas pranimit të materialeve nga KKZ-të dhe pas procesit të futjes së të dhënave KQZ/QNR urdhëruan të rinumërohen fletëvotimet për kuvendet komunale nga 341 vendvotime, si dhe fletëvotimet për kryetarë të komunave nga 16 vendvotime. Ndërsa niveli i lartë i verifikimit të tabelimit në QNR, i cili funksionon pa kufizime kohore për shkak se nuk ka afate kohore për shpalljen e rezultateve nga KQZ-ja, rezultoi të jetë thelbësor për saktësinë e rezultateve, këto rinumërimet ngadalësuan ndjeshëm shpalljen e rezultateve si dhe certifikimin e tyre. Megjithatë, ka një përmirësim në krahasim me zgjedhjet e fundit të shkurtit 2021, pasi në këto zgjedhje, numri prej 357 rinumërimëve të urdhëruara nga QNR/KQZ, që është treguesi kryesor i gabimeve dhe lëshimeve të anëtarëve të KVV-ve, është më i ulët se në zgjedhjet e kaluara.¹⁶⁰

Pas shqyrtimit të ankesave të shumta kundër rezultateve të zgjedhjeve për kuvendet komunale, PZAP urdhëroi rinumërimin edhe të 630 vendvotimeve. Këto rinumërimet bënë që procesi i tabelimit të vazhdoj deri në mbrëmjen e raundit të dytë të zgjedhjeve të 14 nëntorit.

Numri i madh i rinumërimëve të rezultateve të zgjedhjeve për kuvendet komunale nuk tregon vetëm për një problem serioz me përpunimin dhe plotësimin e formularëve të rezultateve nga anëtarët e KVV-ve, shumica dërrmuese e të cilëve e kaluan me sukses provimin me shkrim pas trajnimit të tyre për raundin e parë, por edhe për gabimet gjatë transferimit të të dhënave nga formularët e kandidatëve në FRK dhe për sjelljen e keqe të mundshme nga disa anëtarë të KVV-ve.¹⁶¹

Gjatë procesit të tabelimit, KQZ-ja postoi në faqen e saj të internetit formularët e skanuar të rezultateve të vendvotimeve. Numri i fletëvotimeve të pavlefshme në raundin e parë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, sipas llogaritjeve të EU EOM-së bazuar në të dhënat e ndara sipas komunave të publikuara nga KQZ-ja, ishte 1.6 për qind dhe numri i fletëvotimeve të zbrazëta afër 1 për qind. Nga ana tjetër, numri i fletëvotimeve të pavlefshme në zgjedhjet për kuvendet komunale arriti në pothuajse 7 për qind, duke treguar për aktivitetet e pamjaftueshme për informimin e votuesve ose dizajn tepër të ndërlikuar të fletëvotimeve, dhe numri i fletëvotimeve të zbrazëta në pothuaj 1.6 për qind.

Rekomandim: Të ridizajnohen fletëvotimet për zgjedhjet për kuvendet komunale për tu kuptuar më mirë nga votuesit dhe të shtohen informacionet për votuesit se si të shenjojnë si duhet fletëvotimin në mënyrë që të zvogëlohet numri i votave të pavlefshme.

Në përgjithësi, vëzhguesit e BE-së e vlerësuan tabelimin si transparent dhe të organizuar mirë. Aktivitetet në QNR u zhvilluan në prani të vëzhguesve nga subjektet politike, të cilët nuk parashtruan ankesa kundër procesit të tabelimit dhe nuk raportuan për ndonjë problem tek vëzhguesit e EU EOM-së. Për të rritur transparencën, QNR kishte vendosur 50 kamera në vendet ku regjistroheshin të dhënat dhe tabelat e numërimit, e po ashtu duke ndarë raportet ditore të progresit dhe të dhëna të detajuara për çdo pjesë të procesit me palët e interesuara. Megjithatë, të dhënat nuk ishin gjithmonë të strukturuar në një mënyrë që do të lehtësonte analizën dhe korrelacionet ndërmjet grupeve të ndryshme të të dhënave nganjëherë ishin të paqarta, duke e bërë të vështirë vlerësimin e koherencës së tyre.

¹⁶⁰ QNR/KQZ kishin urdhëruar 564 rinumërimet në zgjedhjet e shkurtit 2021 dhe 730 rinumërimet u urdhëruan nga KQZ/QNR gjatë raundit të parë të zgjedhjeve komunale dhe për kryetarë të komunave në vitin 2017.

¹⁶¹ Sipas raportit përfundimtar të KQZ-së për aktivitetet e trajnimit, nga 14,855 anëtarë të KVV-ve që janë trajnuar për raundin e parë, vetëm 20 nuk e kanë kaluar provimin me shkrim.

EU EOM-ja analizoi formularët e rezultateve të zgjedhjeve për kuvendet komunale të vendvotimeve ku u bënë rinumërimet për shkak të mospërputhjeve në formularët e rezultateve ndërmjet votave të subjekteve politike (FPR) dhe votave të kandidatëve (FRK).¹⁶² Në këto, EU EOM-ja identifikoi një model të gabimeve nga të cilat përfituan të gjitha subjektet politike, por kryesisht ato kryesore.¹⁶³ Në mënyrë të veçantë, në shumicën e këtyre vendvotimeve, gjatë plotësimit të FRK-ve, disa kandidatëve iu atribuuan më shumë vota se sa që kishin fituar dhe ky numër më i lartë ishte kryesisht identik me numrin e tyre rendor në fletëvotim. Ky model me siguri tregon për një gabim të mundshëm njerëzor për shkak të lodhjes dhe kompleksitetit të fletëve të rezultateve të kandidatëve dhe FRK-ve, ndonëse nuk mund të përjashtohen raste të izoluar të keqberjes së qëllimshme.

Duke qenë se plotësimi i detajuar i tabelave është i domosdoshëm për pranimin e rezultateve nga palët e interesuara zgjedhore dhe për besimin e tyre në procesin zgjedhor, 987 rinumërimet (40 për qind) e kryera për raundin e parë të zgjedhjeve nxjerrin në pah nevojën për një rishikim gjithëpërfshirës të të gjithë formularëve të rezultateve dhe fletëve të rezultateve të kandidatëve, të kriterëve të rekrutimit si dhe të trajnimit të anëtarëve të KVV-ve dhe kryesisht të domosdoshmërisë për të rishikuar përbërjen e Komisionëve të Vendvotimeve.

TABELIMI I REZULTATEVE TË RAUNDIT TË DYTË TË ZGJEDHJEVE PËR KRYETARË TË KOMUNAVE

Në përgjithësi, tabelimi i rezultateve të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave ishte më i lehtë dhe më i shpejtë se sa në raundin e parë, për shkak të numrit më të vogël të komunave ku u votua, si dhe thjeshtësisë së formularit të rezultateve që duhej të plotësohej.

Gjatë pranimit të materialeve të ndjeshme nga KKZ-të, nuk pati asnjë kuti të votimit që është dashur të rinumërohet për shkak të parregullsive, përveç një vendvotimi në Prizren ku ka pasur dy zarfa të votimit me kusht (ZVK) por vetëm një nënshkrim në LVK.¹⁶⁴ Pas futjes së formularëve të rezultateve në sistem, nuk pati asnjë që nuk e kaloi auditimin dhe nuk është bërë asnjë rinumërim.

Gjatë një mbledhjeje të KQZ-së më 16 nëntor, disa anëtarë të KQZ-së ngritën çështjen e shkrimit të ngjashëm në pakot me zarfet e fletëvotimeve postare prej jashtë Kosovës për Mamushë, Junik dhe Dragash; shtyrja e numërimit për këto komuna në mënyrë që SKQZ-ja të hetonte këtë çështje u hodh në votim, dhe vetëm katër anëtarë votuan 'për'.¹⁶⁵ Më pas numërimi filloi menjëherë pas takimit dhe u përfundua në të njëjtën ditë. Fletëvotimet jashtë Kosovës për zgjedhjet për kryetar të komunës në Dragash patën ndikim vendimtar në rezultate, pasi kandidati i LDK-së mori 244 vota prej jashtë Kosovës dhe për këtë arsye ia mori epërsinë kandidatit të PDK-së, i cili fillimisht ishte përpara me 47 vota pas numërimit të votave të rregullta.

¹⁶² EU EOM-ja veçanërisht analizoi fletët e rezultateve të 291 vendvotimeve ku QNR/KQZ kishte urdhëruar rinumërimin dhe u fokusua në ato rezultate ku kandidatët kishin marrë numër më të madh të votave se subjekti i tyre politik (154 rezultate të vendvotimeve nga 291).

¹⁶³ PDK, LDK, LVV dhe AAK dhe herë pas here edhe NISMA dhe AKR.

¹⁶⁴ Para se ta hap, KQZ-ja vendosi të anulojë ZVK-në që nuk kishte nënshkrimin përkatës në LVK-në e asaj qendre votimi.

¹⁶⁵ Dy anëtarët e PDK-së dhe ata të AAK-së dhe LS-së votuan për shtyrjen e numërimit.

Numërimi i fletëvotimeve me kusht dhe të VPNV-ve, që ishte pjesa e fundit që u tabelua në QNR, filloi më 18 nëntor dhe u mbyll brenda pak orësh, me transparencë të plotë në prani të vëzhguesve dhe mediave. Kishte gjithsej 10,303 vota me kusht dhe VPNV; prej tyre 9,313 u konfirmuan dhe 990 u refuzuan.¹⁶⁶

KQZ shpalli rezultatet përfundimtare më 20 nëntor. Ankesat e më pastajme të dorëzuara në PZAP (*Shih* Kontestet Zgjedhore) rezultuan me anulimin e rezultateve nga votimi jashtë Kosovës për komunën e Dragashit. Shpallja e 298 fletëvotimeve prej jashtë Kosovës si të pavlefshme në këtë komunë tregon për një mungesë në rregullimin e procedurave për regjistrimin dhe verifikimin e votuesve jashtë Kosovës. Ndonëse SKQZ-ja bëri një verifikim të zarfeve të votave me postë dhe të dhënave të votave përpara se QNR-ja të vazhdonte me numërimin, kjo u bë në përputhje me kriteret e përcaktuara me Rregullën e Zgjedhjeve nr.03/2013 dhe nuk aplikohet për çështjet që lidhen me autenticitetin e dorëshkrimit për të cilin KQZ-së i mungon ekspertiza dhe për ndonjë veprim të keq të mundshëm.¹⁶⁷ Në mungesë të bazës ligjore apo procedurave që do t'i mundësonin KQZ-së të shtyjë numërimin e votave prej jashtë Kosovës nga kjo komunë për një hetim që do të kryhet nga autoritetet tjera kompetente, si policia apo shërbimet mjeko-ligjore, vendimi për të vazhduar me numërim dukej i vetmi vendim i matur që mund të merrte KQZ-ja.

REZULTATET PËRFUNDIMTARE

Pjesëmarrja në raundin e parë ishte 42.72 për qind dhe në raundin e dytë 37.08 për qind. Ashtu si në vitin 2017, kandidatët e LS-së fituan zgjedhjet për kryetar të komunës në të dhjetë komunat ku serbët e Kosovës janë shumicë (nëntë në raundin e parë, një në të dytin). PDK-ja fitoi nëntë pozita të kryetarëve të komunave (katër në raundin e parë dhe pesë në raundin e dytë) duke përfunduar ndjeshëm praninë e saj në rajone pasi që deri më tani kishte pesë kryetarë të komunave. LDK-ja mbajti të njëjtin numër të kryetarëve të komunave duke siguruar shtatë pozita (dy në raundin e parë dhe pesë në raundin e dytë) dhe AAK fitoi pesë pozita në krahasim me gjashtë sa kishte në vitin 2017 (dy në raundin e parë, tri në të dytin). Dymbëdhjetë kandidatë për kryetar të komunës të LVV-së në pushtet u kualifikuan për raundin e dytë, por vetëm katër arritën të fitojnë. Përderisa LVV-ja i përforcoi pak asetet e saj politike, kryesisht nëpër kuvende të komunave, humbjet në garat për kryetar të komunës, në veçanti në Prishtinë dhe Prizren, u portretizuan si dështim i partisë.

Nga 29 kryetarët ekzistues të komunave që kandiduan, 20 siguruan rizgjedhjen e tyre, duke përfshirë pesë nga AAK dhe katër nga LS, LDK dhe PDK. Nëntë fituan në raundin e parë, njëmbëdhjetë në raundin e dytë.

Sa i përket ulëseve në kuvendet komunale, LDK, PDK dhe AAK në përgjithësi ruajtën status quo-në nga zgjedhjet e vitit 2017, ku LDK dhe PDK morën nga 206 ulëse dhe AAK 120 ulëse. LVV fitoi 193 ulëse në kuvendet komunale, duke rritur përfaqësimin e tyre me mbi 30 për qind. LS me 147 ulëse dominon kuvendet komunale në komunat me shumicë serbe të Kosovës, në disa prej tyre është e vetmja forcë politike.

¹⁶⁶ Arsyeja e refuzimit ishte se votuesi me kusht kishte votuar më shumë se një herë, ose nuk ishte në LPV ose nuk ishte i regjistruar në komunën ku ai/ajo votoi me kusht.

¹⁶⁷ SKQZ-ja verifikon nëse dërguesit janë regjistruar me sukses si votues jashtë Kosovës, nëse ata kanë dërguar një kopje të letërnjoftimit bashkë me fletëvotimin e tyre siç kërkohet me ligj, dhe nëse pakoja e tyre është dërguar brenda afatit ligjor.

XX. REKOMANDIMET

NR.	RP Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI:	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PËRKATËS RAJONAL/NDËRKOMBËTAR
ADMINISTRATA ZGJEDHORE						
1.	Fq.10	Formulimi i paqartë i paragrafit (d) të nenit 61.5 të LQP-së që mundëson largimin e kryesuesit ose një anëtarit të KQZ-së nëse ata sillen ose veprojnë “në atë mënyrë që e dëmton seriozisht statusin dhe integritetin e KQZ-së”, nuk është në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare të cilat përcaktojnë se arsyet për largim duhet të “përcaktohen qartë dhe në mënyrë kufizuese në ligj”.	Të ndryshohet LQP për të përcaktuar qartë dhe në mënyrë kufizuese arsyet për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të KQZ-së.	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LQP) Neni 61.5 (d)	Kuvendi i Kosovës (Kuvendi)	Zgjedhje të mirëfillta që pasqyrojnë shprehjen e lirë të vullnetit të votuesve Praktika e mirë Komisioni i Venedikut, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, 2002, Pika 3.1 f: “Organet që caktojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore nuk duhet të kenë dorë të lirë për t’i shkarkuar ata sipas dëshirës”. dhe para. 77: “Përgjithësisht, organet që emërojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore nuk duhet të jenë të lira t’i shkarkojnë ata sa herë të duan, sepse kjo ngre dyshime për pavarësinë e tyre. Shkarkimi sipas diskrecionit është i papranueshëm, por shkarkimi për arsye disiplinore është i lejueshëm – me kusht që arsyet për këtë të jenë të qarta dhe të mbështetura në mënyrë rigorozë në ligj (arsye të paqarta të natyrës “akte që diskreditojnë komisionin” nuk janë të mjaftueshme).”

2.	Fq.12	Pas raundit të parë, KQZ-ja miratoi një formulë të re të përbërjes së KVV-ve për të siguruar që kandidatët që marrin pjesë në raundin e dytë të përfaqësoheshin në KVV. Ajo po ashtu organizoi trajnime shtesë, si për anëtarët që tashmë kishin punuar në raundin e parë ashtu edhe për anëtarët e rinj të KVV-ve, pas zëvendësimit të 806 anëtarëve nga KQZ-ja dhe anëtarëve të tjerë të KVV-ve nga disa subjekte politike për shkak të performancës së dobët gjatë numërimit dhe pasaktësive në plotësimin e formularëve të rezultateve.	Të krijohet një pozitë administrative jopartiake e sekretarit të KVV-së për të ofruar këshilla dhe asistencë të nevojshme për KVV-në që të përmirësoj efikasitetin dhe performancën e tyre.	LZP Rregulla Zgjedhore e KQZ-së Nr.19/2016	Kuvendi KQZ	<p>Zgjedhje të mirëfillta që pasqyrojnë shprehjen e lirë të vullnetit të votuesve</p> <p>Praktika e mirë Komisioni i Venedikut, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, Raporti shpjegues – “104. Cilësia e sistemeve të votimit dhe numërimit të votave dhe respektimi i duhur i procedurave zgjedhore varen nga mënyra e organizimit dhe funksionimit të vendvotimeve.”</p>
3.	Fq.12	Pavarësisht se neni 107.3 i LZP-së udhëzon KQZ-në që gjatë zhvillimit të fushatës për edukimin e votuesve “t’i kushtojë vëmendje të veçantë votuesve në zonat rurale, me aftësi të kufizuara dhe analfabetë” aktivitetet e zhvilluara nga KKZ-të, të cilat kanë qasje dhe i kuptojnë më mirë nevojat e votuesve në komunat e tyre, u kufizuara në vendosjen e posterave informues të dërguar nga KQZ-ja.	Tu jepen më shumë përgjegjësi KKZ-ve lidhur me edukimin dhe informimin e votuesve dhe gjithashtu të angazhohen organizatat e shoqërisë civile në mbarë Kosovën. Duhet të adresohen grupe të veçanta të synuara, si gratë, votuesit në zonat rurale, votuesit për herë të parë dhe personat me aftësi të kufizuara.	Asnjë ndryshim ligjor.	KQZ	<p>E drejta dhe mundësia për të votuar Transparenca dhe qasja në informacione</p> <p>Komenti i përgjithshëm Nr. 25 i ICCPR-së, para. 11 “Edukimi i votuesve dhe fushatat e regjistrimit janë të nevojshme për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave të nenit 25 nga një komunitet i informuar.”</p> <p>Komenti i përgjithshëm Nr. 25 i ICCPR-së, para. 12 “Duhet të përdoren metoda specifike, si fotografitë dhe simbolet, për të</p>

		Fletëvotimet e pavlefshme në zgjedhjet për kuvendet komunale arritën në gati 7 për qind. Të gjithë bashkëbiseduesit e EU EOM-së theksuan se aktivitetet e informimit të votuesve ishin të pamjaftueshme.				<i>siguruar që votuesit analfabetë të kenë informacionet e duhura mbi të cilat mund të bazojnë zgjedhjen e tyre.”</i>
REGJISTRIMI I VOTUESVE						
4.	Fq.14	Analiza nga EU EOM-ja e të dhënave për votuesit e moshuar konfirmon se ka pasur përparim në heqjen e personave të vdekur [nga lista]. Megjithatë, procesi i pastrimit [të listës] nuk ishte uniform, ku komunat më të mëdha duket se kanë qenë më efikase se sa ato më të voglat.	Të aplikohet një mekanizëm për heqjen automatike të personave të vdekur nga regjistri civil dhe nga baza e të dhënave të letërnjoftimeve të lëshuara pasi ARC të ketë marrë informatën nga spitalet dhe institucionet fetare.	Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 17/2015 për procedurat e përgjithshme të regjistrimit të faktit të lindjes, martesës dhe vdekjes	ARC	E drejta universale e votës E drejta dhe mundësia për të votuar <i>Neni 25 i ICCPR-së “zgjedhje të cilat do të jenë me votim të përgjithshëm dhe të barabartë”.</i> <i>Komisioni i Venedikut, Kodi i Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore, 2002, Seksioni I, neni. 1.2.ii “Duhet të ketë përditësim të rregullt (të listave të votuesve), të paktën një herë në vit.”</i>
5.	Fq.14	Sfidat për saktësinë e listës së votuesve kanë të bëjnë me mungesën e një sistemi unik të adresave në Kosovë, pasi ekstraktet e Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC) nuk përfshijnë kodet e rrugëve apo një sistemi standard që do të përdorej nga niveli komunal dhe qendror për emërtimin e rrugëve.	Të përshpejtohet zhvillimi i një sistemi unik të adresave për të caktuar më saktë votuesit në qendrat e votimit.	Asnjë ndryshim ligjor.	Agjencia Kadastrale	E drejta universale e votës E drejta dhe mundësia për të votuar <i>Neni 25 i ICCPR-së “zgjedhje të cilat do të jenë me të drejtë universale dhe të barabartë të votës”.</i>

6.	Fq.15	<p>Pas tërheqjes së vendimit të kontestuar të marrë gjatë zgjedhjeve të shkurtit 2021 për verifikimin përmes telefonit të të gjitha aplikacioneve jashtë Kosovës për regjistrim, KQZ-ja miratoi një vendim tjetër për të verifikuar në mënyrë të rastësishme vetëm dy për qind të të gjitha aplikacioneve.</p> <p>Gjithashtu, janë verifikuar edhe aplikacionet që kanë përdorur të njëjtin numër telefoni ose adresë të postës elektronike për aplikuesit me më shumë se dy mbiemra të ndryshëm, si dhe ato raste që Sekretariati i KQZ-së i ka konsideruar të dyshimta.</p>	<p>Të modernizohet metoda e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, për shembull, përmes një vegëze (link) në faqen e internetit të KQZ-së me masa të sigurisë, siç është verifikimi me dy hapa i aplikuesve në mënyrë që të sigurohet mbrojtja nga mashtrimi dhe nga paraqitja e personave në emër të dikujt tjetër.</p> <p>(rekomandim me prioritet)</p>	<p>Rregulla Zgjedhore e KQZ-së Nr.3/2013</p>	KQZ	<p>E drejta universale e votës Shteti duhet të ndër marrë hapat e nevojshëm për t'i dhënë efekt të drejtave</p> <p>ICCPR, neni 25 “<i>zgjedhje të cilat do të jenë me votim të përgjithshëm dhe të barabartë</i>”.</p> <p>ICCPR, neni 2.2 “<i>Aty ku nuk është parashikuar tashmë nga masat ekzistuese legjislative ose masa të tjera, çdo Shtet Palë e këtij Pakti merr përsipër të ndër marrë hapat e nevojshëm, në përputhje me proceset e tij kushtetuese dhe me dispozitat e këtij Pakti, për të miratuar ligje ose masa të tjera që mund të jetë e nevojshme për të zbatuar të drejtat e njohura në këtë Pakt.</i>”</p>
REGJISTRIMI I KANDIDATËVE DHE PARTIVE POLITIKE						
7.	Fq.16	<p>Siç parashikohet nga LZP-ja, KQZ-ja kërkoi verifikimin e evidencës penale të të gjithë kandidatëve nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), i cili menaxhon Sistemin Qendror të evidencave penale të Kosovës. Ky hap kyç procedural nxori në pah</p>	<p>Të sigurohet se ekziston një mekanizëm për transmetimin e saktë dhe me kohë të të dhënave nga KGJK-ja për t'i mundësuar KQZ-së të bëjë një verifikim efikas dhe të besueshëm të evidencës penale të kandidatëve.</p>	<p>Asnjë ndryshim ligjor.</p> <p>Zbatimi i nenit 29.1.(q) të LZP-së</p>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)	<p>E drejta dhe mundësia për të marrë pjesë në punët publike dhe për të mbajtur poste</p> <p>ICCPR, neni 25 “<i>Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: (a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërdrejt ose</i></p>

		disa mangësi, pasi në disa raste informacioni mbi evidencën penale mbërriti me vonesë ose nuk iu transmetua kurrë KQZ-së.				<i>nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;”</i>
8.	Pg.17	KQZ-ja në fund përjashtoi 176 kandidatë sipas LZP-së për shkak të dosjeve të tyre penale në tri vitet e fundit. Kjo dispozitë ligjore është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe në të kaluarën ka qenë burim i interpretimeve të ndryshme për shkak të dispozitave ligjore kontradiktore.	Të përcaktohet në ligjin për zgjedhjet se një kandidat e humb të drejtën për tu kandiduar vetëm nëse ka një dënim penal të formës së prerë për vepra të rënda penale dhe në bazë të një vendimi gjyqësor që shprehimisht i heq të drejtën për tu kandiduar.	Neni 29.1.(q), LZP	Kuvendi	<p>E drejta dhe mundësia për të marrë pjesë në punët publike dhe për të mbajtur pozita</p> <p>ICCP, Komenti i Përgjithshëm 25, neni 4 “Çdo kusht që zbatohet për ushtrimin e të drejtave të mbrojtura me nenin 25 duhet të bazohet në kritere objektive dhe të arsyeshme”;</p> <p>Praktika e mirë: Komisioni i Venedikut, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, 2002, Seksioni I.1.1.d “i. mund të miratohen dispozita për privimin e individëve nga e drejta e tyre për të votuar apo për t’u zgjedhur, por vetëm në rast se ekzistojnë të gjitha kushtet e mëposhtme: ii. duhet të parashikohet me ligj; iii. duhet të respektohet parimi i proporcionalitetit; kushtet për privimin e individëve nga e drejta për të kandiduar në zgjedhje mund të jenë më pak të rrepta se sa kushtet për privimin e tyre nga e drejta për të votuar [...]”</p>

AMBIENTI I FUSHATËS						
9.	Fq.19	Fushata e raundit të dytë filloi zyrtarisht më 8 nëntor dhe zgjati vetëm pesë ditë deri më 12 nëntor në mesnatë, në përputhje me vendimin përkatës të KQZ-së. Pasi as korniza ligjore nuk e parasheh ndonjë sanksion për fushatë jashtë kësaj periudhe dhe as KQZ-ja nuk ndërmori ndonjë masë, shumica e garuesve rifilluan aktivitetet e tyre të fushatës menjëherë pas raundit të parë, veçanërisht në mediat sociale, duke mos respektuar periudhën zyrtare 5-ditore të fushatës.	Të zhvillohen masa për të zbatuar kufizimet e periudhës zyrtare të fushatës për raundin e dytë të zgjedhjeve ose të lejohet që fushata të fillojë menjëherë pas raundit të parë.	Rregulla Zgjedhore e KQZ-së Nr. 13/2012 Shtimi i dispozitave ligjore në LZL.	KQZ Kuvendi	<p>Liria e tubimit, liria e mendimit dhe e shprehjes</p> <p>ICCPR, Komenti i përgjithshëm 25, para.25 “Për të garantuar gëzimin e plotë të të drejtave të mbrojtura me nenin 25, është thelbësor komunikimi i lirë i informacioneve dhe i ideve për çështje publike dhe politike në mes të qytetarëve, kandidatëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur.{..}. Ai kërkon ushtrimin dhe respektimin e plotë të të drejtave të garantuara në nenet 19, 21 dhe 22 të Paktit, duke përfshirë lirinë për tu përfshirë në aktivitete politike individualisht ose nëpërmjet partive politike dhe organizatave të tjera, lirinë për të debatuar për çështjet publike, për të mbajtur demonstrata dhe takime paqësore, për të kritikuar dhe kundërshtuar, për të publikuar materiale politike, për të bërë fushatë zgjedhore dhe për të reklamuar ide politike.”</p> <p>ICCPR, neni 19.2, “Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacione dhe ide të të gjitha llojeve.”</p>
FINANCIMI I FUSHATËS						

10.	Fq.22	<p>Në kundërshtim me praktikat e mira ndërkombëtare, afati i fundit për raportimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës është caktuar të jetë 45 ditë pas zgjedhjeve, kandidatët e propozuar nga partitë dhe palët e treta nuk i nënshtrohen kërkesës për raportim dhe pasqyrat financiare nuk publikohen në format lehtësisht të kërkueshëm. Të gjitha këto aspekte ulin transparencën, llogaridhënien dhe kufizojnë mundësinë e shqyrtimit publik.</p>	<p>Ligji të parasheh raportimin e përkohshëm të të ardhurave dhe shpenzimeve të garuesve gjatë periudhës së fushatës, si dhe raportimin përfundimtar brenda 30 ditësh nga dita e zgjedhjeve. Raportimi duhet të përfshijë financat e kandidatëve të emëruar nga partitë dhe të subjekteve që bëjnë fushatë për garuesit (palët e treta). Ligji të përcaktojë një afat të shkurtër për autoritetet mbikëqyrëse dhe subjektet politike që të publikojnë të gjitha raportet financiare në një mënyrë lehtësisht të kërkueshme.</p>	LZP Ligji për Financimin e Partive Politike	Kuvendi	<p>Transparenca dhe qasja në informacione</p> <p>Praktika e mirë Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (2003)4, Neni 11 “<i>Shtetet duhet të kërkojnë nga partitë politike dhe subjektet e lidhura me partitë politike të cekura në nenin 6 [subjektet e lidhura me partitë politike] të mbajnë libra dhe llogari të rregullta.</i>”</p> <p>Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (2003)4, Neni 13 “<i>Shtetet duhet të kërkojnë nga partitë politike që t’ia paraqesin llogaritë [...]rregullisht, dhe të paktën çdo vit, autoritetit të pavarur [...]. Shtetet duhet të kërkojnë nga partitë politike që rregullisht, dhe të paktën çdo vit, të bëjnë publike llogaritë [...] ose së paku një përmbledhje të atyre llogarive.</i>”</p> <p>Komisioni i Venedikut, Udhëzime për Partitë Politike, Para. 200 “<i>...raportet e financimit të fushatës duhet të dorëzohen pranë autoriteteve përkatëse brenda një periudhe prej jo më shumë se 30 ditësh pas zgjedhjeve. Raportet e tilla duhet të kërkojnë jo vetëm për partinë si tërësi por edhe për kandidatët individualë dhe listat e kandidatëve.</i></p>
-----	-------	--	---	--	---------	--

11.	Fq.23	<p>Nga Kuvendi i Kosovës kërkohet që në baza vjetore të organizojë auditime financiare të të gjitha subjekteve politike. Në praktikë, auditimeve u mungon financimi i mjaftueshëm, kryhen me vonesë disavjeçare dhe vetëm për partitë parlamentare, duke penguar çdo verifikim domethënës të financave të partive dhe zbatimin me kohë të sanksioneve. Mungesa e auditimit të rregullt dhe zbatimi selektiv i ndëshkimeve nga KQZ-ja rezultoi në mbikëqyrje <i>pro-forma</i> të financave të fushatës dhe nuk ofroi stimulim për garuesit që të respektojnë rregullat. Bashkëbiseduesit informuan EU EOM-në se burime të shumta të të ardhurave dhe shpenzimeve mbeten të paraportuara.</p>	<p>Të sigurohet një mekanizëm i pavarur për mbikëqyrjen efektive të financave të partive dhe fushatës, të cilit i jepet mandati, autoriteti, si dhe burimet financiare dhe njerëzore për të monitoruar dhe hetuar në mënyrë efektive dhe proaktive parregullsitë e pretenduara në financimin e partive dhe fushatës, përfshirë edhe të ardhurat dhe shpenzimet e paraportuara dhe shqiptimin e ndëshkimeve.</p> <p>(rekomandim me prioritet)</p>	<p>LZP</p> <p>Ligji për Financimin e Partive Politike</p>	<p>Kuvendi</p>	<p>Parandalimi i korrupsionit/drejtësia në fushatën zgjedhore</p> <p>Konventa e OKB kundër Korrupsionit (UNCAC), Neni 6.2 “Çdo Shtet Palë do t’i garantojë organit ose organeve [...]pavarësinë e nevojshme [...] për t’i mundësuar organit ose organeve të kryejnë funksionet e tij ose të tyre në mënyrë efektive dhe të lirë nga çdo ndikim i papërshtatshëm. Duhet të sigurohen burimet e nevojshme materiale dhe personeli i specializuar, si dhe trajnimi që ky personel mund të kërkojë për të ushtruar funksionet e tij.”</p> <p>Praktika e mirë</p> <p>Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) Rekomandimi 1516 për Financimin e Partive Politike, neni. 8.d “Shtetet duhet të krijojnë organe të pavarura të auditimit të pajisura me kompetenca të mjaftueshme për të mbikëqyr llogaritë e partive politike dhe shpenzimet që lidhen me fushatat zgjedhore.”</p> <p>Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (2003) 4, Neni 15 “Shtetet duhet të promovojnë specializimin e gjyqësorit, policisë ose personelit tjetër në luftën kundër financimit të paligjshëm të partive politike dhe fushatave zgjedhore.”</p>
-----	-------	---	--	---	----------------	--

						Neni 16 “Shtetet duhet të kërkojnë që shkëlja e rregullave lidhur me financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore t’i nënshtrohet sanksioneve efektive, proporcionale dhe parandaluese.”
MEDIAT						
12.	Fq.24	Televizioni publik RTK nuk është plotësisht i pavarur pasi financohet kryesisht nga buxheti i shtetit dhe pa rregulla të qarta se si i përcaktohet buxheti vjetor, duke e bërë atë të pambrojtur ndaj ndikimeve politike.	Të forcohet pavarësia e transmetuesit publik nga ndërhyrjet e mundshme politike, duke rishikuar sistemin e financimit të tij.	Ligji për RTK-në	Kuvendi	Liria e mendimit dhe e shprehjes ICCPR, neni 19, Komenti i përgjithshëm 34, para. 16 “Shtetet palë duhet të sigurojnë që shërbimet e transmetimit publik të funksionojnë në mënyrë të pavarur. Veprimet për të garantuar pavarësinë mund të përfshijnë përcaktimin e mandatit të këtyre transmetuesve në ligj dhe sigurimin e garancive legislative të pavarësisë dhe lirisë redaktuese, si dhe sigurimin e

						<i>financimit në një mënyrë që nuk cenon pavarësinë.”</i>
13.	Fq.25	Në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) nuk zhvilloi një kornizë rregullative për të siguruar pluralitetin e mediave dhe për të parandaluar përqendrimin në tregun mediatik. Për më tepër, KPM-ja jep informacione të kufizuara ose nuk jep fare informacione publike mbi pronësinë e transmetuesve të licencuar.	Të fillohet zbatimi i dispozitave rregullative specifike që synojnë sigurimin e pluralitetit mediatik dhe transparencën mbi pronësinë e mediave.	Ligji për Komisionin e Pavarur për Media. Rregulloret e Komisionit të Pavarur për Media	Kuvendi KPM	<p>Liria e mendimit dhe e shprehjes</p> <p>ICCPR, neni 19, Komenti i Përgjithshëm 34, para. 40 <i>“Shtetet palë duhet të ndërmarrin veprimet e duhura, në përputhje me Paktin, për të parandaluar dominimin e mediave ose përqendrimin e panevojshëm nga grupet e mediave të kontrolluara privatisht në situata monopoliste që mund të jenë të dëmshme për një diversitet burimesh dhe pikëpamjesh.</i></p> <p>Praktika e mirë</p> <p>Deklarata e përbashkët për mediat dhe zgjedhjet nga OKB, OSBE, OAS dhe ACHPR, Mjedisi i përgjithshëm për mediat dhe zgjedhjet I) <i>“Shtetet duhet të vendosin një sërë masash, duke përfshirë [...] detyrimet e transparencës mbi pronësinë e mediave, licencimin e llojeve të ndryshme të transmetuesve për të promovuar diversitetin, rregullat për të parandaluar përqendrimin e padrejtë të pronësisë së mediave...”</i></p>

14.	Fq.27	<p>Gjatë periudhës së vëzhguar zgjedhore, KPM-ja kishte vetëm katër nga shtatë anëtarë e saj, gjë që ndikoi në kapacitetin e organit rregullator për të arritur kuorumin prej katër anëtarësh për të marrë vendime. Për më tepër, Bordi i Ankesave të KPM-së nuk ishte funksional pasi mandati i njërit prej tre anëtarëve të tij kishte skaduar, duke zgjatur në mënyrë drastike çdo proces ankimor dhe duke dëmtuar të drejtën për të kërkuar mjete juridike efektive. Emërimi i vonuar i anëtarëve të KPM-së dhe anëtarëve të Bordit të Ankesave të KPM-së nga Kuvendi i Kosovës rrezikon aktivitetin e këtij organi rregullator.</p>	<p>Të emërohen me kohë të gjithë anëtarët e KPM-së dhe të Bordit të Ankesave të KPM-së përmes një procesi përzgjedhës konkurrues dhe transparent për të nxitur pavarësinë, mbikëqyrjen dhe fuqinë sanksionuese të organit rregullator.</p> <p>(rekomandim me prioritet)</p>	Asnjë ndryshim ligjor	Kuvendi	<p>Praktika e mirë</p> <p>Deklarata e përbashkët për mediat dhe zgjedhjet nga OKB, OSBE, OAS dhe ACHPR, Mjedisi i përgjithshëm për mediat dhe zgjedhjet VIII, <i>“Mbikëqyrja e çdo rregulle në lidhje me mediat dhe zgjedhjet duhet t’i besohet një organi të pavarur administrativ, i cili duhet të adresojë çdo ankesë menjëherë. Vendimet e këtij organi duhet t’i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor.”</i></p>
KOMUNIKIMI DIGJITAL DHE MEDIAT SOCIALE						
15.	Fq.30	<p>Legjislacioni zgjedhor ka mbetur kryesisht i pandryshuar për më shumë se një dekadë dhe nuk pasqyron në mënyrë eksplicite rritjen e rëndësisë së komunikimit digjital në zgjedhje. Nuk ekziston asnjë dispozitë për zhvillimin e fushatës</p>	<p>Të përfshihen dispozita për reklamën zgjedhore në platformat online dhe rregullat ekzistuese të fushatës të zgjerohen në mënyrë specifike për të mbuluar edhe sferën digjitale.</p>	LZP Rregullat Zgjedhore të KQZ-së	Kuvendi KQZ	<p>Transparenca dhe qasja në informacione</p> <p>UNCAC, neni 7.3: <i>“Çdo Shtet Palë duhet po ashtu të marrë parasysh marrjen e masave të duhura legislative dhe administrative, ... për të rritur transparencën në financimin e kandidaturave për pozita publike</i></p>

		online dhe shpërndarja e reklamave zgjedhore në platformat online mbetet e parregulluar.	(rekomandim me prioritet)			<i>të zgjedhura dhe, kur është e aplikueshme, në financimin e partive politike.”</i>
16.	Fq.33	Megjithëse reklammat me pagesë në internet dukej se përdorshin gjerësisht, mungesa e rregullave të transparencës e pamundësoi llogaridhënien. Miratimi i arkivave të reklamimit në mediat sociale do të mundësonte një shkallë të kontrollit të përmbajtjes me pagesë, në përputhje me standardet ndërkombëtare për transparencë dhe qasje në informacion.	Të nxitet bashkëpunimi ndërmjet administratës së zgjedhjeve dhe ofruesve kryesorë digjitalë për të inkurajuar miratimin e arkivave të detyrueshme për reklammat zgjedhore në internet me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies për shpenzimet e fushatës. Mund të aplikohet një rregullore për subjektet politike dhe kandidatët që synojnë të zhvillojnë fushatë në platformat online për t'u regjistruar si reklamues politikë.	Rregullat Zgjedhore të KQZ-së	KQZ	<p>Transparenca dhe qasje në informacione</p> <p>UNCAC, neni 7.4: “Secili Shtet Palë, në përputhje me parimet themelore të ligjit të brendshëm, përpiket të miratojë, mirëmbajë dhe forcojë sisteme që nxisin transparencën dhe parandalojnë konfliktin e interesit.”</p> <p>UNCAC, neni 13(b) “Secili Shtet Palë do të sigurojë që publiku të ketë qasje efektiv në informacione.”</p> <p>Deklarata e përbashkët për lirinë e shprehjes dhe zgjedhjet në epokën digjitale nga UNHRC, OSBE dhe OAS, “<i>Qasje në informacione lidhur me zgjedhjet: ii) Partive dhe kandidatëve duhet t’u kërkohet që të jenë transparente në kohën e duhur, përfshirë ndaj mediave, lidhur me shpenzimet e tyre për zgjedhje dhe, në veçanti, shpenzimet në mediat tradicionale dhe digjitale dhe për përpjekje të tjera të komunikimit digjital.</i>”</p>

17.	Fq.34	<p>Përkundër propozimit të numrit të kërkuar të grave kandidate, partitë politike, të cilat janë kryesisht të dominuara nga meshkujt, ende nuk e kanë trajtuar seriozisht çështjen e pabarazisë gjinore në programet dhe statutet e tyre dhe janë larg përmbushjes së detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji për Barazi Gjinore.</p>	<p>Partitë politike të konsiderojnë miratimin e politikave të brendshme që promovojnë pjesëmarrjen e grave dhe të integrojnë çështjet gjinore në platformat partiake.</p>	Asnjë ndryshim ligjor	Kuvendi KQZ	<p>Pjesëmarrja e grave në çështjet publike, Sundimi i ligjit</p> <p>ICCPR, neni 3. <i>“Shtetet Palë të këtij Pakti marrin përsipër të garantojnë të drejtën e barabartë të burrave dhe grave për të gëzuar të gjitha të drejtat civile dhe politike të përcaktuara në këtë Pakt.”</i></p> <p>Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW), neni 4, paragrafi 1 <i>“Ndërmarrja nga Shtetet Palë e masave të veçanta të përkohshme që synojnë përshpejtimin faktik të barazisë midis burrave dhe grave nuk do të konsiderohet diskriminim.</i></p> <p>Rekomandimi i përgjithshëm Nr. 23 i CEDAW-së, para. 22 <i>“Sistemi i votimit, shpërndarja e ulëseve në Parlament, zgjedhja e zonës zgjedhore, të gjitha kanë ndikim të rëndësishëm në përqindjen e grave të zgjedhura në Parlament. Partitë politike duhet të përqafojnë parimet e mundësive të barabarta dhe demokracisë dhe të përpiqen të balancojnë numrin e kandidatëve meshkuj dhe femra.”</i></p>
PJESËMARRJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA						

18.	Fq.37	<p>Edhe pse Kosova nuk është nënshkruese e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK), ajo e ka miratuar përkufizimin e KDPAK-së për aftësinë e kufizuar në Planin e saj Kombëtar të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar, i cili synon të harmonizojë legjislacionin e Kosovës me KDPAK dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare.</p>	<p>Të miratohet dhe transpozohet KDPAK e OKB-së në Kushtetutë, në mënyrë që të zbatohen të drejtat e garantuara në të.</p>	<p>Kushtetuta e Kosovës</p>	<p>Kuvendi KQZ</p>	<p>E drejta dhe mundësia për të votuar</p> <p>ICCPR, neni 25: <i>"Çdo qytetar ka të drejtën dhe mundësinë, pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: b) Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të votuesve"</i>.</p> <p>KDPAK, neni 29: <i>"Shtetet Palë duhet tu garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato në mënyrë të barabartë si të tjerët."</i></p> <p>KDPAK, neni 9: <i>"Për të mundësuar që personat me aftësi të kufizuara të jetojnë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara, ashtu si të gjithë të tjerët, të kenë qasje në ambientet fizike, në transport, në informacion dhe komunikim, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në objekte dhe shërbime të tjera të hapura ose të ofruara për publikun, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale."</i></p>
-----	-------	--	--	-----------------------------	------------------------	--

KONTESTET ZGJEDHORE						
19.	Fq.38	Parashtresat dhe ankesat mund të paraqiten brenda një afati prej 24-orësh në PZAP, i cili i ka 72 orë për të marrë vendim. Ankesa ndaj vendimit të PZAP me tej mund të parashtrahet brenda 24 orësh në Gjykatën Supreme, shkalla përfundimtare, e cila ka 72 orë për të vendosur. Këto afate u vlerësuan nga të gjithë bashkëbiseduesit e EU EOM-së si jashtëzakonisht të shkurtra, si për palët për të mbledhur prova të forta ashtu edhe për organet e ankesave për t'i vlerësuar dhe shqyrtuar ato në mënyrë gjithëpërfshirëse.	Të zgjaten afatet për paraqitjen e parashtresave apo ankesave zgjedhore, dhe për PZAP-në dhe GJS-në për t'i gjykuar ato, në tri deri në pesë ditë (si për paraqitjen e parashtresave dhe ankesave ashtu edhe për gjykimin e tyre).	LZP neni 105; neni 118.2.4; neni 119.1; neni 122.1 Rregullorja e punës e PZAP-së 02/2015 neni 5, neni 10.5	Kuvendi	E drejta në mjet juridik efektiv, sundimi i ligjit ICCPR, neni 2.3 “(a) <i>Të sigurojë që çdo person, kur t'i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Pakt, të ketë të drejtën e një mjeti juridik efektiv {...}.</i> ” Praktika e mirë Komisioni i Venedikut, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, 2002, para. 95 “ <i>Përveç kësaj, vendimet për rezultatet e zgjedhjeve nuk duhet të vonohen, veçanërisht kur klima politike është e tendosur. {...}Megjithatë, afatet kohore duhet të zgjasin aq sa për të garantuar ushtrimin e të drejtës së ankesës si dhe për marrjen e një vendimi të peshuar mirë. Një afat kohor prej tre deri në pesë ditësh në shkallën e parë (përfshirë për paraqitjen e ankesës dhe marrjen e vendimit) duket se është i arsyeshëm që vendimet të merren para zgjedhjeve. Megjithatë, është e lejueshme që t'u jepet pak më shumë kohë Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese për të marrë vendimet e tyre.</i> ”
20.	Fq.38	Ligji nuk parasheh ankesa ndaj rezultateve përfundimtare, por vetëm ankesa lidhur me votimin dhe numërimin në qendrat e votimit dhe për procesin e tabelimit në QNR. Këto duhet të	Të përfshihen dispozita për kontestimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të publikuara nga KQZ-ja. Të sqarohen paqartësitë lidhur me ankesat që	LZP neni 105.1; neni 106; neni 119.1, neni 112.1 Rregullorja e procedurës PZAP	Kuvendi PZAP	E drejta në mjet juridik efektiv, sundimi i ligjit ICCPR, neni 2.3 (a) “ <i>Të sigurojë që çdo person, kur t'i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Pakt, të ketë të drejtën e një mjeti juridik efektiv {...}.</i> ”


		<p>dorëzohen brenda një afati prej 24-orësh në PZAP, i cili më pas ka 72 orë për të vendosur. Megjithatë, kjo krijon vështirësi për PZAP-në, i cili duhet të vlerësojë ndikimin e shkeljeve të pretenduara në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve para se rezultatet të publikohen nga KQZ-ja. Në praktikë, PZAP-ja i refuzon ankesat e tilla si të papranueshme ose të parakohshme, por ua mundëson ankuesve që t'i paraqesin ato sërish pasi KQZ-ja të shpallë rezultatet përfundimtare.</p>	<p>kanë të bëjnë me votimin, numërimin, procesin në QNR dhe afatet e tyre përkatëse.</p> <p>(rekomandim me prioritet)</p>	<p>02/2015 neni 5, neni 10</p>		<p>ICCPR, KP 25 para. 20 <i>“Duhet të ekzistojë një kontroll i pavarur i procesit të votimit dhe numërimit dhe qasje në shqyrtim gjyqësor ose ndonjë proces tjetër të ngjashëm, në mënyrë që votuesit të kenë besim në sigurinë e fletëvotimit dhe në numërimin e votave”</i></p> <p>Praktika e mirë Komisioni i Venedikut, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, 2002, para. 97 <i>“Është gjithashtu shumë e rëndësishme që procedura e ankesës, veçanërisht kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të ndryshme që përfshihen në të, të jenë të rregulluara qartë me ligj në mënyrë që të shmangen konfliktet pozitive apo negative të juridiksionit.”</i></p>
VOTIMI, NUMËRIMI DHE TABELIMI						
21.	Fq.41	<p>Vështirësi në plotësimin e formularëve të rezultateve për kryetar të komunës dhe për kuvend janë vërejtur në 16 vendvotime dhe për formularët e rezultateve të kandidatëve për kuvend në 12 nga 31 vendvotimet e vëzhguara.</p>	<p>Të intensifikohet trajnimi i stafit zgjedhor për të adresuar mangësitë e vazhdueshme si mosrespektimi i konsekuent të procedurave të numërimit të votave dhe plotësimi i gabuar i</p>	<p>Asnjë ndryshim ligjor. Përmirësimi i kurrikulës së trajnimit, i materialeve dhe provimeve</p>	KQZ	<p>Zgjedhje të mirëfillta që pasqyrojnë shprehjen e lirë të vullnetit të votuesve ICCPR, Komenti i përgjithshëm Nr. 25, para. 20 <i>“Duhet të krijohet një autoritet i pavarur zgjedhor për të mbikëqyr procesin zgjedhor dhe për të siguruar që ai të zhvillohet në mënyrë të drejtë, të</i></p>

		Në përgjithësi, gabime apo lëshime të konsiderueshme procedurale janë vërejtur në shtatë nga 31 vendvotimet e vëzhguara.	formularëve të rezultateve.			<i>paanshme dhe në përputhje me ligjet e përcaktuara.”</i>
22.	Fq.42	Votimi me asistencë u regjistrua në librat e votimit në 70 për qind të vendvotimeve të vizituara. Mosnjohja e procedurave të votimit, mosha e shtyrë, shikimi i dobët dhe analfabetizmi përbënin shumicën dërrmuese të arsyeve të paraqitura për votim me asistencë.	Votimi me asistencë në vendvotime të rregullohet në mënyrë më të rreptë, për shembull duke kërkuar që personi që ndihmon një votues të jetë i regjistruar në të njëjtin vendvotim.	LZP Rregulla Zgjedhore e KQZ-së Nr.9/2013	Kuvendi KQZ	Zgjedhje të mirëfillta që pasqyrojnë shprehjen e lirë të vullnetit të votuesve ICCPR, Komenti i Përgjithshëm 25, para.11: “Çdo ndërhyrje abuzive në regjistrim ose votim, si dhe frikësimi ose shtrëngimi i votuesve duhet të ndalohet me ligjet penale dhe ato ligje duhet të zbatohen rreptësisht.” dhe para.19: “Personat me të drejtë vote duhet të jenë të lirë të votojnë për çdo kandidat në zgjedhje dhe për ose kundër çdo propozimi të paraqitur në referendum ose plebishit, dhe duhet të jenë të lirë të mbështesin ose të kundërshtojnë qeverinë, pa ndikim të panevojshëm ose detyrim të çfarëdo lloji që mund të shtrembërojë ose pengojë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësit. Votuesit duhet të jenë në gjendje të formojnë opinione në mënyrë të pavarur, pa dhunë ose kërcënim të dhunës, detyrim, nxitje ose ndërhyrje manipulative të çfarëdo lloji
23.	Pg.44	Numri i fletëvotimeve të pavlefshme në raundin e parë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, sipas llogaritjeve të EU	Të ridizajnohen fletëvotimet e zgjedhjeve për kuvende komunale për tu kuptuar më mirë nga	Asnjë ndryshim ligjor.	KQZ	E drejta dhe mundësia për të votuar Transparenca dhe qasja në informacione


		<p>EOM-së bazuar në të dhënat e ndara sipas komunave të publikuara nga KQZ-ja, ishte 1.6 për qind dhe numri i fletëvotimeve të zbrazëta afër 1 për qind. Nga ana tjetër, numri i fletëvotimeve të pavlefshme për zgjedhjet për kuvende komunale arriti në gati 7 për qind, duke treguar se ka pasur aktivitete të pamjaftueshme për informimin e votuesve dhe një dizajn tepër të ndërlikuar të fletëvotimeve, dhe numri i fletëvotimeve të zbrazëta arriti në 1.6 për qind.</p>	<p>votuesit dhe të shtohen informacionet për votuesit se si të shënojnë si duhet fletëvotimin në mënyrë që të zvogëlohet numri i votave të pavlefshme.</p> <p>(rekomandim me prioritet)</p>			<p>ICCPR, Komenti i përgjithshëm Nr. 25, para. 11 <i>“Fushatat për edukimin dhe regjistrimin e votuesve janë të nevojshme për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave sipas nenit 25 nga një komunitet i informuar.”</i></p> <p>ICCPR, Komenti i përgjithshëm Nr. 25, para. 12 <i>“Informacionet dhe materialet rreth votimit duhet të jenë të disponueshme në gjuhët e pakicave. Duhet të përdoren metoda specifike, si fotografitë dhe simbolet, për të siguruar që votuesit analfabetë të kenë informacionet e duhura mbi të cilat mund të bazojnë zgjedhjen e tyre.”</i></p>
--	--	--	---	--	--	---

ANEKSI I. REZULTATET E ZGJEDHJEVE

Rezultatet e zgjedhjeve për kryetarë të komunave për subjektet politike dhe për komunat¹⁶⁸:



Rezultatet e zgjedhjeve për kuvendet komunale për subjektin politik që ka fituar më së shumti ulëse për komunë:



¹⁶⁸ Ngjyra e bardhë në hartë paraqet komunën e Dragashit ku rezultatet e zgjedhjeve do të përcaktohet pas datës 13 dhjetor 2021 nga votuesit jashtë Kosovës.

Nr.	Emri i partisë	Numri i kryetarëve të zgjedhur	Numri i anëtarëve të zgjedhur në kuvende
1	(LS) Lista Serbe	10	147
2	(PDK) Partia Demokratike e Kosovës	8	206
3	(LDK) Lidhja Demokratike e Kosovës	7	206
4	(AAK) Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	5	120
5	(LVV) Lëvizja Vetëvendosje	4	193
6	(NISMA) Nisma Socialdemokrate	1	21
7	(IQO) Iniciativa Qytetare Obiliq	1	9
8	(KDTP) Partia Demokratike Turke e Kosovës	1	11
9	Lista e Pavarur Bekim Jashari	0	10
10	(DD) Demokratët për Drenasin	0	8
11	(AKR) Aleanca Kosova e Re	0	8
12	(KTAP) Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës	0	6
13	(PSD) Partia Social Demokrate	0	5
14	(PSHDK) Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës	0	4
15	(VAKAT) Koalicioni Vakati	0	4
16	(LB) Lëvizja e Unitetit	0	4
17	(GI NS) Nisma Qytetare Harmonia Kombëtare	0	3
18	(IQGD) Iniciativa Qytetare GREEN për Drenas	0	2
19	(JGP) Partia Unike Gorane	0	2
20	(IFKEA) Iniciativa për Fushë Kosovë - Egjiptian dhe Ashkali	0	2
21	(PD) Partia e Drejtësisë	0	2
22	(BPSH) Bashkë për Shtërpcën	0	2
23	(RDF) Reforma Demokratike për Ferizajin	0	2
24	(NS) Harmonia Kombëtare	0	2
25	(NJ) Uniteti Kombëtar	0	2
26	(IQM) Iniciativa Qytetare Mitrovicë	0	2
27	(LQV) Lëvizja Qytetare Vatra	0	1
28	(GIBI) Iniciativa Qytetare Boshnjakët për Istogun	0	1
29	(LN) Lista Ndryshe	0	1
30	(FED) Forca e Diasporës	0	1
31	(PAI) Partia e Ashkalive për Integrim	0	1
32	(BI-PEC) Iniciativa Boshnjake - Pejë	0	1
33	(IBJ) Iniciativa për Unitetin Boshnjak	0	1
34	(OBKD) Organizata e Ballit Kombëtar Demokratik	0	1
35	(NDS) Partia e Re Demokratike	0	1
36	(SDU) Bashkimi Social Demokrat	0	1
37	(YTHP) Partia e Lëvizjes Inovative Turke	0	1
38	(GISS) Iniciativa Qytetare Liri për Shtërpcën	0	1
39	Iniciativa e Therandës	0	1
40	Ne Mundemi	0	1
41	(LA) – Lista e Ashkalive	0	1
42	(GIZP) Iniciativa Qytetare Zubin Potok	0	1
43	(ASH) Aleanca Shqiptare	0	1
44	(IQM) Iniciativa Qytetare për Mogillën	0	1
45	(IQK) Iniciativa Qytetare për Kllokotin	0	1

ANEKSI II. REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE

Zgjedhjet Komunale në Kosovë 2021

Hyrje

Monitorimi i mediave të transmetuara

Janë monitoruar tetë kanale televizive: **RTK1**, kanal televiziv publik (në gjuhën shqipe), **RTK2**, kanal televiziv publik (në gjuhën serbe dhe në gjuhët joshumicë), **KLAN KOSOVA**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe), **TV DUAKGJINI**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe), **T7**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe), **KANAL 10**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe). Përveç këtyre, në monitorimin e mediave u përfshinë edhe programet e lajmeve kryesore ditore të dy kanaleve televizive lokale që transmetojnë në gjuhën serbe, **TV MOST** dhe **TV PULS**.

Monitorimi i raundit të parë të zgjedhjeve: 16 shtator – 17 tetor 2021 çdo ditë nga ora 18:00 deri në 24:00 dhe tërë ditën gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore. Emisionet e lajmeve kryesore të TV MOST dhe TV PULS janë monitoruar çdo ditë.

Monitorimi i raundit të dytë të zgjedhjeve: 18 tetor – 14 nëntor 2021 çdo ditë nga ora 17:00 deri në 24:00 dhe tërë ditën gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore. Kanalet televizive në gjuhën serbe (RTK2, TV Most dhe TV Puls) nuk u monitoruan pas raundit të parë pasi në 9 nga 10 komunat me shumicë serbe nuk kishte raund të dytë të zgjedhjeve.

Metodologjia e përdorur për monitorimin e mediave transmetuese ishte sasiore dhe cilësore. Komponenti sasior i monitorimit konsistonte në analizën e kohës së caktuar për akterët përkatës politikë. Analiza cilësore përfshinte mënyrën se si u portretizuan akterët përkatës, përkatësisht tonin e përdorur nga media ndaj garuesve dhe akterëve politikë (negativ, neutral ose pozitiv). Gjatë periudhës së monitoruar, toni i përdorur nga mediat transmetuese për t'i mbuluar garuesit ishte neutral ose pothuajse plotësisht neutral. Prandaj, nuk i kemi përfshirë diagramet që tregojnë tonin e mbulimit.


Monitorimi i faqeve të lajmeve në internet

Janë monitoruar tetë faqe të lajmeve në internet: **RTK Live** – faqja e internetit e transmetuesit publik, **Koha** – në gjuhën shqipe, **Telegrafi** - në gjuhën shqipe, **GazetaExpress** - në gjuhën shqipe, **Indeksonline** - në gjuhën shqipe, **Insajderi** - në gjuhën shqipe, **KoSsev** dhe **Kosovo online** – në gjuhën serbe.

Shumica e faqeve të lajmeve në internet krijuan një seksion ad hoc, “Zgjedhjet”, ku publikuan artikujt e tyre të lajmeve që lidheshin me zgjedhjet, megjithëse numri i artikujve të botuar ishte i kufizuar. Kjo i mundësoi EU EOM-së t’i monitorojë të gjithë artikujt lidhur me zgjedhjet të publikuar nga këto faqe të lajmeve në internet. Përderisa mediat online nuk janë të detyruara të respektojnë ndonjë kërkesë ligjore për të qenë të balancuar, qëllimi i monitorimit ishte të vlerësohej nëse ato ishin të njëanshme në pasqyrimin e tyre, nëse përhapnin gjuhë të urrejtjes dhe nëse respektonin disa dispozita të Kodit të Mediave të Shkruara, një kod i sjelljes i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, një organ vetërregullues. Të gjitha faqet e lajmeve në internet të monitoruara, përveç faqes së internetit të transmetuesit publik, ishin nënshkruar të Kodit të Mediave të Shkruara. RTK Live nuk kishte seksion ad hoc për zgjedhjet. Prandaj, EU EOM-ja monitoroi të gjithë artikujt që mbulonin subjektet politike të publikuara në faqen e saj kryesore. Gjatë secilës periudhë para raundit të parë dhe të dytë të zgjedhjeve *Telegrafi*, *KoSsev* dhe *Kosova Online* publikuan më pak se 40 artikuj lajmesh që mbulonin fushatën e subjekteve politike. E

njëjta gjë vlen edhe për *Koha* dhe *GazetaExpress* para raundit të dytë. Duke pasur parasysh mbulimin e tyre shumë të kufizuar të fushatës, nuk ishte e mundur të përcaktohej se në çfarë shkalle ishin apo nuk ishin të balancuara, prandaj rezultatet për këto faqe të lajmeve nuk janë përfshirë në grafik.

MBULUESHMËRIA POLITIKE DHE ZGJEDHORE
FUSHATA ZGJEDHORE RAUNDI I PARË (16 shtator – 15 tetor 2021)




	RTK1	RTK2	KLAN KOSOVA	TV DUKAGJINI	KANAL 10	T7
LAJME	14%	42%	7%	9%	6%	3%
DEBATE ZGJEDHORE	73%	5%	47%	53%	48%	16%
BISEDA/AKTUALITETE	7%	9%	28%	28%	28%	62%
REKLAMA POLITIKE ME PAGESË	1%	-	-	3%	2%	2%
PROGRAMI SPONSORIZUAR/ ME PAGESË	1%	-	16%	4%	15%	16%
SPOTET E TRANSMETUARA PA PAGESË	2%	11%	1%	-	-	-
INFORMIMI I VOTUESVE	2%	33%	1%	1%	-	1%
TË TJERA	-	-	-	2%	1%	-

	Gjithsej mbulueshmëri politike dhe zgjedhore
RTK1	97 orë 13 minuta e 21 sekonda


RTK2	18 orë 28 minuta 9 sekonda
Klan Kosova	72 orë 21 minuta dhe 16 sekonda
TV DUKAGJINI	67 orë 48 minuta 24 sekonda
KANAL 10	97 orë 18 minuta 53 sekonda
T7	74 orë 53 minuta 26 sekonda

RTK1 - KANALI TELEVIZIV PUBLIK




169

¹⁶⁹ Mbulimi total i lajmeve në raundin e parë: 18 orë 10 min 17 sek - Mbulimi total i lajmeve në raundin e dytë: 3 orë 35 min 5 sek




MBULIMI NGA KANALET TELEVIZIVE PRIVATE – Raundi i parë




¹⁷⁰ Koha e përgjithshme për programe të debateve/analizave: 6 orë 41 min 2 sek. Para raundit të dytë, RTK1 pothuajse nuk kishte emisione debatuese, pasi ato zakonisht organizoheshin për të komentuar debatet zgjedhore të mbajtura në të njëjtën mbrëmje, por para raundit të dytë u zhvilluan vetëm dy debate zgjedhore.

¹⁷¹ Mbulimi i përgjithshëm i lajmeve të raundit të parë nga kanali televiziv - Klan Kosova: 4 orë 32 min 26 sek; T7: 2 orë 7 min 50 sek; TV Dukagjini 6 orë 8 min 7 sek; Kanali 10: 5 orë 53 min 6 sek.



172

MBULIMI REDAKTUES NGA KANALET TELEVIZIVE PRIVATE – Raundi i Dytë




173


¹⁷² Mbulimi i përgjithshëm politik dhe zgjedhor në emisionet e kanaleve televizive – Klan Kosova: 2 orë 13 min 14 sek; T7: 46 orë 39 min 55 sek; TV Dukagjini 18 orë 24 min 27 sek; Kanali 10: 26 orë 57 min 32 sek. Duhet të merret parasysh se, siç raportohet, përfaqësuesit e LVV-së përgjithësisht janë përbajtur nga pjesëmarrja në emisionet politike të kanalit T7, siç kanë bërë përfaqësuesit e PDK-së me TV Dukagjinin, duke pretenduar se këto kanale televizive ishin të njëanshme ndaj tyre.

¹⁷³ Mbulimi redaktues përfshin lajme, intervista me kandidatë dhe debate politike. Përveç vijës redaktuese të çdo transmetuesi, mbulimi i kanaleve televizive para raundit të dytë u ndikua edhe nga elementë të tjerë, si partitë politike që kishin një numër të ndryshëm kandidatësh në raundin e dytë, kanalet televizive që fokusoheshin në komunitat më të rëndësishme apo

PËRMBAJTJA POLITIKE ME PAGESË



KANALET TELEVIZIVE NË GJUHËN SERBE – MBULIMI I LAJMEVE




ku gara ishte më e ngushtë. Mbulimi i përgjithshëm redaktues nga kanalet televizive – Klan Kosova: 18 orë 30 min 9 sek; T7: 31 orë 56 min 55 sek; TV Dukagjini: 29 orë 44 min 22 sek; Kanali 10: 28 orë 11 min 13 sek.

¹⁷⁴ Gjatë fushatës 30-ditore të raundit të parë, PDK bleu 78 për qind të përmbajtjeve politike me pagesë në kanalet televizive të monitoruara, e pasuar nga LDK me 18 për qind. Gjatë fushatës pesëditore për raundin e dytë, PDK sërish bleu pjesën më të madhe të përmbajtjeve politike me pagesë, 68 për qind, e pasuar nga AAK me 21 për qind dhe LVV me 15 për qind. Pjesa më e madhe e përmbajtjeve politike me pagesë gjatë të dy raundeve përbëhej nga programe politike me pagesë, 88 për qind, kundrejt 12 për qind që ishin spote të shkurtra politike me pagesë.

¹⁷⁵ Mbulimi i përgjithshëm i lajmeve në kohën kryesore të transmetimit nga kanali televiziv – RTK2: 7 orë 32 min 16 sek; PULSI TV: 2 orë 57 min 36 sek; TV Most: 6 orë 15 min 8 sek. Këto kanale televizive u monitoruan vetëm gjatë fushatës zgjedhore të raundit të parë pasi në nëntë nga dhjetë komunat nuk ka pasur raund të dytë.

FAQET E LAJMEVE NË INTERNET – MBULIMI I FUSHATËS




176

¹⁷⁶ Numri i artikujve sipas faqeve të lajmeve në internet, raundi i parë (16 shtator – 15 tetor): RTKLive.com 586; Koha.net 136; Gazetaexpress.net 17; Indeksonline.net 210; Insajderi.org 649. Raundi i dytë (18 tetor – 12 nëntor): RTKLive.com 192; Indeksonline.net 128; Insajderi.org 99.

ANEKSI III. REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE NGA EU EOM

Penetrimi i internetit në Kosovë në janar të vitit 2021 ishte 91 për qind dhe është ndër më të lartit në Evropë. Pothuaj 57 për qind e popullsisë përdor mediat sociale, me rreth 1.10 milionë përdorues të mediave sociale. Facebook është rrjeti kryesor social, i pasuar nga Instagram, LinkedIn dhe Twitter.¹⁷⁷ Aplikacionet e mesazheve janë po ashtu mjaft të popullarizuara, me Viber që udhëheq për sa i përket përdorimit.

NJMMS filloi aktivitetin e saj të monitorimit duke identifikuar peizazhin digjital për të sqaruar se deri në çfarë mase garuesit përdornin në mënyrë aktive platformat më të njohura online për të bërë fushatë. Bazuar në këtë, u mor vendimi për të fokusuar analizën kuantitative në Facebook dhe Instagram.



Aktiviteti i monitorimit të mediave sociale filloi me 16 shtator, ditën e parë të fushatës, dhe përfshiu periudhat e heshtjes zgjedhore dhe ditët e zgjedhjeve. U hartuan projekte të ndryshme të monitorimit. Periudha e monitorimit për fushatën e raundit të parë zgjati prej 16 shtatorit deri më 17 tetor 2021; Periudha e monitorimit për fushatën e raundit të dytë zgjati nga 18 tetori deri më 14 nëntor 2021, duke përfshirë edhe periudhën e para-fushatës edhe atë të fushatës zyrtare pesëditore. Përzgjedhja e mostrës është bërë sipas qëllimeve të shumta analitike, të pasqyruara më vonë në raporte të ndryshme. U përfshinë faqe, grupe dhe llogari me rëndësi kombëtare dhe komunale.

Për Facebook – gjithsej 487 faqe të Facebook-ut për raundin e parë dhe 187 faqe të Facebook-ut për raundin e dytë, si dhe 47 grupe publike.

LISTAT	RAUNDI I PARË	POSTIMET	RAUNDI I DYTË	POSTIMET
Subjektet politike ¹⁷⁸	228	302	52	223
Kandidatët për kryetarë të komunave	106	238	34	357
Institucione publike	68	59	68	157
Faqe të palëve të treta	85	243	33	270
Grupe publike	47	133	47	101

Për Instagram – gjithsej 145 llogari në Instagram për raundin e parë dhe 58 për raundin e dytë.

LISTAT	RAUNDI I PARË	POSTIMET	RAUNDI I DYTË	POSTIMET
--------	---------------	----------	---------------	----------

¹⁷⁷ Burimi: 'Ne jemi social' / Hootsuite, Digital 2021, [Raporti i Kosovës](#)

¹⁷⁸ Përfshirë 25 parti politike, 192 degë të partive, 10 iniciativa qytetare dhe 1 koalicion.

Subjektet politike ¹⁷⁹	42	161	17	158
Kandidatët për kryetarë të komunave	69	366	24	180
Institucione publike	17	51	17	92
Faqe të palëve të treta	17	N/A	N/A	N/A

Në përgjithësi, gjatë fushatës së raundit të parë u analizua një mostër e rastësishme prej 975 postimesh në Facebook dhe 578 postimesh në Instagram të publikuara nga 534 faqe dhe grupe publike në Facebook dhe 145 llogari në Instagram. Për raundin e dytë, mostra u përshtat për listën më të vogël të garuesve të përfshirë në garë dhe përbëhej nga 1,108 postime në Facebook dhe 430 postime në Instagram të publikuara nga 234 faqe dhe grupe publike në Facebook dhe nga 58 llogari në Instagram.

Gjetjet e monitorimit të mediave sociale treguan se toni i fushatës digjitale ishte përgjithësisht respektues në raundin e parë dhe u bë më negativ në vazhdimin e raundit të dytë, me raste të kandidatëve që përdorën platformat online për t'iu drejtuar kundërshtarëve me gjuhë të ashpër, e ndonjëherë duke u përpjekur për të delegitimuar ata.

Një analizë paraprake e aktivitetit të kandidatëve për kryetarë të komunave në Facebook dhe Instagram zbuloi se 106 kandidatë për kryetarë të komunave nga 166 që garonin në raundin e parë dhe 34 nga 42 që garonin në raundin e dytë kishin një faqe publike në Facebook. Gjashtëdhjetë e nëntë kandidatë për kryetarë të komunave kishin edhe profile në Instagram, 24 prej të cilëve garuan në raundin e dytë.

Në përgjithësi, vetëm 16 kandidatë për kryetarë të komunave kishin llogari të verifikuara që tregojnë simbolin verifikues të kaltër në Facebook dhe asnjë në Instagram.



Figura 2. Prania e kandidatëve për kryetarë të komunave në Facebook

¹⁷⁹ Përfshirë 13 parti politike, 21 degë të partive dhe 8 iniciativa.




Figura 3. Prania e kandidatëve për kryetarë të komunave në Instagram

Mjetet e monitorimit të mediave sociale të përdorura për të kryer analizën sasiore:

- *CrowdTangle* për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave në Facebook dhe Instagram;¹⁸⁰
- *Biblioteka e reklamave [Ad Library]* në Facebook për reklamat politike me pagesë;
- Format vizuale dhe SMM për analizimin e përmbajtjes u krijuan në bashkëpunim me Analistin e të Dhënave duke përdorur *Aplikacionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve Dita Z*.

Shumica e postimeve në Facebook të analizuar gjatë fushatës së raundit të parë iu adresuan publikut të gjerë (860). Shpesh ato u adresoheshin grave votuese (52) dhe të rinjve (45). Tridhjetë postime iu adresuan votuesve të diasporës. Në disa raste, ato ju adresuan komuniteteve joshumicë (11) ose personave me aftësi të kufizuara (7).¹⁸¹

¹⁸⁰ CrowdTangle është një instrument publik në pronësi dhe operuar nga Facebook.

¹⁸¹ Në disa raste, u vrojtuan postime që u adresoheshin objektivave të shumtë.




Figura 4. Raundi i parë: Facebook, grupet e synuara sipas postimeve

Në Instagram, shumica e postimeve të analizuara iu drejtuan publikut të përgjithshëm (502), pasuar nga të rinjtë (50) dhe gratë votuese (29). Janë vërejtur vetëm disa raste të izoluara të postimeve që i drejtoheshin diasporës (2) dhe votuesve me aftësi të kufizuara (2).




Figura 5. Raundi i parë: Instagram, grupet e synuara sipas postimeve

Shumica e postimeve në Facebook të analizuar gjatë fushatës për raundin e dytë iu drejtuan publikut të gjerë. EU EOM ka vërejtur një rritje të postimeve që i drejtoheshin diasporës ndërmjet dy raundeve (79 postime). Në pak raste, ato u drejtoheshin edhe komuniteteve joshumicë (9) ose personave me aftësi të kufizuara (8).




Figura 6. Raundi i dytë: Facebook, grupet e synuara sipas postimeve

Përveç publikut të gjerë (408), të rinjtë (18), gratë votuese (10) dhe diaspora (10) ishin grupet e synuara më të shpeshta në Instagram gjatë fushatës së raundit të dytë.




Figura 7. Raundi i dytë: Instagram, grupet e synuara sipas postimeve

Ndër temat e fushatës mbizotëronte infrastruktura – me fokus të veçantë në projektet urbane dhe ndërtimet – e pasuar nga ekonomia. Grafikët e mëposhtëm ofrojnë një përmbledhje të temave kryesore të fushatës gjatë fushatës për raundin e parë dhe të dytë.¹⁸²




Figura 8. Raundi i parë, temat kryesore të fushatës.




Figura 9. Raundi i dytë, temat kryesore të fushatës.

¹⁸² Aktiviteti i monitorimit të mediave sociale i EU EOM-së analizoi fushatën digjitale për të gjitha komunat që mbanin zgjedhje. Grafikët e përfshirë në këtë aneks japin të dhënat e atyre me popullsi më të madhe se 60 mijë banorë sipas regjistrimit të fundit të popullsisë. Shih Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës 2011, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

REKLAMAT POLITIKE ME PAGESË NË FACEBOOK DHE INSTAGRAM

Raundi i parë - Njësia e mediave sociale e EU EOM-së përcolli në mënyrë manuale reklamën politike me pagesë të 106 kandidatëve për kryetarë të komunave dhe 37 subjekteve politike në Facebook dhe Instagram çdo ditë nga 3 deri më 17 tetor. Periudha e vëzhgimit përfshiu dy javët e fundit të fushatës, duke përfshirë periudhën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve (e kuqe). Është vërejtur një rritje e vazhdueshme e reklamave zgjedhore, pjesa më e madhe e të cilave qëndruan aktive për disa ditë. Grafikët e mëposhtëm tregojnë trendin e vërejtur. Pavarësisht rënies së qartë me afrimin e ditës së zgjedhjeve, janë konstatuar gjithsej 58 shkelje të heshtjes zgjedhore nga garuesit.




Figura 9. Raundi i parë, reklamën aktive të kandidatëve për kryetarë të komunave




Figura 10. Raundi i parë, reklamën aktive të subjekteve politike

Raundi i dytë – Një trend i ngjashëm është vërejtur edhe mes dy raundeve, kur EU EOM-ja monitoroi në baza ditore reklamën zgjedhore të shfaqura në Facebook dhe Instagram nga 42 kandidatët për kryetarë të komunave që garuan në raundin e dytë, si dhe 13 subjektet politike. Aktiviteti i monitorimit zgjati nga 21 tetori deri më 14 nëntor dhe përfshiu periudhën e para-fushatës (ngjyrë portokalli), fushatën zyrtare 5-ditore (ngjyrë e kaltër), periudhën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve (ngjyrë e kuqe). Janë vëzhguar gjithsej 279 reklama, pjesa më e madhe e të cilave qëndruan aktive për disa ditë. Grafikët e

mmëposhtëm përmbledhin trendin e vërejtur. Gjatë të dy rundeve u identifikuan gjithsej 25 shkelje të heshtjes zgjedhore nga garuesit.




Figura 11. Raundi i dytë, reklamat aktive të kandidatëve për kryetarë të komunave




Figura 12. Raundi i dytë, reklamat aktive të subjekteve politike